

PËRMBAJTJA

Portreti i muajit: I hoqi dilemat	2
Dr. Milazim Krasniqi: Perde e re e hekurt mbi një pjesë të Ballkanit	3-4
Astrit Veliqi: Kosovarët në pritje, të izoluar larg Evropës!	4-5
Mr. Milazim Mustafa: Shkupi, drejt e më 2014. 6-7	
Zekerija Ibrahim: "Demokracia" që kurrë nuk u bë "e Re"	8-9
Arian Maksutaj: Varr masiv në Tiranë	9-10
Agim Fazliu: Keqtrajtohen prindërit	11
Dukagjin Avdyli: Strehimorja – Shtëpia e dytë për të moshuarit	12-14
Ejup Gashi: Autizmi	14-15
Prof. dr. Naser Ramadani: BIG BROTHER apo BIG BOTHER?!	16-17
Drita Azemi: Mavrova në vend të Brezovicës. 18-19	
Hajrije Mehmeti: Hoxha paditet për ndërtimin e xhamisë	19
Intervistë me Hayri Hatipoglu	20-22
Zekerija Ibrahim: Donkishotët zbulojnë Andaluzinë	23-24
Muhamed J. Kajolli: Luftërat civile 656-661 ..	25-28
Dr. Murad W. Hofmann: Muslimanët ndërmjet Oksidentit dhe Orientit (2)	29-31
Rini Hyseni: Zhdukja e gjuhëve	32
Flamur Maloku: Në tri toka	33
Avni Rudaku: Kosova në ngërçin mes kulturës dhe vetëkulturës (1)	34-35
Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Gjumi – "buton me natyrë pushimi"	36-37
Alban Bilalli: Sporti mbetet ende i izoluar	38-39
Me tespihe në dorë brenda dhe jashtë fushës së lojës	39
Fjalëkryqi	40



3 Perde e re e hekurt mbi një...



12 Strehimorja - Shtëpia e dytë...



20 Intervistë me Hayri Hatipoglu



23 Donkishotët zbulojnë...



38 Sporti mbetet ende i izoluar



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti V / Nr. 39
19 shkurt 2010 - 19 mars 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë**

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

I hoqi dilemat

Prizreni, Lipjani dhe Gjlani ishin komunat më të kontestuarra, pas raundit të parë të zgjedhjeve të para lokale në Kosovën e pavarur. Pati përplasje mes partive në pushtet, por në opozitë programore PDK-së dhe LDK-së. Pas vendosjes së përsëritjes së votimeve në dy komunat kontestuese, në Prizren dhe Lipjan, fitues dolën kandidatët e PDK-së: në Prizren, Ramadan Muja dhe në Lipjan, Shukri Buja. Të dy kryetarët mbetet të vazhdojnë detyrën e tyre në postin që kanë mbajtur deri më tani edhe për katër vitet e ardhshme. Fitorja bindëse e dy kandidatëve kishte rëndësi të madhe për PDK, sepse e rifitoi dhe e rikonfirmoi besimin aq shumë të duhur për momentin nëpër të cilin kaloi, e bombarduar me kritika nga opozita, por dhe rivali politik në koalicion LDK-ja. Po ashtu, kjo fitore ka ulur zërat e kritikës që vinin nga radhët e LDK-së kundër qeverisë. Kritikën e shumta reciproke e bën qeverisjen të brishtë, ndërsa dilemat për ndarje u shtuan gjithnjë e më shumë.

Mbetej të pritej epilogu i balotazhit në Lipjan, e në veçanti në Prizren, për të dalë nga qorrsoçaku i krijuar. Kështu fitorja bindëse në këto komuna, i hoqi dilemat e krijuara për prishjen e koalicionit si dhe i fashiti kërkesat e shpeshtuara të opozentëve për zgjedhje të parakohshme.

Në ambientet e selisë së asamblesë komunale të Prizrenit, kryetari Ramadan Muja, në një koktej rasti, me rastin e referimit përshëndetës, pos të tjerash, i falënderoi qytetarët e komunës së Prizrenit, duke i lavdëruar për besimin e dhënë, me rastin e daljes në numër nivelesh të dëshiruara, gjendje kjo, e cila fitoren e koalicionit, që ai e ka përfaqësuar në garën zgjedhore, e ka bërë më të bindshme se asnjëherë më parë. Z. Muja, gjithashtu, ka theksuar se përgjatë mandatit të tij katërvjeçar, do të jetë kryetar i të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre partiake, nacionale e fetare, ndërkaq për premtimet e dhëna përgjatë tërë fushatës elektorale, theksoi se do t'i realizojë me konsekuencë dhe pa asnjë përjashtim. ■

BIOGRAFIA:

Prof. dr. Ramadan Muja lindi më

8.II.1939. Ka magjistruar më 1975 dhe ka doktoruar më 1984. Gjatë viteve 1968 – 1975 ka punuar në shkollën normale në Prizren, si profesor i lëndës së historisë; prej vitit 1975 ka punuar në ShLP Gjakovë, si profesor i rregullt i lëndëve 'Historia e popullit shqiptar' dhe 'Metodika e mësimit të historisë'. Disa herë ka punuar edhe si Shefi i Katedrës. Është autor i teksteve shkollore e universitare dhe i shumë punimeve shkencore. Ligjeron lëndën e historisë. Më 2002 ishte bartës i listës për zgjedhjet komunale në Prizren 2002 – 2005, nënkryetar i degës së PDK-së në Prizren, 2002 – 2007 këshilltar në Asamblenë Komunale në Prizren nga radhët e PDK-së.



Perde e re e hekurt mbi një pjesë të Ballkanit

Me ndarjen e tashme të Ballkanit në “Ballkanin e mirë” dhe në “Ballkanin e keq”, rritet rreziku i shtimit të keqkuptimeve dhe të ndarjeve. Mund të thuhet se aktualisht qetësia në Ballkan ruhet vetëm për shkak të prezencës së NATO-s në Kosovë dhe premtimeve të Bashkimit Evropian për ta integruar mbarë rajonin në gjirin e vet



Dr. Milazim KRASNIQI

Bashkimi Evropian, më 19 dhjetor 2009, ka hequr regjimin e vizave për Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, ndërsa edhe për vitin 2010 ka mbajtur në fuqi regjimin e vjetër të vizave për Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën dhe Kosovën. Qytetarët e tri shteteve të para që u përmendën, tashmë udhëtojnë lirish nëpër shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa qytetarët e Shqipërisë, të Bosnjës dhe të Kosovës do të vazhdojnë të sorollaten para ambasadave, pa shpresa të mëdha që të marrin një vizë.

Me këtë vendim të ri, Bashkimi Evropian ka krijuar një version të ri të Perdes së Hekurt në Ballkan, duke i mbuluar me atë perde vetëm tri shtete të ashtuquajturit Ballkan Perëndimor. Kjo ndarje mund të ketë pasoja të rënda psikologjike te qytetarët e këtyre tri shteteve të izoluar, sepse do t'ua kujtojë periudhën e ndarjes së kontinentit dhe do t'ua injekttojë kompleksin e inferioritetit në raport me kombet e tjera ballkanike.

Këto pasoja edhe mund të rriten, kur dihet se Bashkimi Evropian i ka pranuar në anëtarësi të rregullt disa shtete, si Rumaninë e Bullgarinë, edhe kur ato nuk i kanë plotësuar kushtet elementare për të qenë anëtare të Bashkimit Evropian. Në fakt, edhe pse pas pranimit të tyre në Bashkimin Evropian, janë derdhur miliarda euro në këto dy shtete, ato ende janë të shtrënguara nga darët e krimit të organizuar.

Me vendimin më të ri të liberalizimit të vizave ndaj Serbisë, Maqedonisë dhe

Malit të Zi, Bashkimi Evropian sërish ka bërë lëshime ndaj këtyre shteteve, sepse as këto shtete ende nuk i kanë arritur standardet e kërkuara. Serbia ende nuk ka pasur sukses në përmbushjen e detyrimeve ndaj Gjykatës së Hagës, për arrestimin e kriminelëve të luftës, Ratko Mlladiqit dhe Goran Haxhiqit. Po ashtu, Serbia ende mban në Kosovë struktura paralele që e destabilizojnë Kosovën, e kjo është në kundërshtim me obligimet që ka ndaj EULEX-it. Serbia nxit nacionalizmin edhe në Bosnjë dhe me këtë nxitje po e pengon konsolidimin e shtetit boshnjak.

Të gjitha këto episode tregojnë se nuk ekziston as solidariteti rajonal ndërmjet shteteve të Ballkanit. Pra, nuk ekziston një Ballkan unik, pra as Ballkani Perëndimor, sepse me futjen e Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi në listën e Shengenit e me mbajtjen e regjimit të vizave për Shqipërinë, Bosnjën dhe Kosovën, është bërë edhe një ndarje e re e Ballkanit. Ka mendimtarë që thonë se një Ballkan me një identitet

unik ballkanik nuk ka ekzistuar kurrë.

Atëherë, pse Bashkimi Evropian ka ndjekur një politikë të krijimit të përparësive për integrimin e Serbisë, duke mbajtur jashtë Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjën? Tash për tash nuk është lehtë që të gjendet një përgjigje e plotë në këtë pyetje. Deri tash fokusimi i Bashkimit Evropian ka qenë në tërë “Ballkanin Perëndimor”, si një entitet unik, i sajuar për qëllime praktike të procesit të integrit. Kjo ka qenë një politikë më integruese dhe më unifikuese për Ballkanin. Por, me ndarjen e tashme të Ballkanit në “Ballkanin e mirë” dhe në “Ballkanin e keq”, rritet rreziku i shtimit të keqkuptimeve dhe ndarjeve. Mund të thuhet se aktualisht qetësia në Ballkan ruhet vetëm për shkak të prezencës së NATO-s në Kosovë dhe premtimeve të Bashkimit Evropian për ta integruar mbarë rajonin në gjirin e vet. Pa këto dy aspekte, konflikti serbo-shqiptar kurrsesi nuk do të fashitej. Përderisa është kështu, nuk mund të thuhet se ka triumfuar ndikimi i Bashkimit Evropian në këtë rajon të



trazuar, kur me vendimin më të ri ka shkaktuar ndarje të reja të këtij rajoni.

Në kohën që pason, Bashkimi Evropian duhet të gjejë mënyra si të mbajë gjallë shpresën e integritetit edhe te qytetarët e shteteve të lëna jashtë. Janë disa fusha si: arsimit, kultura dhe media, ku mund të rritet ndikimi i Brukselit, në procesin transformues mbi disa nga shoqëritë ballkanike që kanë mbetur prapa në zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Pra, në të ardhmen, ndikimi i Bashkimit Evropian duhet të përfshijë direkt edhe vetë shoqëritë, në mënyrë që ato ta ndiejnë vetë ndikimin, prezencën dhe kontributin që jepet për to. Kjo mund të realizohet në disa sektorë.

Agjencitë e Bashkimit Evropian duhet të financojnë me shuma më të mëdha dhe me projekte direkte universitetet publike dhe të medieve publike. Tejkalmimi i paragjykimëve dhe i armiqësive mund të bëhet përmes njohjes më të mirë dhe të kuptuarit e ndërvarësisë së fateve të këtyre kombeve në kohën në të cilën jetojmë. Angazhimi aktual i Unionit Evropian të Transmetuesve për ta mbrojtur pavarësinë e Radiotelevizionit të Kosovës është një shembull i mirë në këtë drejtim. Universitetet dhe mediet publike janë pak më larg dorës së qeverive dhe transmetojnë më shpejt nevojën e ndryshimeve në shoqëri. Por, angazhime të tilla duhet të ketë edhe në fusha të tjera si lufta kundër krimit të organizuar. Nëse Bullgaria dhe Rumania, si shtete anëtare të Bashkimit Evropian, ende nuk kanë kapacitete për ta luftuar krimin e organizuar, kjo tregon se shtetet e reja si Kosova dhe shtete të dala nga konflikte të rënda si Bosnja e Hercegovina, duhet të ndihmohen shumë më tepër në këtë drejtim.

Megjithatë, Bashkimi Evropian ka dhënë sinjale se për Shqipërinë dhe Bosnjën mund të bëhet liberalizimi në mesin e vitit 2010, gjë që e mban shpresën se edhe kjo pjesë e Ballkanit do të përfshihet në integritet. Ndërsa, sinjalet më pesimiste kanë ardhur për Kosovën, sepse është thënë se kjo nuk mund të ndodhë para vitit 2011. Por, këto janë ende prognoza. Ajo që dihet saktësisht është se ka ndodhur një ndarje e re e Ballkanit dhe se kjo mund të prodhojë efekte negative në këtë rajon. Por, mbetet të shpresohet se kjo ndarje e re është shumë më e përkohshme se sa ndarjet e dikurshme. ■

Mosliberalizimi i vizave – kosovarët presin më orë të tëra para...

Kosovarët në pritje, të izoluar larg Evropës!



Astrit VELIPI

Pothuaj çdo ditë janë të shumë qytetarët që presin me orë të tëra para ambasadave të vendeve perëndimore në këtë kohë të acartë dimri për t'u pajisur me viza shengen.

Shumë prej tyre shprehen të pakënaqur me pritjet e gjata në rreshtat e gjatë, ku ata presin me orë të tëra për t'u pajisur me viza për të vizituar vendet e ndryshme perëndimore, ku në të shumtën e herëve i kanë të afërmit dhe familjarët e tyre.

Me orë të tëra duhet pritur për një vizë shengen

Një fat të tillë, për të pritur më orë të tëra para ambasadës gjermane në Prishtinë edhe në këtë të ftohtë të madh dimri, e kishte edhe plaku 63 vjeçar nga komuna e Malishevës, Asllan Krasniqi.

Ai, sikurse shumë të tjerë, qëndronte në radhët e gjata para dyerve të ambasadës për ta marrë vizën shengen.

“Edhe para tri jave jam kan ktu, ku i kam dorëzuar dokumentet për me mor vizën, siç pe shihni edhe ju i ka plot pesë orë që jam t'uj prit për ta marrë vizën” - shprehet plaku Asllan, i cili kishte mër-

hirë tej mase nga të ftohtit.

Ai pasi që ta merrte vizën kishte vendosur të shkonte për ta vizituar djalin e tij që e ka me familje në Gjermani, tash e shtatë vite.

Sipas tij, mbetja e Kosovës jashtë zonës evropiane të vizave shengen i ka zbehur edhe më tej shpresat e tij, pasi, edhe herën tjetër, ai duhet të presë pranë ambasadave për ta marrë vizën.

Halit Berisha: Shtatë orë prita për një vizë

Nuk është plaku Asllan i vetmi që ka pritur më orë të tëra për t'u pajisur me viza shengen, para ambasadave perëndimore në Prishtinë.

Një fat i tillë e ka shoqëruar edhe të riun Halit Berishën, të cilin e takuam duke pritur para dyerve të ambasadës italiane në lagjen “Arbëria” në Prishtinë.

Ai u shpreh se kishte udhëtuar mbi 50 km për të arritur në ambasadë. Që nga ora nëntë e mëngjesit e deri në orën 15, nuk ka pasur mundësi të marrë vizën, ngase masa e qytetarëve ka qenë shumë e madhe për t'u pajisur me viza italiane, andaj edhe ishte detyruar të priste kaq gjatë.

“Këtu jam që nga ora nëntë e mëngjesit dhe ende nuk po mund të hyj në radhë për ta marrë vizën”, - u shpreh Haliti.

Ai tha se mos liberalizimi i vizave ka bërë që ne të presim edhe më tej me orë të tëra në këto ambasada, edhe për shumë kohë.



Ambasadave perëndimore

Megjithatë, ai thotë se liberalizimi i vizave do të ishte një mundësi e mirë për të lëvizur më të lirë nëpër vendet e BE-së. Kjo çështje ka mbetur pa u zgjidhur për shkak të standardeve që duhet t'i përmbushë Kosova për t'u bërë pjesë e zonës "shengen".

Por, përveç tij, ata që ndoshta heqin të zitë e ullirit në transport e shpenzime të shumta, janë ata qytetarë që detyrohen të udhëtojnë në vendet e rajonit për t'u pajisur me vizat e vendeve të ndryshme.

Si cak i tyre edhe më tej mbetet Shkupi, Tirana e madje edhe Beogradi.

Mentor Gashi: Institucionet - kanë bërë pak për liberalizimin e vizave

Mentor Gashin, nga Prishtina, e takuam në orët e hershme të mëngjesit në stacionin e autobusëve në Prishtinë, para se të hynte në autobus, për të udhëtuar drejt Shkupit.

Atij i duhej të udhëtonte në Shkup, në ambasadën e Luksemburgut, për ta marrë vizën e këtij vendi.

Ai i fajësoi institucionet e vendit se nuk janë duke bërë shumë për ta futur edhe Kosovën në zonën e vizave shengen.

"Po detyrohemi të udhëtojmë në Shkup e Tiranë për të marrë një vizë të vendeve perëndimore, në mungesë të një alternative tjetër për jetesë në Kosovë", - u shpreh Gashi.

Sipas tij, mungesa e një perspektive për jetë më të mirë dhe statusi i brishtë social ka bërë që ne të orvatemi në zyrat e shteteve perëndimore për të synuar një jetë më të mirë dhe një të ardhme më të mirë, duke fajësuar institucionet e vendit se kanë bërë pak për liberalizimin e vizave edhe për kosovarët.

Kosovarët paguajnë 5000 euro për një pasaportë serbe

Të gjitha këto rrëfime, që shprehën qytetarët tanë për t'u pajisur me një vizë shengen, janë vërtet të dhimbshme, por ajo që duket edhe më shqetësuese për këtë fakt janë disa burime, që kanë qarkulluar kohën e fundit, se kosovarët kanë nisur të paguajnë deri në 5000 euro për një pasaportë biometrike të Serbisë.

Deri më tani, 970 shqiptarë kanë parashtruar kërkesë për marrjen e pasaportave në Qendrën Koordinuese në Beograd, prej të cilëve 800 vetave u është



pranuar kërkesa, ka theksuar agjencia 'Beta', duke u bazuar në burimet e MPB të Serbisë. Ata konsiderojnë se qytetarët e Kosovës janë qytetarë të Serbisë dhe kanë të drejtë të kenë pasaporta serbe.

Gjithnjë sipas këtyre burimeve, thuhet se për të udhëtuar pa viza në BE, shtetasit kosovarë, përveç që paguajnë shumën të mëdha të hollash për t'u pajisur me një pasaportë biometrike serbe, ata në të njëjtën kohë janë edhe të detyruar të shpërngulen nga Kosova dhe të bëhen shtetas të Serbisë, me qëllimin e vetëm që të pajisen me pasaportë biometrike serbe.

Bëhet e ditur se kosovarët, përveç të tjerash, marrin letrën e shpërnguljes në Graçanicë dhe bëhen banorë të Serbisë. Madje këtë e kanë konfirmuar edhe zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Megjithatë, në lidhje me këtë fakt, zyrtarët nuk japin statistika se sa kosovarë i kanë marrë këto pasaporta për të udhëtuar pa vizë në vendet e jashtme.

Kështu që edhe sekretari i Ministrisë Serbe për Kosovën, Oliver Iavnoviq, e ka pohuar faktin se kosovarët po pajisen me këto pasaporta.

Megjithatë, këshilltari i ministrit të punëve të brendshme, Zenun Pajaziti thotë se nuk është në dijeni se kosovarët pajisen me pasaporta serbe.

Qeveria këmbëngulëse për liberalizimin e vizave

Edhe pse tash së voni, në ambientet e Qeverisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme mbajti takimin e Grupit Punues për Liberalizimin e Vizave.

Në këtë takim, përveç ministrit të punëve të brendshme, Zenun Pajaziti, kanë marrë pjesë edhe anëtarët e Grupit Ndërministror, që janë përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit dhe Planit të Punës për Liberalizimin e vizave, si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të tjera përgjegjëse në procesin e liberalizimit të vizave.

"Ministri Pajaziti, në këtë takim, thuhet se e ka inkurajuar Grupin Punues në emër të Qeverisë dhe të Kryeministrit për punën që e ka bërë dhe që pritet ta bëjë. Kështu që Grupi Punues ka koordinuar një varg aktivitete në nivel të Qeverisë dhe të institucioneve të ndryshme për ta përgatitur vendin tonë për hyrje, ose përfshirje në procesin e liberalizimit të vizave", - thuhet në një komnatë të MPB-së.

"Jam i sigurt që trendi i angazhimeve të institucioneve të Kosovës është i mirë dhe ne presim edhe një partneritet me shoqërinë civile, në mënyrë që bashkërisht, si shoqëri kosovare, të jemi sa më të përgatitur për përfshirjen sa më të shpejtë në këtë proces", - ka thënë ndër të tjera Pajaziti.

Ai u zotua për gatishmërinë e institucioneve të vendit për t'u përfshirë në këtë proces dhe, siç pohon Pajaziti, këtë gjë e kërkojmë me ngulm nga BE.

Sido që të jetë, vonesa e këtij procesi po bën që kosovarët të presin edhe më tej me orë të tëra për t'u pajisur me një vizë shengen, e madje edhe të bëhen shtetas serbë, vetëm për një jetë dhe mirëqenie më të mirë në të ardhmen. ■

Shkupi, drejt e më 2014



Mr. Milazim MUSTAFA

Në kryeqytetin e Republikës së Maqedonisë jetojnë afërsisht 1 milion banorë. Të dhënat e para për Shkupin janë prej shekullit të 3-të p.e.s. Baza e këtij qyteti është qyteti antik Skupi, i cili gjendet 5 km në veri të qendrës së Shkupit. Ai ka qenë pjesë dhe kryeqendër e Provincës Ilire të Dardanisë. Çdo perandori dhe sundimtar që ka kaluar nëpër Shkup ka lënë gjurmët e veta, duke filluar qysh nga ajo iliro-romake, pastaj ajo bizantine, osmane, serbo-jugosllave, e tash edhe sllavo-maqedonase. Në këtë qytet, jetojnë grupe të ndryshme etnike dhe fetare, duke dominuar karakteri i tij shumetnik dhe shumëkonfesional. Në këtë qytet, ndër objektet kryesore arkitektonike llogariten Kalaja e Shkupit, Kompleksi i Manastireve Shën Pantelejmoni (i shek. të 12-të), Ura e Gurit (e shek. të 15-të), Hamami i Daut Pashës (objekt i shek. të 15-të), Xhamitë e Sulltan Muratit, Mustafa Pashës, Isa Beut dhe disa xhami të tjera (të ndërtuara mes shekujve 15 – 18-të), Kisha Sveti Spas (shek. 17-18-të), Çarshia Orientale, së bashku me tregun Bitpazar etj.

Kohëve të fundit, sidomos pas ardhjes në pushtet të kësaj garniture qeveritare të udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe lideri i saj Nikolla Gruevski, u aktualizua fenomeni i ndërrimit të identitetit sllavo-maqedonas në atë të maqedonasve antik, se maqedonasit e RM-së nuk janë me origjinë sllave, por janë pasardhësit e Filipit të dytë dhe Aleksandrit të Maqedonisë (Leka i Madh). Të shtyrë nga kjo ide, fillimisht qeveria propozoi që të vendosë statujën e Aleksandrit të Madh në sheshin e Shkupit. Pas kësaj doli edhe me projekt për vendosjen e një numri të madh të figurave historike maqedonase, të të gjitha periudhave të historisë së tyre.

Pas prezantimit vizual të këtij projekti të ashtuquajtur “Shkupi 2014” reagon të gjitha subjektet që veprojnë në RM. Më të zëshëm ishin dy organizata studentore të studentëve të fakultetit të arkitekturës në Shkup, si ajo ‘Sheshi Liria’ dhe ‘Arqi Brigada e parë’ ku më pas iu bashkëngjitën edhe një numër prej 30 organizatave joqeveritare maqedonase. Këta janë kundër vendosjes së çfarëdo objekti në shesh, për arsye sepse një gjë tillë do ta ngulfat sheshin e Shkupit. Duke e ditur se bëhet fjalë për një shesh me hapësirë jo shumë të madhe, sipas Nikolla Gelevski, anëtar i shoqatës ‘Sheshi Liria’, ky projekt, përveç kësaj që prezanton, shpie edhe në prishjen e tensioneve multietnike, me ç’rast ai kërkoi dorëheqjen e ministres së kulturës Elizabeta Kançeska – Milevska, për shkak të mosposedimit të kulturës elementare, por edhe ndryshimin e pamjes së qytetit pa ndonjë debat publik..

Faktori politik shqiptar – konfuz

Qeveria e RM-së, konkretisht partia maqedonase, pa asnjë debat publik, ose arritje të kompromisit me partnerin shqiptar në qeveri, prezantoi planin, porositi gdhendjen e skulpturave, por edhe nënshkroi marrëveshje me kompani të caktuara për lyerjen me bronz të këtyre skulpturave. Me këtë rast janë shkelur të gjitha procedurat për ndryshime të tilla, rast për të cilin do të vendosë edhe Gjykata kushtetuese e RM-së.

Nga partia më e madhe opozitare maqedonase LSDM, kërkohet debat për “projektin më të korrumpuar”, duke deklaruar se dikush duhet t’i ndalë këto frustracione personale të qeverisë dhe

se për këtë projekt duhet të vendosin qytetarët nëpërmjet referendumit, -deklaroi koordinatorja e kësaj partie, Cvetanka Ivanova. Gjithashtu, në një deklaratë nga nënkryetari i kësaj partie, Gordan Georgiev, u potencua sy ky projekt është provokim për shqiptarët e Maqedonisë.

Paritë shqiptare, në këtë rast, janë të gjitha në opozitë. Edhe përkundër gjithë kësaj vërehet një reagim jo i bollshëm nga këto subjekte. Fatkeqësi më e madhe në këtë rast janë akuzat e ndërsjella, si dhe tentimet për përfitim politik.

Partia në pushtet, BDI, nëpërmjet zëdhënëses Ermira Mehmeti prononcohet se në këtë shesh “Pamja e re e sheshit, jo vetëm që nuk shpreh me asnjë element realitetin multietnik dhe multikonfesional të Maqedonisë, por paraqet sulm arrogant ndaj të gjitha vlerave të përbashkëta, të cilat u ngritën me shumë mund”. Sipas saj, vizioni i BDI-së, “Shkupi 2014”, është integrimi i brendshëm, duke respektuar të gjitha bashkësitë etnike, si dhe duke u integruar në bashkësinë e metropoleve evropiane. Anëtarët e PDSH-së janë shumë jo konstruktivë. Nënkryetari i saj, Iljaz Halimi, në një emision debatues, u prononca se atyre nuk ju pengon aspak një projekt i tillë, respektivisht: “në sheshin e Shkupit, le të ndërtohen jo një, po edhe tri kisha nëse duan”, sepse sipas tij, në anën e djathtë të rrjedhës së Vardarit, jetojnë gati 100% maqedonas. Kësaj partie i intereson që ta ndërtojë sheshin e Tetovës. Edhe nga deklaratat e mëparshme të kësaj partie kemi parë se ata kanë hequr dorë prej kohësh nga Shkupi, duke toleruar ndërtimin e kryqit gjigant në “malin e Shkupit” Vodno,

pastaj duke dhënë pëlqimin e tyre për ndërtimin e Kishës Shën Konstantini dhe Elena në sheshin e Shkupit. Sipas Imer Selmanit, kryetari i DR-së, ky projekt duhet të stopohet sepse përndryshe do të shpie në prishjen e marrëdhënieve multietnike në shtet, duke kërkuar të kihet kujdes ndaj ndjenjave fetare të qytetarëve të Maqedonisë, sepse të gjithë e dimë se ky

Xhamia Burmali



Xhamia Burmali u ndërtua në Shkup nga Mehmet Beu, i biri i Karlëzades, nga fundi i shekullit të 15-të, konkretisht në vitin 1495. Fillimisht ka qenë e njohur si Xhamia e Mehmet Beut, duke e mbajtur emrin e ndërtuesit të saj, e më vonë mori emrin Burmali, emër, të cilin e mori nga shtylla e minares së saj që ka qenë e ndërtuar me gurë në formë spiraleje. Me shekuj ka qëndruar afër Urës së Gurit në Shkup dhe e ka hijeshuar sheshin e Shkupit, duke u llogaritur si një monument kulturor imponant me një arkitekturë fantastike, derisa u rrënuar nga mbretëria SKS në vitin 1925. Kjo xhami dallon për stilin e saj karakteristik dhe minaren e saj në formë spirale.



shtet është shumëkonfesional. Gjithash-tu, ai deklaroi se për kalimin e këtij projekti duhet të ketë debat në kuvendin e RM-së dhe se për të kërkohet shumica e dyfishhtë (shumica e Badinterit), dhe se qendra e Shkupit duhet t'i pasqyrojë qytetarët e RM-së nëpërmjet dallimeve të tyre kulturore, historike dhe fetare.

I ndarë edhe sektori civil

Asnjëra nga këto parti nuk ka qëndrim zyrtar për çështjen e Xhamisë Burmali, objekt ky që kërkohet me ngulm nga Këshilli për ndërtimin e Xhamisë Burmali, ku bëjnë pjesë 72 organizata joqeveritare, por edhe nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë. Të gjithë këta kërkojnë ndërtimin e Xhamisë Burmali në vendin ku ka ekzistuar para se të rrënohej nga serbët në vitin 1925. Ky këshill kërkon me ngulm nga shteti që vendi ku ka qenë e vendosur Xhamia Burmali t'i jepet Bashkësisë Islame dhe në po të njëjtin vend të ndërtohet xhamia, e cila ka qëndruar aty me shekuj deri në kohën e rrënimit të saj.

Organizata qytetare 'Zgjohu', fillimisht, aktivitetin e saj e përqendroi në kërkesën për ndërtimin e shtëpisë së "Nënë Terezës" në vendin ku edhe ka qenë, ku sipas projektit në fjalë do të jetë vendi i kishës Ortodokse Shën Konstantini dhe Elena. Ditëve të fundit, të shtyrë nga realiteti, e zgjeruan kërkesën e tyre edhe për përmendore shqiptare, duke dëshiruar që qendra të ketë karakter

shumetnik dhe shumëkonfesional. Ajo propozoi ndërtimin e përmendores së Adem Jasharit, 28 Nëntorit, 17 Shkurtit, Dëshmorëve të UÇK-së të vitit 2001, Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Lidhjes së Prizrenit, Ibrahim Rugovës, Motrave Qiriazit, Ferid Muratit, Kulla Shqiptare, si dhe objekte tjera të historisë shqiptare që do të vendosen nëpër qytetet tjera të Maqedonisë.

Shoqata e historianëve shqiptarë në Maqedoni, në prononcimin e tyre për media, kanë deklaruar se janë kundër këtij projekti tendencioz dhe etnocentrik me elemente fashiste. "Shkupi ka një realitet tërësisht tjetër dhe Shkupi ka qenë në vazhdimësi kryeqendër e Mbretërisë Dardane dhe e Vilajetit të Kosovës", - deklaroi për media Skender Hasani, nënkryetar i kësaj shoqate.

Reagimet nga Shqipëria dhe Kosova janë të pakta

Ky projekt shtyri që të reagojnë analistët shqiptarë edhe jashtë Maqedonisë. Në një prononcim për media, analisti i pavarur shqiptar Koço Danaj, u shpreh se fajin kryesor e kanë politikanët shqiptarë, duke e justifikuar politikën e kryeministrit Gruveski. Ai tha se politikanët shqiptarë "ditën janë kundër Nikolla Gruevskit, kurse natën përqafohen me të". Ndryshe mendon Albin Kurti, i Lëvizjes 'Vetëvendosja'. Ai e akuzoi qeverinë e IRJM-së se me këtë akt dëshiron të shpërngulë shqiptarët

nga Shkupi, duke politizuar kulturën, duke ndërtuar përmendore dhe kisha të ndryshme. Kurti deklaroi se shqiptarët nuk mund t'i kundërvihen politikës shoviniste të qeverisë së IRJM-së, por duhet një ndikim gjithëkombëtar, gjë që nga Prishtina dhe Tirana nuk ka aspak interes.

Përkundër gjithë këtyre reagimeve, qeveria u bë e shurdhët dhe këtyre ditëve ka filluar me realizimin e këtij projekti, duke rrethuar vendin ku do të ndërtohet kisha në shesh, pastaj edhe përmendora 26 metërshe e Aleksandrit të Madh, objekte këto të parapara në planin detaj të Komunës së Qendrës në Shkup. Këto janë vetëm dy nga qindra skulpturat dhe objektet e tjera që do të ndërtohen në afërsinë e sheshit të Shkupit. Në këtë projekt fashizoid nuk është paraparë as edhe një objekt tjetër i natyrës jo maqedonase apo jo ortodokse. Me këtë projekt dëshirohet t'i ndërrohet tërësisht pamja Shkupit.

Sikurse edhe mijëra herë të tjera, reagimet e "faktorit" shqiptar ishin të ndara. Jo vetëm që janë të ndara, por edhe kundërthënëse mes vete. Kjo më së shumti është në dobi të atyre që Shkupin - kryeqytetin e Dardanisë Ilire dhe kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, duan ta shohin me kryqe dhe kisha ortodokse maqedonase, e jo si Shkup edhe i shqiptarëve dhe muslimanëve. Për këtë hap, liderët shqiptarë që veprojnë në Maqedoni, do t'i mallkojë historia. ■

“Demokracia” që kurrë nuk u

Tashmë të gjithë politikanët shqiptarë më kanë dëshpëruar nganjëherë, kush më shumë e kush më pak, por vërtet më vjen keq për ata shokë të mi që besuan dhe humbën aq energji, fuqi, por edhe miq të taborëve të tjerë politikë, duke u munduar që këtë parti vërtet ta bëjnë “të Re”



Zekerija IBRAHIMI

Kur në skenën politike doli Imer Selmani me partinë e re, që edhe e quajti Demokracia e Re, vërtet kisha besuar se në politikën e shqiptarëve të Maqedonisë po ndodhnin mrekulli. Ma merrte mendja se përfundimisht po përfundonte epoka e ditëve të liga në politikë, duke i dhënë fund PDSH-së dhe se po i merrte këmbët inferioriteti politik i BDI-së që na bëri të pyesnim se “a ia vllente vërtet gjithë ajo luftë në vitin 2001?!” Por, për herë të tretë isha mashtruar.

Një herë u mashtrova në vitin 1993 kur doli në skenë Menduh Thaçi me kryefjalën e tij “Shqip! Votën atdhetarëve! etj.” Disa vite më vonë e kuptova se gjithë ato moto e fjalë të mira ishin gatuan në kuzhinat e DBK-së së Maqedonisë, gjë të cilën e pohoi para disa viteve një ish-ministër i policisë, ndërsa Thaçi asnjëherë nuk e mohoi këtë.

Së dyti, jam zhgënjyer kur mendova se pas luftës së 2001-shit përfundoi më çështja shqiptare te ne. Por, kur e shoh se ky pushtet, edhe në vitin 2009, ende sillet me po atë arrogancë si Cërvenkosvki gjatë të '90-tave, duke na e imponuar maqedonishten me zor, duke na e nëpërkëmbur shqipen, ushtarët tanë dhe sakrificën tonë, ndërsa BDI-ja ëndërron ditë më të mira dhe



Ali Ahmeti

i bën bajram vetes se “punët janë mirë”, më vjen keq që edhe këtë e kam kuptuar kaq vonë.

Ndërkaq zhgënjimin e fundit e përjetova në kohën kur mendoja se në Maqedoni do të dalë një opSION politik më këmbëngulës, më i pjekur, më serioz, me profesionistë dhe me njerëz që dinë të bëjnë politikë në shek. e XXI-të. Ndonëse gjithë shqiptarët këtë e prisnin nga Rufi Osmani, në skenë u ngjiti ish-nënkryetari i PDSH-së, Imer Selmani. Ndonëse ish-figurat jo fort të famshme të PDSH-së, që shkuan këtu, sikur ia zbehnin imazhin “e Re” kësaj partie, përsëri njerëzit donin të besonin se ka përfunduar ajo kohë. Pastaj edhe skenat e zgjedhjeve të 2008-tës me grupin e Kondovës të bashkërenduar pikërisht me lidhshimin e DR-së i trokitnin memories sonë, por dëshira që të bëhet mirë dëshironte të besojë se ajo kishte qenë një e kaluar që kishte përfunduar dhe tash po hapej një faqe e re në poli-



Menduh Thaçi

tikën shqiptare. Dhe, ndonëse një mik i imi i Sarajit disa herë ma kishte përsëritur atë meselenë e ujkut që e ndërron vetëm qimen, unë si me dëshirë doja të besoj se në politikën shqiptare po vijnë ditë më të mira. Mendoja se kështu do dalë nga skena Menduhi me “mangupët” e vet, ndërsa BDI-së do t'i krijohej një opozitë konstruktive që do ta detyronte t'i çonte proceset përpara, ngase do t'i rrinte vazhdimisht mbi kokë për lëshimet e bëra. Aq më shumë, për këtë, më bindën ca shokë të mi, të cilët duke besuar si unë bile u angazhuan politikisht në partinë e re. Ata gabuan dy herë më shumë, sepse u angazhuan të bëjnë strukturën e partisë, të vrapojnë në zgjedhje dhe të besojnë me sinqeritet se premtimet e Imerit për parti, ku gjithçka do të shkonte në bazë të statutit me zgjedhje një anëtar-një votë, vërtet do të përmbusheshin. Sipas kësaj logjike dhe sipas sistemit të lobimeve politike, që janë

formë e njohur e organizimit modern politik, ata formuan disa degë, morën pjesën në zgjedhjet komunale, ndërsa në kongresin e partisë zunë vend në Këshillin Qendror të DR-së. Por, këtu u këput peri. Ata që i pamë atë ditë të ulur në rreshtin e parë në mbledhjen e këtij këshilli në Aleksandar Palace, që në ambientin tonë janë të njohur si ndotës të ajrit me dyoksid karboni, afion dhe me huazime fizike të njerëzve, si dhe përjashtimi i atyre që realisht



Pamje nga Shkupi

u bë "e Re"

"Dita e re shihet n'sabah"
Thënie popullore

e bënë Demokracinë e Re në terren, na bindi se gjithë ato vizita të Imerit nëpër xhami, ato iftare e gjithë ato fjalë të mira për respektimin e rregulloreve e statuteve kishin qenë vetëm një manir i vjetër në një parti të re – kështu vepronte Menduhi derisa forcohej. Kështu ky Imeri fjalëmirë e fytyrëqeshur tregoi se cili ishte në të vërtetë – ai do të vazhdonte me sistemin e sulltan partive, me bosë të njohur "të shkencës", me parti pa vizion politik, me parti pa strukturë e pa degë, vetëm e vetëm që mos të lejonte që në parti të mbretëronte demokracia. Ndonëse partia mban emër demagogjik Demokracia e Re. Një emër që tash po bëhet pronë e historisë sonë të dështuar.

Dhe, unë nuk e kam dert për vete se jam zhgënjyer, sepse tashmë të gjithë politikanët shqiptarë më kanë dëshpëruar nganjëherë, kush më shumë e kush më pak, por vërtet më vjen keq për ata shokë të mi që besuan dhe humbën aq energji, fuqi, por edhe miq të taborëve të tjerë politikë, duke u munduar që këtë parti vërtet ta bëjnë "të Re". Por, "dita e mirë shihet n'sabah", thotë populli.

Kurrjë. Një letër më pak në politikën shqiptare, një dështim i ri dhe një pritje e re e deklaratës së re të ndonjë polici se kush e formoi dhe pse e formoi DR-në. Vetëm edhe një zhgënjim. Asgjë më shumë. ■



Imer Selmani

Eshtrat e 19 njerëzve të ekzekutuar me nga një plumb pas koke u gjetën pranë një reparti ushtarak rrëzë Dajtit

Varr masiv në Tiranë

Ekspertët thonë se janë vrrarë në vitet '70-'80. Ende të pidentifikuar.



Arian MAKSUTAJ

Përderisa pozita dhe opozita akoma zihen rreth hapjes ose mos-hapjes së kutive të votimit, Shqipëria këto ditëve u shokua nga një ngjarje jo e zakonshme. Në shtegun e ngushtë të një lugine të rrethuar nga pishat dhe barakat ushtarake, në rrëzë të malit të Dajtit, u zbulua një varr masiv, që daton nga koha e regjimit të egër diktatorial komunist të Enver Hoxhës. Ekzistenca e varrit masiv u bë e ditur pasi djemtë e dy prej të ekzekutuarve nga regjimi komunist në vitin 1976 kryen gërmime masive private në kërkim të eshtrave të baballarëve. Ekzaminimet tregojnë se viktimat ishin ekzekutuar në dimër. Nga dhëmbët dhe kafa dukej se ishin ekzekutuar në moshë të re. Urdhri i ekzekutimit ishte firmosur nga ministri i kohës, Kadri Hazbiu, i cili disa vite më vonë u bë pjesë e procesionit që kishin pësuar viktimat e tij.

Ministria e Brendshme premtoi hapjen e arkivit të vet për hetuesit që do

të përpiqen të gjejnë emrat e mbetjeve njerëzore të gjetura.

Bodrumet e Ministrisë së Brendshme dhe arkivat e tjera bartin qindra dhe mijëra dokumente që mund të japin informacion mbi vendet e ekzekutimit. Nxjerrja në dritë e këtyre arkivave jo vetëm që do t'u japë dinjitet vuajtjeve të gjeneratave që jetuan nën komunizëm, por do të shërbejë edhe si shpjegim për ata që kanë lindur pas rrëzimit të sistemit. Këta të fundit do të kenë në këtë mënyrë një shpjegim se pse Shqipëria nuk duhet të përballet kurrë më me fatkeqësi të tilla.

Ndonëse zbulimi i varrit masiv 313 bëri bujë, fakt mbetet se në zonë gjenden ende vendvarrosjet e shumë të tjerëve. Vetëm një nga procesverbalet e Ministrisë së Brendshme të kohës tregon emrat e mbi 30 vetëve të ekzekutuar në atë vend.

Varrri masiv 313 i përket para së gjithash viteve 1970-1980. Arkivat dëshmojnë se pikërisht në këto vite zona është përdorur si vend ekzekutimi dhe var-



rosjeje. Në arkiv ekziston edhe një listë e detajuar me njerëzit e ekzekutuar aty.

Njerëzit që bënë zbulimin, thonë se dëshira e tyre është që gërmimet e tjera të kryhen nga ekspertët. Ata kërkojnë që profesionistët e historisë të menaxhojnë të gjithë informacionin e nevojshëm arkivor dhe të kryejnë intervista me njerëzit që kanë qenë dëshmitarë në atë kohë. Në Shqipëri ka ende më shumë të ekzekutuar pa varr, se sa të ekzekutuar me varr. Vlerësohet se 2500-3000 varre të tilla presin të hapen në të gjithë vendin.

Shqipëria është një nga pak vendet përtej Perdes së Hekurt që nuk i ka hapur arkivat e shërbimit sekret të kohës së komunizmit. Askush nuk i ka numëruar me të vërtetë të ekzekutuarit ose të burgosurit, kështu që nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e tyre.

Shoqatat e ish-të burgosurve politikë besojnë se 5577 burra dhe 450 gra u ekzekutuan gjatë regjimit komunist nga viti 1946 deri në vitin 1991.

Ndërkohë, autoritetet shtetërore nuk kanë bërë asgjë për të ndihmuar familjarët e viktimave të gjejnë eshtrat e të ekzekutuarve.

Një debat vijon prej shumë vitesh nëse duhet apo jo të hapen arkivat e shërbimeve sekrete. Megjithatë Parlamenti i Shqipërisë miratoi vitin e kaluar një ligj që synon të ndalojë ish-zyrtarët e lartë të komunizmit, si edhe bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, kritikët thonë se ai ligj, përveç faktit që nuk i hapte dosjet për publikun e gjerë, u hartua qëllimisht keq, në mënyrë që të dështonte në Gjykatën Kushtetuese.

Ligji vetëm sa hapi një valë të re akuzash, kundër-akuzash dhe thashemesh, se kush nga politikanët e sotëm ka qenë spiun e kush jo, por nuk solli asgjë me vlerë në zbulimin e së vërtetës mbi të shkuarën. Një ligj tjetër i ngjashëm, i miratuar në vitin 1995, u konsiderua gjithashtu i pavlerë dhe u hodh poshtë. Gjykata Kushtetuese e anuloi ligjin e fundit të lustracionit vitin e kaluar. Pavarësisht kësaj, asnjë deputet i Parlamentit të Shqipërisë, përfshi edhe disa deputetë që kanë qenë të burgosur politikë, nuk propozoi kurrë një ligj për t'i ngarkuar qeverisë detyrën e gjetjes dhe identifikimit të eshtrave të të pushkatuarve. Ligji i fundit i lustracionit, i hartuar nga qeveria e djathtë e Kryeministrit Sali Berisha, ka marrë edhe kritika nga Këshilli i Evropës, i cili e konsideroi atë si jashtë standardeve.

Shumë ish-të burgosur politikë dhe familjarët e viktimave besojnë se bashkëfajësia e elitës politike dhe intelektuale të ditëve tona dhe ish-udhëheqësive komuniste do të thotë se vështirë se do të ketë ndonjëherë një proces të pavarur për të hedhur dritë mbi krimet e një prej diktaturave më brutale në botë. Ish-ministra të pas viteve '90 kanë kërkuar eshtrat e të afërmeve të vet, por nuk e kanë vrarë mendjen të kërkojnë edhe për të tjerët. Familjarët e viktimave të komunizmit kërkojnë vetëm varret e të afërmeve.

Regjimi komunist i Enver Hoxhës njihet si më monstruozi, që ndiqte me besnikëri modelin stalinist. Njerëzit shpallehin armiq për arsye personale. Ekzekutoheshin pasi qenë kapur apo thjesht qenë akuzuar se kishin vjedhur. Shumë vrasje apo burgosje qenë viktime anësore të makinës së stërmadhe të propagandës. Qe një Frankenshtajn që në fund të viteve '70 dhe në fillim të viteve '80 doli nga kontrolli i krijuesve të vet. Në këtë kohë, çdokush mund të dyshohej si spiun apo armik. Ekzekutuesit mund të bëheshin të ekzekutuar, gjë që në fakt ndodhi në shumë raste. Megjithatë, pavarësisht torturave, në kulm të dhunës pati shembuj trimërie të pashoq ose sakrifikimi me vetëdije. Një vlonjat deklaroi me shkrim para një prokurori se "ka qenë, është dhe do të mbetet armik i regjimit".

Eshtrat e zbuluara së fundmi, në një ish-bazë ushtarake të njohur si Reparti 313, janë një pjesë shumë e vockël e

mijëra njerëzve që u ekzekutuan nga regjimi komunist. Por ndërsa vendi pret 20-vjetorin e rënies së regjimit komunist, politikanët në Tiranë, si majtas, ashtu edhe djathtas, parapëlqejnë të gjejnë se kush është më shumë fajtor për të shkuarën, në përpjekje për të fituar kapital politik nga trauma shoqërore dhe njerëzore e regjimit stalinist.

Akuzat e egra janë të zakonshme në diskutimet politike në Shqipëri. Gjatë muajve të fundit, Edi Rama dhe Sali Berisha e kanë akuzuar njëri-tjetrin për çdo gjë, nga skizofrenia te fashizmi, si pasojë e një debati të ashpër që erdhi nga zgjedhjet me rezultat shumë të ngushtë të vitit të kaluar. Si Berisha, ashtu edhe Rama, duket se duan të bindin njerëzit se jeta është e pavlerë në rast se ata nuk e kapin ose nuk e mbajnë postin e Kryeministrit. Për pasojë, çdo gjë që publikohet duhet që të diskutohet dhe debatohet në atë formë që atyre u intereson. Gjithsesi, për familjet e atyre që u ekzekutuan dhe që janë ende pa një gur varri, fati i të dashurve të tyre është më e rëndësishme sesa beteja mondane për pushtet që duket se është e pafundme në Shqipëri.

Këto varre të zbuluara do të kenë në këtë mënyrë një shpjegim se pse Shqipëria nuk duhet të përballet kurrë më me fatkeqësi të tilla. Tentativa për të nxjerrë përfitime politike nga trauma kolektive që krimet e komunizmit lanë pas, siç kanë bërë politikanët në dy dekada, thjesht sa e shton dyshimin se ata mbesin skllevër të së shkuarës – një periudhë kur varret e atyre që u ekzekutuan për arsye politike qenë të fshehura aq mirë sa të mos gjendeshin kurrë. ■



Keqtrajtohen prindërit

Në kronikat policore janë shpeshtuar raportet sipas të cilave fëmijët i keqtrajtojnë prindërit e tyre. Sipas sociologut Shemsi Krasniqi, këto janë defekte të sjelljes që ndodhin në rastet e problemeve të theksuara sociale. Ndërkohë, psikologja Melita Kallaba shpjegon se rastet e keqtrajtimit të prindërve nga fëmijët rriten për shkak të përhapjes së alkoolizmit, drogës dhe sjelljeve të tjera që nxisin ftohjen e marrëdhënieve familjare



Agim FAZLIU

Vitet e fundit janë shpeshtuar raportet, në të cilat jepen detaje për fëmijët që i keqtrajtojnë prindërit e tyre. Rrëfimet janë të trishtueshme. Vajza e ka goditur babanë e vet me shufër në kokë, pas një konflikti verbal, në një familje që jeton në fshatin Bërnice të Prishtinës. Policia ka njoftuar se një nënë, që banonte në rrugën "Ismajl Ismajli" në Prishtinë, është sulmuar fizikisht nga djali i saj. Në fshatin Dobërdolan të Suharekës, një nënë ka raportuar në polici se ishte sulmuar fizikisht nga djali i saj. Një burrë, që banon në rrugën "Xhevat Berisha" në Prizren, është ankuar në polici se është sulmuar nga djali e tij, i cili është përdorues i substancave narkotike.

Kronika të tilla rrëqethëse janë të izoluara, por ato vënë në pikëpyetje shenjtërinë tradicionale të prindërve në familjet shqiptare. Mund të përipihen shumë gjëra të këqija, por rrahja e

nënës është ndoshta më e vështira për t'u kuptuar. Sipas sociologut Shemsi Krasniqi, dhuna e fëmijëve ndaj prindërve është sjellje shumëdimensionale, goxha e vështirë për t'u shpjeguar. Ai tha se kjo bëhet më bizare kur jemi mësuar të dëgjojnë për dhunën që ushtrojnë prindërit ndaj fëmijëve. E kundërta ndodh më rrallë, zakonisht në rastet e problemeve të theksuara sociale, të ngarkuara me lëkundjen e ekuilibrit psikik të personave të caktuar. "Përhapja e lojërave kompjuterike i ka 'egërsuar' fëmijët. Depërtimi i tyre shpirtëror, thellë në 'tripat' e lojës virtuale bën që ata të kundërshtojnë shumëçka tjetër në botën reale". Sipas Krasniqit, nëse prindi heziton t'i japë të holla fëmijës, sepse dëshiron që ta largojë nga varësia ndaj kompjuterit, ky i fundit reagon në mënyrë të dhunshme, manifeston sjellje të ftohtë dhe bëhet jo i dëgjueshëm.

Virtualizimi i jetës është bërë mjedis ushqyes për arrogancën. Sipas psikologes Melita Kallaba, prindërit nuk duhet që të insistojnë që ta ndalojnë në mënyrë të dhunshme fëmijën e vet që bën sjellje të pahijshme, sepse kështu nxisin reagime të ashpra nga ana e tyre.

"Fëmijët që ushtrojnë dhunë mund

të kenë simptoma të sëmundjeve psikike. Është mirë të përdoret metoda e shpërblimeve, për ta inkurajuar fëmijën që të largohet nga një sjellje e keqe". Kallaba tha se rastet e keqtrajtimit të prindërve nga fëmijët e tyre janë shpeshtuar për shkak të përhapjes së alkoolizmit, drogës dhe sjelljeve të tjera që nxisin ftohjen e marrëdhënieve familjare.

Sipas saj, personat që janë të dhunshëm në personalitetin e tyre, në një moment e shfaqin agresivitetin edhe në sjelljet e jashtme. "Kjo deri-diku është e trashëguar gjenetikisht. Kur ballafaqohen me ndonjë situatë konfliktuale, këta tipa janë të prirë të ushtrojnë dhunë". Kallaba, e cila punon si psikologe në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, tha se në vendet që dalin nga lufta, siç ka ndodhur në Kosovë, personat e dhunshëm janë në numër shumë më të madh, sesa në vendet me të kaluar më paqësore. Sociologu Shemsi Krasniqi mendon se modeli tradicional i familjes është në krizë, sepse mbijetesa në kushte të reja është e vështirë. Edhe modeli bashkëkohor, po ashtu, nuk është i përkryer, sepse është i mbërthyer nga kriza materiale, sociale e morale. ■

Strehimorja – Shtëpia e dytë

Gjatë vizitës që i bëmë kësaj shtëpie, shumica e pleqve ishin duke i bërë shoqëri njëri-tjetrit. Disa luanin shah, gratë punonin punë dore. Secili kryente ndonjë punë



Dukagjin AVDYLI

Strehimorja e të Moshuarve në Prishtinë, që funksionon në kuadër të Departamentit të Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), është vendi ku 88 të moshuar, mbi moshën 65 vjeçare, kanë gjetur ngrohtësinë familjare, e cila më parë ishte një gjë e huaj dhe imagjinare për ta. Lumturia dhe familja për këta të moshuar ishte imagjinare, ngase këta njerëz, përveç Zotit që ua dha jetën, nuk kishin askënd tjetër për t'u dalë në ndihmë dhe në mbikëqyrje, në kohën kur ata më së shumti kishin nevojë.

Edhe pse shteti dhe qeveritë, që shkojnë e vijnë, janë kritikuar e kritikohen për moskujdesje ndaj shoqërisë dhe kategorive në nevojë, në Strehimoren e Pleqve në Prishtinë dëshmohej e kundërta, të paktën sa i përket kësaj shtrese të shoqërisë. Falë kujdesit që tregon Qeveria e Kosovës, konkretisht MPMS, përmes udhëheqësve të kësaj strehimoreje, këta të moshuar thonë se, sa t'ju falë Zoti jetë, çdo moment të saj do të donin ta kalonin në ambientet e strehimores.

Për këta të moshuar kujdesen 60 punëtorë për 24 orë rresht, me në krye drejtoreshën e tyre, znj. Raze Aliqkaj, e cila punën me këtë kategori e cilëson si obligim dhe, njëherësh, si kënaqësi që mund të punojë për njerëzit, të cilët kanë shumë nevojë për kujdes të veçantë, ngase këta individ janë të vetëm, pa askënd.

Gjatë ditës, pleqtë e strehuar aty ushqehen tre herë: në mëngjes, në drekë dhe në darkë. Mënyrë me të cilën ata ushqehen, shumëkush nga ne do të dëshironin ta kishte edhe në shtëpi. Por jo çdokush mund të ushqehet ashtu, ngase investimet që bëhen në këtë strehimore nuk



do të mund t'i përballonte xhepi i një kryefamiljari të zakonitë.

Veç të tjerash, ushqimi, pijet, pemët dhe perimet, për ata të cilët përballen me diabetin, hipertensionin e sëmundje të ngjashme, përgatiten në mënyrë të veçantë, gjë që ua lehtëson atyre shumë problemet shëndetësore.

Znj. Raze Aliqkaj rrëfen për punën që bën në këtë institucion. Shërbimin ndaj të moshuarve, në këtë institucion, ajo mbi të gjitha e sheh si gjest moral dhe human, që siç thotë ajo "ua kemi borxh kësaj shtrese të shoqërisë".

Sipas saj, në këtë vend janë strehuar njerëz nga të gjitha rajonet e Kosovës,

të të dy gjinive, të gjitha etnive dhe normalisht pa dallime fetare, kujdesi ndaj të cilëve bëhet i njëjtë pa asnjë dallim, sepse siç thotë ajo "të gjithë këta persona kanë jetë dhe meritojnë të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme. Ajo na tregon edhe për organizimin e festave brenda këtij institucioni. Të gjitha festat organizohen në mënyrë të veçantë. Veshmbathjet, ushqimi dhe argëtimi për këta të moshuar, gjatë festave, dallojnë nga një ditë e zakonshme.

Kjo strehimore ekziston që para 40 viteve. Nga periudha e paraluftës e deri në qershor të vitit 2006, në këtë strehimore, e cila është quajtur "Nënë Terëza", janë strehuar njerëz të moshuar të

ë për të moshuarit

kategorive të ndryshme, deri në vitin 2004. Pas qershorit të vitit 2004, personat që merren në mbikëqyrje nga ky institucion, duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila me një udhëzim administrativ ka marrë vendim që personi që mund të pranohet duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas i përhershëm i Kosovës,
- Të jetë mbi moshën 65 vjeçare,
- Të jetë person për të cilin nuk përkujdeset askush dhe
- T'i posedojë certifikatat nga mjeku infektolog dhe nga specialisti psikiatër, të cilat dëshmojnë se personi, i cili vendoset aty, është në gjendje të mirë shëndetësore dhe mentale.

Meqenëse këtu janë të vendosur persona, të cilët nuk kanë familje dhe as përkujdesje nga askush, të gjitha shpenzimet i financon MPMS, për çka drejtoresha znj. Aliqkaj thotë se: 'nga Ministria tregohet kujdes i veçantë dhe investohet shumë, kur kihen parasysh shpenzimet për ta.'

Vendosja e tyre mundësohet përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS), nga të gjitha komunat, në bazë të kriterëve të vendosura nga MPMS-ja.

Nëpunësit e qendrave për punë sociale e plotësojnë dokumentacionin për këta individë. Ato dokumente i verifikon komisioni që funksionon në kuadër të strehimores. Pasi ky komision të ketë vendosur që dokumentacioni është në rregull jep dritën jeshile, pastaj vendimin për pranimin në Strehimore e merr drejtori i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Strehimorja ofron gjithashtu edhe kujdesin shëndetësor në të cilin janë të angazhuar mjekja e përgjithshme, stomatologia, teknikja e stomatologjisë, ndihmës mjeket dhe infermierët, të cilët punojnë 24 orë, madje edhe frizeri është aty për t'u kujdesur për dukjen e tyre.

Në këtë shtëpi të madhe ka shumë gjëra që të lënë gojëhapur, për të mirë. Aty jeta është e organizuar shumë mirë, madje synohet që këtyre të moshuarve t'u kalohet koha më lehtë. Organizohet edhe terapia e punës së dorës dhe viza-timeve, e cila ishte mbresëlënëse.

Ashtu si edhe personat e tjerë të moshuar, edhe këta të strehimores e gëzojnë pensionin nga buxheti i Kosovës gjithashtu edhe nga 10 euro nga MPMS-ja, të holla këto, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për të blerë duhan, për të pirë ndonjë kafe në qytet, ose për gjëra të tjera, të cilat ata duan t'i kenë, përveç gjithë atyre që ua ofron kjo strehimore.

Këta pleq mund të vizitohen nga të afërmit e tyre, të cilët mund edhe t'i marrin për vizitë në shtëpitë e tyre. Por për ta gëzuar këtë të drejtë, personat, të cilët i marrin ata duhet paraprakisht ta kenë lejen nga QPS, në komunën nga e cila vijnë, kjo për sigurinë e të moshuarve.

Në kuadër të strehimores ekziston edhe sera për kultivimin e perimeve, të cilën punëtorët, së bashku me pleqtë, e punojnë gjatë verës. Pleqtë nuk janë të obliguar të punojnë në këtë serë, por këtë e bëjnë në mënyrë që ta kalojnë kohën dhe nga ndjenja për të dhënë edhe ata një kontribut modest në "shtëpinë e tyre", e cila është më shumë se shtëpi për ta në këtë moshë dhe në gjendjen shpirtërore dhe fizike që janë.

Strehimorja ka edhe klubin e rezydentëve, në të cilin pleqtë mund të luajnë letra, domino, shah, të lexojnë libra, revista etj, si dhe të shikojnë televizor. Ne vizituam këtë klub dhe, siç e pamë, ai iu ofronte të moshuarve kushte shumë të mira për t'u argëtuar dhe për ta kaluar një pjesë të kohës aty.

Secili nga ata që pranohet në këtë strehimore mund ta

marrë me vete edhe bashkëshortin/en, por ka të atillë që e gjejnë brenda mureve të strehimores "personin e zemrës".

Ata mund të zgjedhin vetë se me kë nga banorët e atyshëm duan ta ndajnë dhomën, me një shok ose dy, me një shoqe a dy. Por ka edhe nga ata të cilët duan të jetojnë vetëm, ngase atyre u mundësohet edhe kjo gjë.

Në këtë qendër tregohet kujdes i veçantë edhe për risocializimin e tyre. Me këtë proces, nëpër të cilin duhet kaluar patjetër, merren të gjithë punëtorët, e në veçanti punëtori social, madje edhe vetë drejtoresha e kësaj strehimoreje, znj. Raze Aliqkaj, e cila me një vullnet të çeliktë, fytyrë të buzëqeshur, bisedë të ngrohtë dhe, mbi të gjitha, me ndjeshmërinë e saj prej bije, kujdeset për këtë shtresë të shoqërisë sikur të ishin prindërit e saj. Z. Aliqkaj thotë se është kënaqësi të punosh për ta sepse mbi të gjitha obligimi moral e social na bën që të jemi të sjellshëm dhe korrekt ndaj tyre.

Duke folur me kujdes të veçantë, znj. Aliqkaj na rrëfen se me këtë shtresë gjithmonë duhet të jesh në disponim të mirë, ngase përveç moshës së thyer që kanë, ata preken shumë lehtë në sedër ngaqë janë pa familje të vërtetë.

Në kuadër të këtij institucioni, vitin e kaluar janë ndërtuar edhe dy strehimore: njëra në Gurrakoc të Istogut, tjetra në Skenderaj dhe një është duke u ndërtuar në Mitrovicë. Kapaciteti i tyre është deri në 20 persona dhe këto shtëpi janë shumë moderne, në mënyrë që të moshuarve t'u ofrohet ngrohtësia familjare, e cila u mungon në vazhdimësi. Qëllimi i ndërtimit të tyre ka qenë që në



Raze Aliqkaj

këto strehimore të vendosen persona nga ato rajone, në mënyrë që t'u bëhet më e lehtë vizita nga të afërmit dhe ta kenë më afër vendlindjen kur duan ta vizitojnë. Por, ka edhe nga ata që edhe pse u është dhënë mundësia të shkojnë në strehimoret e Gurrakocit dhe Skenderajt, nuk kanë pranuar ngase janë akomoduar mirë dhe janë adoptuar në Strehimoren e Prishtinës.

J. T. një plakë e urtë dhe e mençur nga Peja, banore në Strehimoren e Prishtinës, thotë se dëshiron të dalë nga kjo shtëpi vetëm atëherë kur të ndërrojë jetë. E mbytur në lot nga mërzia dhe zhgënjimi prej djalit që e kishte birësuar dhe ia kishte kushtuar jetën, i cili tash e shtatë vite e kishte braktisur, thotë se edhe po t'i faleshin të gjitha ndërtesat përreth strehimores dhe po t'i jepej një qytet i tërë, ajo nuk do t'i merrte në këmbim të strehimores: "Këtu e kam gjetur atë që më ka munguar për një kohë të gjatë, e kam gjetur respektin, dashurinë dhe kujdesin që nuk ma ofroi djali që e rrita dhe ia kushtova tërë jetën".

Ndërkaq I. Z., një i strehuar tjetër, që jeton që 25 vite në strehimore na tha: "Nuk kam ku të shkoj, por edhe këtu po ndihem shumë mirë. I vetmi hall imi është që ta marrë letërnjoftimin e Republikës së Kosovës, se tutna mos po mbes pa pension". Plakut të lindur më 1930, i kishin humbur dokumentet e kohës së Serbisë dhe iu kishte komplikuar puna me to. Por, zyrtarët e strehimores thanë që po merren me atë çështje dhe që kanë qenë disa herë në Pejë për t'ia rregulluar dokumentet, por kanë hasur në probleme për shkak se nuk figuron askund emri i tij në zyrat përkatëse. Në pyetjen se sa janë korrekt punëtorët e kësaj strehimoreje I. Z. thotë: "Janë shumë të mirë dhe të saktë në punë dhe kujdesen shumë për neve".

Gjatë stinëve të pranverës, verës dhe vjeshtës, punëtorët e strehimores organizojnë shëtitje për pleqtë nëpër vendet më të bukura të Kosovës siç janë: Gryka e Rugovës, Mirusha, Prevala, si dhe vende e restorante të ndryshme.

Sipas drejtoreshës, ky institucion ka një bashkëpunim të madh me QKUK-në. Ajo thotë se punëtorët në spital kanë treguar në vazhdimësi kujdes të veçantë për këta persona, për çka ajo u është shumë mirënjohëse.

Këta pleq shpeshherë vizitohen edhe nga nxënës të shkollave të ndryshme, të cilët sjellin dhurata modeste për ta, dhurata, të cilat i bëjnë tejet të lumtur të moshuarit, kur nxënësit, duke ua dhënë dhuratat, i quajnë gjyshe ose gjysh.

Në kuadër të gjithë këtij objekti strehimor ekziston edhe morgu, i cili shfrytëzohet për të moshuarit që ndërrojnë jetë aty. Në rast vdekjeje, njoftohet farefisi i të strehuarit, që nëse duan ta varrosin të afërmin e tyre në vendlindje, mund ta bëjnë këtë. Strehimorja kujdeset edhe për transportin e kufomës, deri në vendlindje. Mirëpo, në rast se askush nga të afërmit e të vdekurit nuk dëshiron ta kryejë ceremoninë e varrimit të atyre personave, atëherë punëtorët e strehimores kujdesen edhe për këtë punë dhe varrimin e tyre e bëjnë në varrezat e qytetit në Dragodan.

Nuk na mbetet tjetër të themi përveçse t'ia rikujtojmë vetes dhe të tjerëve që kjo jetë është e shkurtër, e ta jetojmë me dinjitet dhe nder siç na ka hije duke respektuar të tjerët dhe duke mos i harruar kurrë obligimet ndaj të vjetërve. T'i respektojmë dhe t'i përkrahim të vjetrit edhe për arsyen se kemi obligim që të kemi kujdes për ta. Dhe asses të mos harrojmë se një ditë do t'i përkasim kësaj kategorie. ■



Autizmi

Ejup GASHI

Saktësisht nuk dihet numri i fëmijëve në Kosovë që vuajnë nga autizmi. Shfaqjet e këtij çrregullimi psikoemocional dallojnë varësisht nga shkalla e zhvillimit dhe moshë e personit. Në qoftë se fëmija nuk tregon sinjale afrie ose nuk dëshiron të ketë kontakt fizik me askë qysh në moshë shumë të re, ka mungesë të kontaktit sy më sy, nuk ka reagime të fytyrës, nuk përgjigjet, as nuk reagon kur e thërrasin prindërit, atëherë këto janë indikacionet e para të autizmit. Autizmi trajtohet, nuk shërohet. Shkaqet e këtij çrregullimi janë ende të panjohura, por studimet tregojnë që faktorët gjenetikë janë me rëndësi. Simptomat e çrregullimit të autizmit shfaqen para se fëmijët t'i kenë 3 vjet dhe më të shpeshta janë rastet te meshkujt sesa te femrat.

Autizmi në Kosovë trajtohet vetëm në mënyrë simptomatike dhe nuk ka ndonjë program të sistemuar, edhe pse fëmijët me autizëm kanë nevojë për qendra të specializuara, me ekip të trajnuar për të punuar me ta dhe njëkohësisht për klasa ku ata vijnë shkollën. Ministria e Shëndetësisë premtonte programe për këta fëmijë, duke krijuar mundësitë për hapjen e qendrave të specializuara për këtë kategori.

Në kuadër të SOS fshatit të fëmijëve në Kosovë vepron një Qendër për Zhvillim dhe Rehabilitim të Hershëm "Shtëpia e bletëve". Kjo shtëpi merret me fëmijët që nuk kanë aftësi zhvilluese, me fëmijët autistë dhe me fëmijët të tjerë që kanë nevojë për lloje të këtylla rehabilitimi. Në vitin 2007, në shkollën fillore "Ismail Qemali" në Prishtinë, me ndihmën e prindërve të fëmijëve autistë dhe shkollës është formuar një paralele e posaçme për fëmijët me autizëm, por me kapacitete të kufizuara.


Së shpejti në Kosovë pritet të formohet organizata joqeveritare për fëmijët autistë "Autizmi flet". Misioni i kësaj organizate është të ndihmojë në integrimin dhe përmirësimin e jetës sociale të njerëzve autistë.

Autizmi

Kriza ekonomike dhe autizmi

Kriza ekonomiko-financiare që ende nuk ka kaluar, e që e pati zanafillën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është analizuar dhe vazhdon të analizohet. Sigurisht, më së shumti, nga financierët dhe analistët e ekonomisë për të nxjerrë mësim për të ardhmen. Por ndërkohë, në lojë kanë hyrë edhe psikologët që tentojnë të shohin aspekte të tjera të krizës. Në këtë drejtim ka nga ata që kanë bërë së fundi një pyetje të tillë? A u shkaktoi kriza e fundit ekonomike nga njerëz që ndër karakteristikat e tyre kryesore kishin edhe një formë të butë të autizmit, që ndryshe njihet me emrin sindroma e Aspoerger? Sjellja e njerëzve të tillë me këtë formë autizmi, karakterizohet, mes të tjerash, edhe nga një pamjaftueshmëri e asaj që quhet "mendja teorike", që është aftësia për të kuptuar diversitetin e njerëzve të tjerë, faktin se ata kanë besime dhe pika referimi të ndryshme nga tonat. Sipas psikologëve, një mungesë e tillë, e vënë re te një numër njerëzish me pozicione shumë të rëndësishme vendimmarrëse, mund të ketë shkaktuar një pjesë të krizës, sepse persona të tillë nuk arrijnë dot që të konceptojnë me mendjen e tyre opinionet e ndryshme, e për më tepër sjellja e personave të tillë është e paparashikueshme. Kështu, ndaj shumë krerëve të bankave, deri para fillimit të krizës, ekzistonte ideja se ishin nën kontroll të vazhdueshëm të situatës e për më tepër ishin të pagabueshëm, mendim që sigurisht u përmbys kur bankat e tyre, të mëdha e të vogla i shtrinë dorën shtetit për ndihmë mbijetese. Gjithashtu, para krizës kishte një refuzim të përgjithshëm për të pranuar qoftë edhe një mundësi të vogël të gabimeve të sistemit financiar, ose qoftë edhe të të dhënave. Nuk janë për t'u harruar gjithë siguritë që dhanë bankierët para krizës për fuqinë dhe gjendjen e mirë të sistemit financiar dhe atij bankier. Familjarët e personave që vuajnë nga një simptomë e tillë e dinë fare mirë se përse bëhet fjalë. Këta njerëz janë shumë të dhënë pas të dhënave dhe

modeleve të caktuara dhe manifestojnë vazhdimisht një mungesë vullneti për t'u përfshirë në parjen e të gjithë situatës dhe jo vetëm të një segmenti të saj. Po të shohim me vëmendje këto tipare të të sëmurëve me simptomën Asperger ato ngjasojnë shumë me simptomat e vetë sistemit financiar dhe bankier në vitin 2007, pra në vitin e shpërthimit të krizës. Sigurisht që nuk bëhet fjalë për një person a dy, por për një sistem të tërë financiar që refuzoi të shihte atë që po ndodhte, pra rrokullimën drejt gremisë e që është më e keqja vazhdon të mos shohë edhe sot atë që duhet ndryshuar rrënjësisht. Një tjetër karakteristikë e njerëzve me simptomën e Aspergerit është se ata janë shumë imunë ndaj presioneve sociale. Në rastin më të mirë nuk i njohin dhe nëse i njohin nuk e vënë ujin në zjarr duke i konsideruar të parëndësishme. Në shumë mënyra, ata mund të krahasohen si fëmija në përrallën e Hans Kristian Andersenit "Rrobat e Mbretit". Në këtë përrallë Mbretit iu shit një kostum i ri i bërë nga një material i veçantë, por i dukshëm vetëm për sytë e atyre që meritonin pozicionin që kishin në oborrin mbretëror. Për të tjerët, pra ata që nuk e meritonin, Mbreti do të



dukej lakuriq. K o s t u m i sigurisht që nuk ekzistonte dhe ishte një mashtrim, por njerëzit që ndodheshin në pritje, duke pasur frikë të thoshin se Mbreti ishte lakuriq, sepse një gjë e tillë mund të merrej ndryshe, thanë se kostumi i ri i Mbretit ishte i mrekullueshëm. Më në fund Mbreti has në një fëmijë që me sinqeritetin e çiltërsinë e moshës i thotë Mbretit të vërtetën, pra që ishte

Ç'është Autizmi

Autizmi është paaftësi zhvilluese e përgjithshme, e cila ndikon në mënyrën se si personi a fëmija komunikon dhe silllet me njerëzit rreth tyre. Fëmijët dhe të rriturit me autizëm kanë vështirësi të kenë afërsi me të tjerët në mënyrë të thjeshtë. Në përgjithësi, aftësitë e tyre për të zhvilluar shoqëri dhe aftësia e tyre për të kuptuar shprehjet emocionale të njerëzve të tjerë janë të kufizuara. Njerëzit me autizëm shpesh mund të kenë paftësi të tjera, por çdo njeri me këtë gjendje ka vështirësi të kuptojnë gjërat në botë. Autizmi është një çrregullim, i cili është mjaft i diskutueshëm në raport me prognozën dhe arritjen përfundimtare të trajtimit. Sidoqoftë, trajtimi i autizmit kërkon një qasje multidisiplinare dhe një sistem ligjor, i cili lejon që fëmija ose individi, i cili vuan nga ky çrregullim, të marrë maksimumin e përkujdesjes.

lakuriq. Kjo është sjellje tipike e njerëzve që ndjekin turmën ose të dhënat e caktuara pa qenë të aftë vetë të bëjnë një analizë të situatës. Një sjellje e tillë masive prej kopeje deleje çon në krijimin e "fluskave", siç ishte ajo e pasurive të patundshme. Të gjithë amerikanët, në vitin 2005 nisën që të marrin kredi të mëdha e të blinin shtëpi, sepse të gjithë e bënë një gjë të tillë dhe sepse ekzistonte mendimi që çmimet do të vinin duke u rritur. Moda, apo më mirë modelet janë një forcë e madhe mpirëse dhe njerëzit kanë tendencë që të mendojnë se tjetri gjithmonë është më i zgjuar se ata. Psikologët mendojnë se edhe tani pasi kriza mori në qafë shumë njerëz, këta të fundit në pakicë janë të ndërgjegjësuar për faktin se tani e mbrapa duhet të jenë më të kujdesshëm kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me jetën. Vetëm disa janë të ndërgjegjësuar në atë masë sa të kenë nxjerrë mësimin e madh të kësaj sate se një ndjekje e pamenduar e turmës të bën shumë dëm dhe se në këtë rast fajtori je vetëm ti. ■

BIG BROTHER apo B



Prof.dr. Naser RAMADANI

Çfarë të shohësh te fqinjët, prite te dera". Kjo urti popullore na mëson që të mos befasohe mi me asgjë që shohim se ka ndodhur diku afër ose larg nesh. Jetojmë në botën e të papriturave. Ato e diktojnë jetën tonë, mënyrën e të jetuarit.

Mediet janë bërë diçka pa të cilën s'mund të paramendohet ritmi normal i jetës. Në çdo moment përballësh me to. Janë pikërisht ato që e trullojnë opinionin, që e bëjnë atë të varur më shumë sesa nga narkotikët.

Bosët, manjatët e medieeve, ditë e natë, mendojnë se çfarë do të ishte më interesante dhe se çfarë do të ishte më tërheqëse, ashtu që të jenë edhe më profitabile.

Kohëve të fundit, në këtë sens, mund të flitet për spektaklin e ashtuquajtur "Big Brother". Fillimisht, si nocion,

është zhvilluar nga fabrika televizive argëtuese holandeze "Endemol" dhe është shpërndarë në mjaft shtete, pra edhe në Shqipëri e Kosovë.

Gjykuar më shumë racionalisht sesa emocionalisht, konceptit "Big Brother" duhet t'i hiqet një r, me ç'ka do t'i jepet haku. Pra, "Big Brother" është "Big Bother". Është shqetësim, bela, bezdi, ngacim dhe mëzë e madhe. "Big Brother" nuk ka ndonjë mision tjetër, përpos të na ngacmojë dhe shqetësojë.

Janë disa arsye që shtyjnë kundër këtij të ashtuquajtur *reality show*. Para së gjithash, shtrohet pyetja se kush është ai '*filantrop*' që ka aq shumë që të harxhojë aq pa lidhje në këto kohë krizash, kur një pjesë e madhe e popullatës lufton për kafshatën e bukës apo edhe është buzë greminës ekzistenciale?! Nëse matanë kufirit me 'Big Brother' deshën të imitojnë ose kopjojnë diçka që është sensacionale apo spektakulare për dikë, a ishte e patjetërsueshme të shpejtohej me 'Shpinë e Kosovës'?! Çfarë realisht synohet me këto të ashtuquajtura *reality show*?! Cili është qëllimi kryesor që po bëhen kaq shumë shpenzime?!

Shikuar nga aspekti psikologjik, survejimi live 24 orë i banorëve nuk mund të japë asnjë të dhënë shkencore për sjelljet njerëzore. Banorët janë strukturë heterogjene me pak pika të përbashkëta dhe prej tyre nuk pritët të japin rezultate të kënaqshme studimore për mënyrat e të sjellit. Ata të futur siç thuhet në një kafaz, do të jenë të detyruar vetëm se të llomotisin gjëra të kota e të pavlera, biseda që s'i hynë në punë askujt. Në disa raste ata edhe mund të zihen, por kjo s'paraqet diçka të panjohur. Pra, në esencë, shikuar edhe në aspektin e përgjithshëm, kjo mënyrë edhe nëse mendohet se është metodologji eksperimentale e të vëzhguarit të sjelljeve njerëzore, prapëseprapë nuk shkon si ide, sepse vetë fakti se banorët janë të vetëdijshëm se survejohen, do të thotë se ata s'mund të jenë origjinal në asnjë mënyrë. Madje eksperimentimi i tillë nuk është i moralshëm as për eksperimentuesit, as për të eksperimentuarit dhe bile as për vëzhguesit. Tingëllon normale të mësosh se si janë testuar kaviet në kafaz, por jo edhe njerëzit. Në shtetet perëndimore ka pasur shumë

REALITY SHOW | BIG BROTHER ALBANIA 3



Një ndër formatet e Reality Show më të suksesshëm në botë, prodhim i kompanisë Endemol, Holandë, vjen në sezonin e tij të tretë në Shqipëri, pas suksesit të mëparshëm, prodhuar nga Top Channel. Personazhe e karaktere të zgjedhur me shumë kujdes në baze të profileve të tyre psikologjike e social-kulturore do të jetojnë për 14 javë rresht në një shtëpi së bashku. I gjithë votimi i personazheve vjen nga publiku dhe personazhi me i admiruar prej tij fiton çmimin e madh. Ky është një show që në stafin e tij ka psikolog, ku skenaristi është pjese e prodhimit gjatë gjithë kohës, ku i gjithë zhvillimi i tij varet nga evoluimi i personazheve. Formatit me fame botërore e sukses te padiskutueshëm në të gjithë botën, Reality Show "Big Brother" është realizuar ne Holandë në vitin 1999 dhe është "klonuar" pastaj ne rreth 70 vende te botes. Normalisht personazhet mbyllen e bashkëjetojnë së bashku për gati 100 dite në një shtëpi dhe shkëpusin kontaktet nga realiteti, ndërsa realiteti i ndjek ata nëpërmjet transmetimeve direkt. Është i bazuar ne 4 realitete baze: përballimi i jetesës së përditshme, sistemi i përjashtimit, çdo jave ka një detyre nga Big Brother, dhe këtë herë ka shume surpriza qe do ta bëjnë Big Brother Albania 3 me te jashtëzakonshëm se kurrë.



BIG BROTHER?!



reagime nga politikanët, ministrat dhe kryeministrat, të cilët kanë kërkuar ndalimin e këtyre spektakleve për shkak të lëndimit të dinjitetit njerëzor. Po ashtu, kundër kanë qenë edhe organizatat religjioze. Te ne, për çudi, ka pak reagime, që janë të papërfillshme.

Sado 'vlerë' të paraqiste kjo ide për banorët, sipas projektuesve të këtij spektakli, prapëseprapë, edhe për banorët kjo nuk paraqet kurrfarë domethënie të vlefshme, sepse i mban në një ankth të panevojshëm, mu ashtu siç i mbajnë bastoret sportive shumë badihavaxhinj. Shikuar hollësisht, kjo nuk ka vlerë afatgjate as për fituesin eventual, sepse zgjon tek ai ndjenjën e plogështisë, limontisë dhe dembelisë; po ashtu edhe idenë se, në jetë, qenka e mundur të arrihet deri te fitimi edhe me budallallëqe të shumta. Efekti tjetër negativ psikologjik te publiku është se i bën njerëzit, në veçanti të rinjtë, të ethshëm për të arritur deri tek ëndrra që realisht nuk mund ta arrijë gjithsecili. Kjo u humb atyre kohën e çmuar, të cilën mund ta kalojnë në mënyrë më produktive pranë librit ose kompjuterit. Shikimi i këtij spektakli i mban ata peng të një loje pa mbarim, duke i bërë të harrojnë problemet më esenciale për të cilat duhet të vendosin. Ata rrinë në pritjen e skandaleve publike, që

zgjojnë kureshtje banale. Ata provokohen nga veprimet e personave të pagdhundur. Të krisurit bëjnë veprime të papjekura para kamerave dhe nxisin polemika jashtë kafazit të tyre.

Në aspektin pedagogjik, nga shikimi i këtij spektakli s'mund të përfitohet asnjë mesazh edukativ, e lëre më arsimor. Nga aspekti sociologjik, shfaqjet e tilla pasqyrojnë një miniaturë të një psikodrame e sociodrame të mjerë, ngase sa herë që do të nxjerrësh diçka, e sheh se s'ke se çfarë të nxjerrësh. Shikuar estetikisht, ky *spektakël live* është i pakripë, pa skenar, pa komponentë artistike dhe, thjesht, pa kurrfarë shije. Prandaj i vetmi përfitues është ideatori dhe gjithë mbështetësit mediatikë të këtij spektakli, të cilët interesin e tyre e kanë të lidhur vetëm me biznesin dhe asgjë tjetër. "Big Brother" është një "show" komercial, është një makinë parash. Duke e parë këtë realitet, që në të vërtetë është suprem kur kemi të bëjmë me këso shfaqjesh të pakripa, atëherë nuk do të

Si propagandohet.

Big Brother tashmë është në rrugëtim e sipër.

Me mijëra teleshikues ndjekin çdo orë, çdo minutë e çdo sekondë atë që po ndodh me banorët e shtëpisë më të famshme të Shqipërisë. Ata kanë aritur të fitojnë zemrat e të gjithëve. Por e shtuna po afron...

Ç'të re do sjellë ajo për ta?

Një zarf i kuq pret për t'u hapur...

Çfarë ka brenda tij?

Çfarë surprize ka rezervuar Vëllai i Madh për ata dhe për publikun?

Ata mendojnë se kanë parë dhe kanë prekur gjithçka... por aventura sapo ka filluar!

Këtë të shtunë, vendimi që ndodhet brenda në këtë zarf do të ndryshojë krejtësisht jetën e tyre dhe do të përmbysë totalisht rrjedhën e ngjarjeve.

ishite e ndershme nga ideatori, sponsorët dhe gjithë ata që qëndrojnë pas, që t'i keqtrajtojnë të rinjtë me këso gjëra të pavlera. Qëllimi i tyre është të japin diçka

të mërziqshme, që megjithatë nuk do të duket e mërziqshme për mentalitete adoleshentesh. Çfarë do të pasojë pas "Big Brother-it"? Televizionet në të ardhmen do të inskenojnë gjëra në mënyrë shumë më të drejtpërdrejtë. Sigurisht do të thyhen edhe më shumë tabu, edhe pse sot na duken të patejkalueshme. Me gjasë do të ketë, madje, gjëra edhe më të poshtra sesa sharje të fëlliqura, rrahje të paskrupullta dhe aleanca djallëzore.

Mediet, krahas rolit informativ e argëtues, para së gjithash, duhet të kenë edhe rol edukativ.

Megjithatë, fatkeqësisht, pikërisht aspektet edukative janë ato që mungojnë më së shumti.

"Prindërit përgjigjen për fëmijët e tyre" - kështu thuhet zakonisht. Le të jetë kjo shprehje udhëzim edhe për prindërit shqiptarë. ■

Mavrova në vend të Brez



Sivjet, Mavrova në Maqedoni ka qenë destinacioni më i preferuar i shqiptarëve, kurse hotelet në Brezovicë nuk kanë pasur punë si vitet e kaluara. Mungesa e turistëve, që e ka karakterizuar këtë sezon, shpjegohet edhe me mungesën e borës. Në Brezovicë s'mbahet mend që të mos këtë rënë borë për një kohë kaq të gjatë. Qendra e skijimit, për një kohë të gjatë, ishte e përzier me baltë e skllotë. Teleferikët nuk punonin si më parë. Zakonisht, vitet e shkuara bora binte që nga fundi i nëntorit. Kurse këtë vit, vetëm një ditë ka pasur reshje të kënaqshme bore, lartësia e së cilës arriti në gjysmë metri. Kjo kohë i ka shqetësuar edhe shumë pasionantë, të cilët e kanë bërë shprehi skijimin çdo vit. Vështirë është edhe për studentët e Fakultetit të Edukatës Fizike, të cilët skijimin e kanë obligativ dhe u duhet terren i volitshëm për ushtrime. Sezoni turistik dimëror merr fund në mbarim të prillit dhe nëse nuk kthehet imazhi i duhur i Brezovicës, humbjet në turizëm llogariten të jenë të konsiderueshme. Mirëpo, reshjet e këtij muaji mbeten shpresëdhënëse se megjithatë Brezovicës do t'i kthehet imazhi i mëparshëm.

Drita AZEMI





Hoxha paditet për ndërtimin e xhamisë

Pushteti maqedonas ka vendosur që krizën ekonomike dhe problemet e shumta politike t'i tejkalojë me ndërtimin e kishave dhe pengimin e ndërtimit të xhamive. Rasti i Meqail Osmanit, imam i fshatit Ladorishtë, është shembull eklatant se çfarë qëndrimi mban regjimi aktual ndaj objekteve fetare islame. Avokati shtetëror e ka paditur imamin për uzurpim dhe fillimin e punimeve pa leje në xhaminë e fshatit Belicë e Sipërme, në parcelën ku muaj më parë u hodh gurthemeli për ndërtimin e xhamisë. Bashkë me të, janë paditur edhe Berat Kolonja dhe Mensur Ismaili nga Këshilli për ndërtimin e Xhamisë. "Kjo padi, e cila më është adresuar në formë të shkruar, nga ata që është përpiluar, ka edhe karakter qesharak, sepse më është drejtuar si hoxha Meqail, e jo si Meqail Osmani. Ndërkohë unë paditem sepse paskam filluar punime pa leje në atë vend, që është një e pavërtetë e madhe" - është shprehur Osmani, i cili shërben si imam afër 35 vjet. Imami i Ladorishtit shprehet i çuditur se si mund të paditet në këtë formë të ulët, vetëm se ka marrë pjesë në një aktivitet që është thirrur dhe organizuar nga besimtarët. "Së bashku me kolegët e mi, në hedhjen e gurthemelit kemi marrë pjesë në cilësinë e besimtarit dhe të imamit dhe kemi bërë detyrën tonë karshi besimtarëve. Unë nuk mund ta kuptoj se prej kur, kryerja e ceremonive fetare dhe këndimi i duasë është bërë i rrezikshëm për shoqërinë dhe shtetin", - thotë ai, duke e konsideruar si qesharake padinë e avokatit shtetëror se gjoja, ai, së bashku me të tjerë, ka uzurpuar parcelën e xhamisë së Belicës. Ndërkohë, për Këshillin iniciues për ndërtimin e xhamisë në Belicë të Sipërme, këto veprime të avokatit shtetëror dhe të gjykatës janë të koordinuara me qëllim që xhamia të mos ndërtohet në këtë vend. "Ne nuk mund ta kuptojmë gjithë këtë energji negative kundër një objekti fetar në një fshat, ku më parë ka pasur një xhami. Tani gjenden forma të ndryshme për ta penguar iniciativën tonë", - theksojnë nga

ТУЖИТЕЛ: Република Македонија
 ТУЖЕНИ: Колонја Берат од с. Радолишта, Струга
 Ошата Мецаит од с. Радолишта, Струга и
 Ислами Менсур од с. Заграчани, Струга
 ПРЕДМЕТ: Предавање во владение
 ВРЕДНОСТ: 40.000,00 ден.

ТУЖБА

Со предлог за издавање на При

Тужителот е сопственик на недвижен катастарските операти како: Кп.бр. 2034/1, ливада 4-т со површина од 199.440 кв. опишан во Поседовен лист

ДОКАЗ: Поседовен лист број 228 за КО В на недвижности- Струга

Со цел да заживее населбата во која има у во текот на 70-тите години со Одлука на Собрането со Месната зедница на заинтересирани лица беа д изградба на викенд- куќи, кои се користат од граѓани. Пред извесно време тужените без документација и одобрение од верската зедница, на Хотелот на ХЕЦ „Лобочница“ Струга, самоволно поставија. Иако биле предупредени од претставници на тужените тоа го игнорираат и продолжуваат со поставување на арматурна мрежа за столбови.

ky Këshill. Para disa kohësh, banorët me origjinë shqiptare të këtij fshati hodhën gurthemelin për ndërtimin e xhamisë, punimet e së cilës pritet të fillojnë së shpejti. Por ky hap kundërshtohet nga individë dhe faktorë të tjerë që tashmë kanë siguruar mbështetjen edhe nga institucione të tjera. Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Pashko Kuzman, është përmendur nga banorët si pengesa kryesore e ndërtimit të xhamisë, e cila dikur ishte e ngritur në po të njëjtin vend. Sot, në këtë fshat nuk ka mjaft banorë, pasi Belica e Epërme është një lokalitetet i cili gradualisht po kthehet në një vend ekskluziv të turizmit malor dhe atij dimëror, falë pozitës së tij. Sipas banorëve me origjinë nga ky fshat, dikur ky vend ka qenë shumë i zhvilluar dhe ka qenë një qendër e rëndësishme e tregtisë, ku vinin tregtarë të shumtë nga qytete të rëndësishme të rajonit. Fshati ka qenë i banuar nga vllahë e shqiptarë, por deri në vitet gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar është larguar edhe familja e fundit shqiptare nga ky fshat, megjithëse ata asnjëherë nuk i kanë shitur pronat. Dhe tani fshati ka filluar të gjallërohet, pasi shqiptarët përsëri po ndërtojnë shtëpi banimi.

Hajrije MEHMETI

Intervistë me drejtorin e Shkollës Ndërkombëtare të Prishtinës, Hayri Hatipoğlu

HATIPOĞLU: Nxënësit q tonë do të kenë një të a

Intervistoi: Osman D. GASHI

Në Kosovë, pas luftës përveç shkollimit publik ka marrë hov edhe ai privat. Ndër këto shkolla, funksionon edhe kolegji turk "Mehmet Akif" e cila është aktive jo vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri. Ka qendra të hapura në Prishtinë, Lipjan dhe në Prizren dhe është një prej shkollave më të mëdha private. Për t'u informuar më gjerësisht, zhvilluam një bisedë me drejtorin e Shkollës Ndërkombëtare të Prishtinës, Hayri Hatipoğlu, shkollë e cila është pjesë e kolegjit "Mehmet Akif".

PAQJA: Kur keni ardhur për herë të parë në Kosovë dhe cili është opinioni juaj për shoqërinë tonë?

HATIPOĞLU: Në Kosovë kam ardhur tri vite më parë, në gusht të vitit akademik 2007/2008. Ky është viti im i tretë këtu dhe shpresoj se do t'i bëj edhe një ose më shumë vite të tjera këtu. Kur kam ardhur për herë të parë këtu në Kosovë, kam pasur njohuri mjaft të mira për popullin shqiptar, sepse, edhe pse me origjinë jam turk, i kam njohur shqiptarët si të jenë vëllezërit e mi. Ne

jemi të lidhur si dy popuj, historikisht e po ashtu edhe geografikisht, me njëritjetrin për qindra e qindra vite. Prandaj, ne kemi shumë gjëra të përbashkëta, gjëra që i ndajmë, kështu që para se të vija këtu i kam pasur këto gjëra në kokë dhe, kur erdha këtu, i përjetova ato gjëra që i kisha në kokë ashtu siç e kam pritur. Njerëzit këtu janë të dashur, mikpritës, derëhapur dhe u pëlqen që t'u shërbejnë mysafirëve dhe për këtë arsye popullin e Kosovës e çmoj shumë.

PAQJA: Z. Hatipoğlu, a mund të na flisni për jetën dhe edukimin tuaj?

HATIPOĞLU: Para se te vija këtu, kam qenë drejtor kolegji në Manavgat në Turqi, i cili është rajon i Antalisë, e që është një vend i mrekullueshëm turistik, i cili ndodhet në pjesën jugore të Turqisë. Në këtë kolegji, isha drejtor për dy vite, kurse para kësaj kam qenë në Australi dhe kam qenë drejtor në një shkollë atje. Kam lindur në Australi, kam jetuar atje për disa vite. Prindërit e mi, më 1988, u kthyen që të jetojnë përgjithmonë në Turqi. Edhe unë u ktheva me ta në atdhe dhe e vazhdova shkollimin e lartë dhe e kam përfunduar universitetin në Stamboll. Pasi

kreva universitetin dhe i përmbusha të gjitha kriteret, u ktheva prapë në Australi dhe kam dhënë mësim atje për tetë vite, anglisht e ndonjëherë edhe turqisht, sepse atje ka pasur studentë turq që i vijonin shkollat turke.

PAQJA: Si e vlerësoni planprogramin shkollor këtu në Kosovë dhe çfarë bashkëpunimi keni me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë?

HATIPOĞLU: Sa i përket planprogrameve që kemi, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, besoj që janë të mira për momentin, por në to mund të bëhen shumë përmirësime. Dhe jam i sigurt dhe e di që Ministria e Arsimit po punon me një zell të madh për ta bërë një gjë të tillë. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe të harmonishëm me Ministrinë e Arsimit. Janë shumë të dobishëm, na ndihmojnë dhe gjithmonë na mbështesin në çfarëdo që bëjmë. Kështu që është një rast i mirë për mua që ta falënderoj Ministrinë e Arsimit për këtë mbështetje. Edhe njëherë i falënderoj për këtë gjë dhe shpresoj që edhe në të ardhmen të konsolidohemi dhe të punojmë së bashku në shumë aspekte.



Që diplomojnë në shkollën ardhme të suksesshme

PAQJA: A mund të na flisni pak më shumë për shkollën dhe nxënësit tuaj. Sa është numri i tyre dhe çfarë sistemi shkollimi keni?

HATIPOĞLU: Në shkollën tonë, natyrisht si shkollë private që jemi, këtë vit, do të jetë një moment historik, ngase po bëhen 10 vite që kur është themeluar kolegji 'Mehmet Akif', pjesë e të cilit është edhe Shkolla Ndërkombëtare e Prishtinës. Dhe shpresojmë që në maj të këtij viti të festojmë dhjetë vjetorin e themelimit e kolegjit 'Mehmet Akif'. Shkolla Ndërkombëtare e Prishtinës është themeluar dy vite më vonë se sa kolegji 'Mehmet Akif' që i bie se është tetë vite e vjetër dhe është versioni i parë i kolegjit 'Mehmet Akif'. Kemi shkollat të tjera simotra që janë pjesë e qendrës edukative 'Gülstan'. Janë tri shkolla në Kosovë, një në kampusin tonë, këtu në Veternik, Shkolla Ndërkombëtare e Prishtinës që ka 320 nxënës, me grupmosha që prej kopshtit të fëmijëve (parashkollorë) e deri në klasën e nëntë. Në Lipjan, kemi kolegjin 'Mehmet Akif', që është shkollë e lartë (e mesme) prej klasës së dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë (12) dhe atje kemi 440 nxënës. Dhe kemi një shkollë tjetër në Prizren, edhe ajo quhet kolegji 'Mehmet Akif' dhe atje mësimi zhvillohet që nga kopshti (parashkollor) e deri në klasën e dymbëdhjetë me një numër prej 380 nxënësish, kështu që në tërësi kemi më shumë se 1000 nxënës në tërë Kosovën dhe jemi shkolla më e madhe private e pavarur në Kosovë dhe besoj që jemi ndër shkollat më të suksesshme dhe shpresojmë që do të mbesim kështu.

PAQJA: Çfarë lloj nxënësish keni në shkollën tuaj? A janë ata vetëm fëmijë të familjeve të pasura apo keni edhe nxënës të shtresave të ndryshme sociale?

HATIPOĞLU: Ne në shkollën tonë kemi një gamë të ndryshme nxënësish. Njerëzit na shohin si një shkollë elitë që është e mundshme vetëm për njerëzit



elitarë, gjë e cila nuk është e vërtetë. Ne jemi këtu për tërë njerëzit, për të gjitha mjediset shoqërore, për të gjitha shtesa sociale të shoqërisë. Ne kemi këtu fëmijë të dëshmorëve, për të cilët familjet e tyre nuk janë në gjendje të paguajnë për t'i arsimuar në shkollë private dhe ne kemi bursa për këta studentë. Në tri shkollat tona, Shkollën Ndërkombëtare të Prishtinës, kolegjin 'Mehmet Akif' në Lipjan dhe në Prizren, kemi rreth 20 nxënës që janë fëmijë dëshmorësh, kështu që ne mundohemi t'i mbështesim dhe t'i ndihmojmë ata në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjithashtu, ne kemi edhe bursa të tjera për arsimim dhe edukim për studentët, të cilët arrijnë suksese në provimet dhe mësimet e tyre dhe kemi edhe një projekt përmes të cilit mundohemi t'i gjejmë nxënësit më inteligjentë nëpër tërë Kosovën, të cilët e kanë të pamundur që të paguajnë shkollimin dhe ne ua sigurojmë akomodimin dhe tërë gjërat e tjera të nevojshme për shkollimin e tyre në shkollat tona. Pra, ne mundohemi që të bëjmë më të mirën për Kosovën dhe popullin e saj. Shpresoj që edhe më tutje do të kemi vullnetin dhe dëshirën e mirë që t'u ndihmojmë sa më shumë këtyre njerëzve.

Natyrisht, një pjesë e këtyre nxënësve janë fëmijë të deputetëve, të VIP-ve, të biznesmenëve, dhe të shtresave të tjera të shoqërisë. Gjithashtu, ne në shkollën tonë nuk kemi vetëm nxënës shqiptarë, por edhe ndërkombëtarë, e gjithashtu edhe nxënës turq.

PAQJA: Mësimdhënësit që japin mësim te ju çfarë kombësie janë dhe në çfarë gjuhe ligjërojnë?

HATIPOĞLU: Gjysma e stafit tonë është me një prapavijë turke, kurse gjysma tjetër janë shqiptarë, mësimdhënësit shqiptarë. Pse është e tërë kjo? Pas klasës së gjashtë ne japim mësim në gjuhën angleze. Këtu, në Kosovë, nuk ka shkolla publike që japin mësim në anglisht. Ne ua mësojmë (ligjërojmë) nxënësve matematikën, fizikën, kiminë në anglisht prandaj na duhen mësimdhënësit që i mësojnë anglisht në fushat e specializuara. Pra, pas klasës së gjashtë lëndët shkencore ligjërohen në anglisht, kurse ato shoqërore në shqip.

PAQJA: Kush është 'Mehmet Akif', emrin e të cilit mban shkolla juaj?

HATIPOĞLU: Mehmet Akif Ersoy është autori i himnit kombëtar të Turq-

isë, i cili është me origjinë shqiptare nga Peja, këtu nga Kosovë dhe është një nga poetët dhe shkrimtarët më të mëdhenj të Republikës së hershme të Turqisë. Ka qenë një person i mrekullueshëm, me cilësi shumë të larta morale, i cili gjithashtu ka qenë edhe person shumë kombëtar dhe, për këtë arsye dhe për këto cilësi që ka pasur, ne i kemi vendosur kolegjit tonë emrin e tij, për shkak të personalitetit të tij të mrekullueshëm.

PAQJA: Ju, më lart, përmendët se jeni shkollë private. Si financoheni dhe sa janë çmimet për vitin akademik në shkollën tuaj?

HATIPOĞLU: Unë kam një përvojë të mësimdhënies në tri kontinente. Kam dhënë mësim në Australi, në Turqi dhe këtu në Kosovë, në tri vende të ndryshme, në tri sisteme të ndryshme të shkollimit dhe jam shumë i kënaqur me atë që po ndodh. P.sh. në Australi, qeveria e ka mbështetur sektorin privat të shkollimit dhe për çdo fëmijë qeveria paguante shkollimin e tij. Pra ishte një mbështetje financiare nga ana e qeverisë. Natyrisht, nuk është i njëjti rast me Turqinë dhe Kosovën dhe shpresojmë që, në një të ardhme të afërt, kjo të ndodhë edhe këtu, gjë e cila do të na ndihmonte shumë, kështu që nuk do të na nevojiteshin paratë prej fëmijëve (nxënësve), sepse në të kundërtën ne nuk do të mund t'i pagua-

nim mësimdhënësit tanë, nuk do të mund ta mbanim shkollën. Dhe pa mbështetje financiare, pa para, është e pamundshme që të arrihet diçka. Prandaj, nxënësit duhet të paguajnë vetë shkollimin e tyre, e cila është një tarifë që ndryshon nga niveli në nivel, duke filluar prej çerdhes (kopshtit të fëmijëve, parashkollorëve) që kap një çmim prej 1600 – 1700€ për vit, ku përfshihen që prej uniformës shkollore e gjërat e tjera dhe ky çmim rritet për çdo nivel më lart dhe shkolla e mesme është më e shtrenjtë se sa ajo fillore.

PAQJA: Ata nxënës që e kryejnë dhe diplomojnë shkollimin te ju, çfarë perspektive kanë në të ardhmen?

HATIPOĞLU: Te ne deri më tani kanë diplomuar rreth 470 nxënës, ku 30% prej tyre kanë shkuar jashtë për të studiuar, në tërë botën, në Amerikë, Kinë, këtu në Shqipëri, në Evropë, në Zvicër dhe 70% e tyre kanë zgjedhur të qëndrojnë në Kosovë. Pra, këtë raport e kemi momentalisht. Kemi nxënës që kanë diplomuar në shkollën tonë dhe tani kanë përfunduar universitetin dhe kanë një jetë aktive të punës në shumë pozita të rëndësishme. Veç t'i përmendi disa: kemi një nxënës që ka diplomuar në shkollën tonë dhe tani është këshilltar e një ministri dhe tani ka vetëm 22 vjet. Kemi nxënës që tani po e kryejnë masterin, mund t'i përmendi dy prej tyre:

njëri është në Stamboll në Universitetin Fatih, Erdoğan dhe tjetri është në Austri dhe shpresojmë që edhe mijëra të tjerë të diplomojnë dhe të zënë pozitat kryesore të punës në tërë Kosovën dhe kështu të bëhen forca kryesore e përparimit dhe përmirësimit për lehtësimin e rrugëtimit për në Evropë. Kjo është edhe dëshira ime për këta nxënës dhe nuk kam ndonjë dyshim për këtë, sepse të pajisurit me një edukim të mirë edhe në aspektin moral është shumë i rëndësishëm. Nxënësit tanë nuk mësojnë vetëm shkencë por edhe mënyrën e të jetuarit, i mësojmë ata se si t'i respektojnë vlerat kombëtare shqiptare dhe ata janë shumë të vetëdijshëm se çka do të thotë flamuri për ta, janë të vetëdijshëm se përse u vranë tërë ata dëshmorë për këtë komb dhe ata rriten në atë mënyrë. Ata e duan kombin e tyre, e duan popullin e tyre dhe ata do të bëjnë tërë atë që është në duart e tyre për popullin e tyre të dashur. Kështu që ne i edukojmë ata, siç e thashë edhe më herët, jo vetëm në aspektin e arsimit, të pajisjes me dije shkencore, por i mësojmë ata edhe në aspektin e humanitetit, i cili është shumë i rëndësishëm.

PAQJA: Dhe për fund?

HATIPOĞLU: E falënderoj shumë revistën 'Paqja' që ma dha këtë mundësi. E çmoj shumë këtë gjë e, gjithashtu, i përhëndes të gjithë lexuesit e saj. ■



Donkishotët zbulojnë Andaluzinë



Zekerija IBRAHIMI

Derisa avioni fluturonte mbi alpet e mbuluara me borë, unë ende s'mund të bindesha se njëmend ëndrra për ta vizituar Spanjën më në fund po realizohej. Gjithmonë kisha pasur përshtypje se ai është një vend i largët që nuk kapet dot. Gjithmonë kisha ëndërruar për Andaluzinë (rajon juglindor i Spanjës) si për një vend që vështirë arrihet. Leximet e mia për Spanjën, e cila pas kontaktit për 8 shekuj të plotë të mesjetës me arabët dhe qytetërimin islamik kishte prodhuar renesancën evropiane, më kishin krijuar imagjinatën se ajo ishte një El-Dorado që s'arrihej me sy. Dhe, kisha pasur të drejtë: kush dëshiron ta vizitojë Spanjën, duhet enkas ta marrë atë rrugë dhe mos të pendohet. Ia vlen.

Aeroporti i ftohtë Cyrihut dhe pritja e ngrohtë e mikut tonë që na priste atje, bashkë me rrëmujën e madhe të shqiptarëve që prisnin dikë aty, na këndelli pas aterimit në tokën e simetrisë – në Zvicër. E, derisa pastaj ecnim rrugës, dy gjëra më bënë shumë përshtypje – simetria e përkryer zvicerane, sidomos parqet e bukura edhe në këtë stinë nëntori, që e bëjnë xheloz secilin njeri simetrik, siç më konsiderojnë edhe mua, dhe afishet e shumta që bënin thirrje për referendumin kundër minareve. Çudi! Ndoshta Zvicrës simetrike edhe minaret ia prishnin simetrinë!

E nesërmja ende pa lindur dielli na gjeti në rrugë. Bashkë me miqtë e mi të jetës, poetin e pazbuluar mistik, Taxhudinin, dhe piktorin e fotografjin e lirë, Rromirin, tamam si Don Kishoti që kërkonte kohë tjetër në kohë tjetër, u nisëm ta kërkojmë Endelusin në Spanjë. Kaluam pranë liqenit të bukur të Lozanës dhe qytetit të rregullt të Gjenevës, për të hyrë në Francën jugore. As këtu kufi nuk ka. Evropë se jo lojë. Një herë të kërkojnë pasaportën në aeroport dhe pastaj kah të dojë zemra ec, se nuk sheh më kufitar. Mua m'u kujtua kufiri i Bllacës, kur edhe për të shkruar për

“Buenos dias” - na përshëndetin në hyrje. Alhambra është pallat pa fund. Kopshtet, përroskat, shatërvanët, muret e punuara krejt në dorë me thirrjen e njohur ushtarake maure “Ve la galibe il-laallah” dhe liqenet e vogla të pallatit të Nasrit, si dhe fortesa përreth, të kthejnë pas në shekullin XII, kur është ngritur kjo mrekulli që emrin e ka marrë nga arabishtja “El-Hamër – e kuqe”

Bajram te miqtë në Han të Elezit, duhet të presësh nga disa orë. Mbase për atë jemi aq larg Evropës. Duke ecur nëpër Francën jugore, kalojmë pranë disa qyteteve, mes të cilëve edhe pranë Monpeliesë dhe Nimit, ku dikur kishte luajtur futbolli Fadil Vokrri. Moti ka qenë ajo.

Dhe, derisa merresh me këto gjëra, dreka ka kaluar, ndërsa ne jemi afruar kufirit të Spanjës. As aty nuk sheh kufitar e doganier. Autostradat e mrekullueshme me nga katër shirita në një anë dhe GPS-i që nuk të lë të humbësh në asnjë çast rrugës, të kthjellin – je në Evropë. Por, Spanja s'ka fund – mbase 1500 km gjatësi. Prej Pirinejeve me borë e deri në Gjibraltarin ku nuk ka dimër.



Xhamia e Madhe në Kordobë

Destinacioni jonë i parë është Barcelona. Tashmë i kemi bërë 10-12 orë rrugë. Ndonëse emrin e këtij qyteti e dëgjojmë çdo javë në temën e futbollit botëror, ai është e pamundur të perceptohet me sy. Rrëmujë e madhe, rrokaqiej pa fund dhe vërshime makinash. Para se të vendosemi në hotel, ia bëjmë një tavaf stadiumit “Kamp Nou”, i cili për fatin tonë të keq gjithkund është i mbyllur. Ishte vonë më. Të lodhur nga gjithë ajo rrugë e qëndrim në makinë, mezi e gjejmë një vend parkimi për veturën tonë dhe shpejt vendosemi në hotel. Pas një pushimi të shkurtër, ia bëjmë një qark Barcelonës. Dhe, kur të shkosh në Barcelonë, të gjithë të thonë që dy gjëra të mos i lësh pa i pa: stadiumin e qytetit dhe katedralen “Sagrada familia”. Një katedrale që tashmë një shekull ndërto-

het dhe ende s'ka përfunduar. E lartë sa të merrej mendja për ta kapur të tërën. Krejt e punuar në gurë. Një mrekulli e vërtetë arkitektonike. Edhe pse ishte mbrëmje, turistët s'kishin të ndalur. Po bëhej vonë. Ne duhej të pushonim se nesër na priste rrugë e gjatë.

Në xhaminë/katedralen “Mesquita” në Kordobë

Edhe mëngjesi spanjoll njësoj si ai zviceran – para se të lind dielli ne jemi në makinë. Dallimi është se këtu fillojmë ta ndjejmë klimën e butë mesdhetare të bregdetit. Ndërsa në makinën tonë jehon kënga e Loreena McKenitt për *Natën në Alhambra*. Pushojmë një çikë në qytezën e bukur bregdetare Benikasim (një toponim arab) dhe përsëri vazhdojmë bregut të Detit Mesdhe, duke kaluar Valensinë e duke marrë në të djathtë për Kordobë. Atje mbërrijmë pak para mbrëmjes. Vendosemi në një hotel mu pranë xhamisë/katedrales Mesquita dhe, pasi pushojmë pak, i biem një qark të shkurtër qytetit, duke kaluar nëpër Urën Romake, e duke u kënaqur me kalldrëmin e bukur të pjesës së vjetër të Kordobës. E, derisa pimë çaj në minderet orientale, me hartën e qytetit në dorë e bëjmë planin e vizitave të nesërme. Kemi mjaft për të ecur.

Mëngjesi me “leçe” (qumësht) kalon pa u vënë re. Po futemi në Mesquita. Kjo është xhamia që, pas ardhjes së arabëve në Spanjë në vitin 711, me zbarkimin e Tarik ibn Zijadit (me emrin e të cilit u emërtua edhe ngushtica “Gjibraltar” nga Xhebelu Tarik – Kodra e Tarikut), filloi të ndërtohet në Kordobë në vitin 785, gjatë kohës së Abdurrahmanit I dhe përfundoi në vitin 987. Është një objekt grandioz. Pos qindra shtyllave që të bëjnë të humbësh brenda objektit që përfshin një sipërfaqe prej 214 për së gjeri dhe 150 për së gjati, të mahnit edhe simetria e harqeve, që sikur të mos e dish se në shekullin e 8-të nuk kishte kompjuter do të shkonte mendja

se dikush i ka bërë krejt me copy-paste. Megjithatë historiku i kësaj xhamie është i dhimbshëm. Në vitin 1236, kur Kordoba merret përsëri nga inkuizitorët e krishterë, ajo kthehet në katedrale, duke vazhduar kështu edhe në ditët tona. Pranë mihrabit me mbishkrim arab nga Kurani janë skulpturat e shenjtoreve dhe altari i katedrales. Ndërkaq minarja e gjatë tashmë nuk ka asnjë shenjë se dikur ka qenë minare. Aty janë të varura kambanat, që i ftojnë besimtarët në meshë. Pikërisht në xhaminë e bukur të Kordobës, që ende e ruan edhe emrin Mesquita (nga latinishtja – xhami).

Megjithatë detyra jonë në Kordobë nuk përfundon këtu. Janë dhjetëra objekte të tjera, shumica “iglesia” (kisha), të cilat ne i vizitojmë, është kalaja rrethojë e qytetit, përmendorja e filozofit me famë botërore, që ka lindur në Kordobë, Ibën Rushd (i njohur në Evropë si Averros), si dhe kopshti parajsor i pallatit po aq grandioz “Alkazar”, që po ashtu është ngritur gjatë kohës së maurëve (arabëve). Perëndimi i diellit na zë në malin 8 km larg qytetit, ku është vendosur saraji Medina al-Zahra, i ngritur nga kalifi Abdurrahmani III, mes viteve 936 dhe 940. Bukuria e tij, që ende lexohet në rrënojat dhe porta e sarajit, si dhe pamja e mrekullueshme e qytetit që ofron ky vend, ta mbush mendjen se ata që e kanë zgjedhur këtë pikë për rezidencë kanë qenë njerëz të mëdhenj.

Ndonëse harta jonë na thotë se edhe shumë vende më të vogla na kanë mbetur pa i parë, megjithatë koha jonë e ngushtë na detyron që nesër të planifikojmë rrugë tjetër. E derisa rrimë e pimë kafe në një kafene orientale të Kordobës me shatërvan në mes e me shumë lule gjithandej, vendosim që rrugën tonë ta ndryshojmë. Vizitën në Seviljë do ta zëvendësojmë me “Rrugën e kalifatit”

Shqiptarët në Rrugën e kalifatit

Meqë kah të sillësh të vërshonin fletushkat e materiali propagandistik, në hyrje të hotelit na ra në dorë një fletushkë që e përshkruante *Rrugën e kalifatit*. Ajo thuhej të ketë qenë rrugë e kalifëve prej Kordobe në Granadë. Ishin aty disa qytete me objekte që ishin me interes për vizitën tonë. Mëngjesi i ditës sonë të dytë në Andaluzi na zë rrugës për Espejo, një fshat kodrinor me kështjellë dhe kishë në majë të kodrës – stacioni jonë i parë në “Routo del kalifato”. Pastaj vijmë

qyteza Baena me kështjellën e vet, fshatrat Luque e Zuheros me kështjellat majë kepi mbi fushat e gjera me ullinj, Alcaudete me kështjellën e shekullit të 8-të dhe Alcalá al-Real me kështjellën grandioze, ku secili kishte lënë historinë e tij, që nga romakët, maurët e deri te Napoleon Bonaparta. Një cicerone fjalëmbël e ardhur aty nga Jokshiri i largët në shoqëroi gjatë gjithë kësaj vizite njëorëshe duke na kaluar prej periudhe në periudhë. Ndërsa era që frynte në atë majë kepi dhe 6 kështjellat më të vogla në kodrat përreth ishin për ne shembulli më i mirë sa ëmbël është bartur jehona e zërit të tellallëve në kohën kur nuk kishte celular.

Dhe, derisa po bie muzgu, në rrugë tonë na shfaqet Granada. Mezi presim që të na e zë syri diku pallatin Alhambra, ngase nga video-incizimet e këngëve të Loreena McKenitt, duket se ajo është e vendosur në një kodër. Por, errësira e natës, rrëmuja e makinave në qytet, rrugët njëkahëshe dhe GPS-i ynë që s’pushon duke na sugjeruar për *rrugën e vërtetë*, na e shmangin vëmendjen. Arrijmë në hotel, vendosemi sa për të thënë dhe, si të uritur, dalim në kërkim të Alhambres. Kur ne arrijmë para dyerve të pallatit, aty s’lëviz gjë e gjallë. Është bërë vonë. E presim autobusin e fundit që dërgon në qytet, ngjitemi në të dhe shkojmë të pushojmë. Se nesër na pret saraji Alhambra.

Alhambra – bukuroshja e Andaluzisë

Të nesërmen një “kafe kon leçe” (kafe me qumësht) para hyrjes dhe prerja e biletave janë riti jonë i fundit. “Buenos dias” (Mirëdita), na përshëndetin në hyrje. Alhambra është pallat pa fund. Kopshtet, përroskat, shatërvanët, muret e punuara krejt në dorë me thirrjen e njohur ushtarakë maure “Ve la galibe il-laallah” (S’ka ngadhënjimtar tjetër, pos Allahut) dhe liqenet e

vogla të pallatit të Nasrit, si dhe fortësa përreth, të kthejnë pas në shekullin XII, kur është ngritur kjo mrekulli që emrin e ka marrë nga arabishtja “El Hamër – E Kuqe”. Këtu ishte kulmi i qytetërimit arab. Derisa osmanët e ngrinin sarajin Topkapi, arabët flladitëshin në Alhambren e tyre në Garnatë. Ndërkaq në kodrën përballë e kishin krijuar një lagje tjetër tipike orientale të quajtur Albasin. Kalimi i diellit në perëndim na zuri në kopshtet e Alhambres.

Kënaqësia e qëndrimit në Alhambra, mahnitja me realizimet arkitektonike dhe dekorimet e mrekullueshme e shënonin fundin e vizitës sonë në Andaluzi. Një “kafe se leçe” (kafe pa qumësht) në Albasin, sa për t’i bërë edhe ca foto të Alhambres prej matanë, disa shëtitje nëpër çarshinë e Albasinit, vizita në një faltore myslimanësh emigrantë nga Afrika, që ende s’e kishin zbuluar drejtimin e Qabesë e faleshin secili në kiblen e tij, ishin krejt ajo që na mbeti kujtim nga Granada.

Të nesërmen herët po niseshim për Zvicër. Me shumë kujtime dhe me shumë keqardhje që shumë gjëra na mbeten për t’i parë. Sa për të lënë një shkak që përsëri të vijmë kënde. E derisa udhëtonim përsëri në veri, më kujtohej ajo ngjarja që e kanë regjistruar gjithë historianët kur sunduesi i fundit arab i Granadës, Muhamed XII, i njohur si Boabdil, që sundoi kah fundi i shekullit XV, e dorëzoi qytetin pa luftë dhe, duke thënë “Zoti është më i madhi”, filloi të qajë. Ndërsa nëna e tij me qortim ia ktheu: “Mos qaj si grua për atë që e humbe si burrë”. Por, ne nuk arritën ta gjejmë shkëmbin e quajtur “El ultimo sospiro del Moro” (Pshëritima e fundit e maurit), aty ku kishte qarë ky maur i fundit, i cili u largua nga Andaluzia më 1492. Na mbeti për vizitën tonë të ardhshme.

E sa e mërzitshme ishte pastaj rruga e gjatë për në Zvicër! E sidomos fluturimi për në Shkup. Këtu ku në një mënyrë përsëritet mesjeta spanjolle e inkuizicionit. Has- ta la vista, Andalucia!



Alhambra

Luftërat civile 656-661



Muhamed J. KAJOLLI

Librat e historisë e kanë përshkruar në detaje vrasjen e Osmanit r.a. Ashtu siç është shkruar e thënë, në kohën kur rebelët po e masakronin Osmanin, gruaja e tij Nailja, kishte dalë para tyre dhe ka kërkuar që mos ta mbysynin. Fjalët dhe britmat e saj nuk i ndihmuan Osmanit r.a., bile asaj ia prenë gishtërinjtë derisa ajo po qëndronte mbi trupin e burrit të saj. (Ibën Kethir: 5/460) E solla këtë detaj në fillim të kësaj teme, si hyrje për shkak se këta gishtërinj dhe këmisha e Osmanit, do të vareshin në minderin e xhamisë emevite në Damask, të cilat do t'i shfrytëzonin për nxitje dhe shtim të urrejtjes, si dhe do t'i shërbenin Muaviut për mobilizimin e ushtrisë që do ta përgatiste në një ditë të caktuar, në emër të hakmarrjes ndaj vrasësve të Osmanit r.a.

Maskara ndaj kalifit të tretë, nuk do të kalonte pa pasoja, por askush nuk kishte parashikuar se ato do të tejkalonin çdo parashikim njerëzor. Kjo vrasje do të bëhej shkaktare e vëllavrasjeve të mëdha, sa që shumëkush mendoi se çdo gjë që kishte ngritur Muhamedi s.a.v.s., do të shkatërronhej që në

themel.

Njëri prej tyre ishte edhe vetë kalifi i muslimanëve Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij),

i cili pas namazi të sabahtut ishte thelluar

në një meditim të gjatë, ku

thuhet se ashtu kishte qëndruar derisa dielli kishte kaluar një shtizë larg murit të xhamisë. Pasi kishte mbaruar meditim, iu drejtua të pranishmëve me fjalët: "I kam parë shokët e të Dërguarit s.a.v.s. dhe asgjë nuk po më ngjason me ta. Ata kalonin natën me pagjumësi, faleshin në këmbë, shkonin në ruku e sexhde dhe lexonin Librin e Allahut. Meditonin për Allahun, e kur e përmendnin Atë, trupi ju rrëqethej ndërsa sytë ju lotonin. Për Zotin, njerëzit sot sikur janë harruar. Pastaj u ngrit dhe nuk qeshi më derisa e vrau Ibën Mulxhemi" (Ejub: 229)

Arsyeja po humbej

Kaluan tre-katër muaj që kur Aliu (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) u zgjodh kalifi i muslimanëve. Brenda kësaj periudhe kohore, disa prej figurave më të njohura publike, nuk kishin guximin e duhur të dilnin në publik për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre. Shumë prej sahabëve u mbyllën në shtëpitë e tyre, thuajse shprehnin një bojkot të heshur, por ky veprim sikur kishte mbyllur shumicën e aktiviteteve dhe angazhimet e tyre publike. Kjo nuk nënkuptonte se këta ishin kundër zgjedhjes së Aliut për prijës të besimtarëve, por, për shkak se rebelët ishin akoma prezent në Medinë dhe kërkonin zgjidhjen sa më të shpejtë.

Prezenca e tyre në publik je sinjale se ata e drejtonin jto-shtetin islam, e vetë kalifi.

Gjatë kësaj periudhe kohore, prefekturat e shtetit islam gjithashtu po vlonin, por askush nuk kishte idenë se nga të fillonin në përmirësimin e gjendjes, sepse shumica e tyre mendonin ndryshe. Me një fjalë, kupola e shtetit ishte paralizuar. Asgjë nuk funksiononte si duhet. Shumica e prefekturave kishin qëndrim pozitiv ndaj Aliut (Zoti e

fisnikëroftë fytyrën e tij), me përjashtim të Shamit, nga i cili Aliu nuk po merrte sinjale pozitive, por nuk mund të thuhet se ishin totalisht negative. Akoma kishte shpresë për përmirësim.

Aliu r.a. kishte një ushtri të vogël, brenda së cilës një pjesë e madhe e komandantëve kryesorë ishin pjesëtarë të rebelëve. Me ta, ai nuk ishte i sigurt të marshonte drejt Shamit për ta nënshtruar Muaviun, ndërsa ky i fundit e shfrytëzonte dobësinë ushtarake të tij për qëllime politike në krahinën e vet. Strategjia e Aliut ishte e qartë. Ai fillimisht kërkoi t'i njihej posti i kalifit, e pastaj kishte premtuar se do të merrej me gjykimin e rebelëve, sepse një gjykim i tillë nuk ishte edhe aq i lehtë.

Aliu r.a. nuk ishte i paditur dhe nuk priste që dikush ta mësonte se si t'i gjykonte ata. Ai nuk mendonte ashtu siç pretendonin të tjerët. Gjykimi po, por jo të gjithë pjesëmarrësit në komplot do të dënoheshin me vdekje. Sipas Aliut, kjo ishte absurde dhe e papranueshme, prandaj ai preferonte stabilizimin e vendit e pastaj të merrej shtruar e mirë me secilin veç e veç prej komplotistëve.

Sidoqoftë, pa dashjen e tij, ai do të fillonte përgatitjet e një ushtrie, e cila do të marshonte drejt Shamit. Kjo situatë amorfe nuk do të çahet me nisjen e kësaj ushtrie të tij nga Medina, por nga dy ish-kandidatët për kalif në zgjedhjen e Osmanit (Talha dhe Zubejri), të cilët kërkuan leje prej kalifit për ta bërë umren në Mekë. Aliu edhe pse nuk iu gëzua kërkesës së tyre, i lejoi. Pasi ata shkuan, të pranishmëve që ishin aty u tha se ata dy nuk synonin umren!

Shkaqet që sollën luftën e parë civile 656-661

Pas goditjes të madhe që pësoi shteti islam me vrasjen e Osmanit r.a., populli musliman u zhyt në luftën civile, e cila u ndal vetëm pas rënies shehid të kalifit të katërt Aliut (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij) në vitin 661 (40h). Derisa në pushtet ishte Muavi Ibën Sufjani, në shtet mbretëroi një stabilitet i brishtë, por luftërat civile rifilluan menjëherë pas vdekjes së tij, kur më 680 (61h) në Kerbela u vra mizorisht djali i Aliut, ose nipi i Pejgamberit s.a.v.s. Husejni. Kjo katrahurë civile u ndërpre me vrasjen e kalifit të vetëshpallur për Qarkun





e Mekes, Abdullah Ibën Zubejri më 692. Me vrasjen e tij u ndalën luftërat civile dhe shteti islam u zgjerua shpejt gjeografikisht, për të ndalur në jugun e Francës së sotme.

Një këndvështrim i mprehtë i këtyre ngjarjeve sikur lë të kuptohet se zanafilla e këtyre dy luftërave të mëdha civile buroi nga pasionet dhe ambiciet për ta shuar dinastinë udhëheqëse të familjes hashimite (të lozës së Pejgamberit s.a.v.s), ndërsa këndvështrimi tjetër thotë se çdo gjë u bë nga papjekuria politike, duke krijuar situata të turbullta. Personalisht mendoj se të dyja këto qëndrojnë, e para më pak sesa e dyta, por që të dyja në esencë qëndrojnë. Të parët udhëhiqeshin nga Muavi Ibën Sufjan, ndërsa të dytët nga Aishja, Ibën Zubejri dhe Talha (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre).

Nëse gjykojmë me logjikën e asaj kohe, kjo familje ishte e vetmja familje që mund të siguronte stabilitet, mirëqenie dhe zhvillim për umetin musliman. Mirëpo, në anën tjetër, familja emevite sikur e ndiente veten më të fuqishme në aspektin politik dhe financiar. Ata

mendonin se janë më të aftë për të udhëhequr shtetin e ri, aftësi që e dëshmuuan pas rënies së gjakrave vëllavrasëse se ishin vërtet të zotë, por jo të drejtë karshi umetit. Ndërsa situata e krijuar nga Aishja r.a. do të shfrytëzohet nga vrasësit e Osmanit r.a. dhe do të shkaktonte vrasje të mëdha, të cilët Aliu r.a. do t'i varroste të gjithë si shehidë.

Muaviu, Amër Bin As dhe emevitë të tjerë, kishin nuhatur se situata në Mekë po ziente dhe kjo paralajmëronte një destabilitet në pushtetin e lartë. Prandaj, kjo familje, në vend se të shkonte në ndihmë politike e ushtarake, ajo do të priste momentin e duhur dhe kohën e duhur për të vepruar kundër Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*). Këta nuk do të nxitonin ta njihnin kalifin e ri të muslimanëve, por edhe nuk do ta refuzonin atë, siç kishin bërë Talha dhe Zubejri. Këta dy ia kishin dhënë besën Aliut r.a. në Medinë, por historianët sikur japin shenja se pas katër muajsh ata të dy e kishin thyer atë besë.

Për të mos u zgjatur më shumë në

analizat tona, përveç vrasësve të Osmanit, të cilët janë shkaku kryesor i fillimit të trazirave dhe luftërave civile 656-666, do të sillja më gjerësisht edhe gabimet e disa personaliteteve të njohura të sahabëve të Pejgamberit s.a.v.s., të cilët pa vetëdije i hidhnin flakës benzinë:

1. Numan Bin Beshir

Me t'u vrarë Osmani r.a., Numani iku vetëtimthi te Muaviu në Sham. Me vete kishte marrë këmishën e gjakosur të Osmanit r.a. dhe gishtërinjtë e gruas së Osmanit r.a. Ai kishte me vete edhe një mesazh gojor për Muaviun. "Nailja paska përcjellë amanetin e burrit të saj, i cili pak para se të vritej paska kërkuar nga Muaviu që vetëm ai¹ të hakmerrej për gjakun e tij." (Dinuri: 44) Por, Muaviu nuk do të nxitonte të hakmerrej. Ai do të priste momentin më të volitshëm për të, sepse ai duhej të shkonte në fitore të sigurt. Burime historike tregojnë se Muaviu do ta linte të varur këmishën e gjakosur dhe gishtërinjtë e Nailës për një vit me radhë në xhaminë emevite.

Tradicionalisht, që nga koha e injorancës², familja emevite dhe ajo hashimite në Mekë i kishin punët e ndara. Dikush këtë ndarje e komentonte se, këto dy familje e konsideronin njëra-tjetrën rivale tradicionale. Në realitet, edhe nëse kishte ekzistuar ky rivalitet, me përfundimin e Shpalljes së Kur'anit, çdo gjë kishte përfunduar, sepse ai kishte arritur që t'i bashkonte të gjitha fiset arabe dhe vetëkuptohet se edhe këto dy familje.

Askush nuk ka paragjykur se një ditë midis tyre do të lindin marrëveshje dhe vëllavrasje. Njëzet e pesë vjet pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s., në shtetin e ri do të mbretëronte një situatë e turbullt dhe amorfe. Situata e krijuar ishte rast i volitshëm për emevitët për ta rimarrë pushtetin politik dhe kjo turbulencë do t'i rikthente ata në ambiciet e kohës së injorancës.

2. Shkarkimi i prefektëve

Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*), sikur i irritoi shumë administratorë të shtetit dhe ithtarët e Osmanit³, kur mori vendimin për shkarkimin e prefektëve të vjetër. Ata nuk qenë në gjendje ta kuptonin barrën e kalifit dhe gjithashtu nuk dinin se cila ishte strategjia e tij për t'u çliruar nga ajo barrë, prandaj, edhe nuk e respektuan urdhrin e tij. Çdo veprim

i tij, për ta, ishte i pakuptimtë dhe çdo gjë fatkeqësisht interpretohej ndryshe. Në fakt, disa prej sahabëve të mëdhenj e kishin këshilluar Aliun (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) që të mos nxitonte me shkarkimin e tyre. Sidomos Ibën Abasi dhe djali tij Hasani, i kishin thënë që të mos e shkarkonte Muaviun, sepse ai kishte qenë prefekt i suksesshëm që prej kohës së Omerit r.a. (Dinuri: f. 49)

Mirëpo, mosshkarkimi i Muaviut ishte edhe më problem, sepse ai situatën e krijuar pas vrasjes së Osmanit po e shfrytëzonte për nxitje dhe urrejtje në krahinën e Shamit, e jo për zbutje dhe qetësim të umetit. Situata do të ndizej akoma më shumë atëherë kur Muaviu, nuk e pranoi shkarkimin për t'u zëvendësuar me prefektin e ri, dhe as nuk po jepte shenja pozitive se do ta pranonte Aliun për kalif të muslimanëve.⁴ Ndërsa Aliu r.a., me të drejtë, do të përgatitej kundër tij.

3. Shfuqizimin i disa vendimeve të Osmanit r.a.

Askush nuk mund ta akuzojë drejtpërdrejt Osmanin r.a. për nepotizëm, e as për abuzim të pasurisë së shtetit. Mirëpo, kalifi i vrarë nuk mund t'i ikte përgjegjësisë së tij, sepse nuk kishte bërë aq sa duhej për t'i penguar të afërmit e tij, të cilët abuzonin me pasurinën e patundshme të shtetit. Derisa Osmani r.a. qëndroi në postin e kalifit, ai kishte shpërndarë vendime pronësie dhe patundshmëri për farefisin e tij. Këto vendime të tij, Aliu r.a. do t'i shfuqizonte menjëherë, edhe pse ishte i vetëdijshëm se akoma nuk kishte fuqinë ekzekutive për t'i rikthyer pronat e shtetit.

Mirëpo, fillimisht ky vendim funksionoi dhe të ardhurat e këtyre pronave ai filloi t'ua shpërndante fukarenjve dhe nevojtarëve. Ky vendim i tij për familjen emevite ishte një goditje e madhe dhe kuptohet se irritoi një numër të madh të prefektëve dhe zyrtarëve të lartë të shtetit. Ajo që e shtyu Aliun të merrte këtë vendim, nuk ishte hakmarrja ndaj kësaj familje, por drejtësia e tij dhe parregullsitë që ishin shkaktuar gjatë kohës së Osmanit r.a.

4. Qëndrimi i Aishes r.a.

Pa dyshim se Aishja r.a. ishte gruaja më e dalluar nga të gjitha gratë e Muhamedit s.a.v.s. Ajo ishte gruaja që më së shumti i ndihmoi sahabët t'i zgjidhin

disa nga fetvatë që ishin të rëndësishme së veçantë për gjininë femërore. Thënë shkurt, nëse Aliu r.a. ishte njeriu më i ditur nga të gjithë sahabët e Pejgamberit s.a.v.s. prej gjinisë mashkullore, Aishja ishte më e ditura nga gjinia femërore.

Aishja r.a., para se të vritej Osmani, kishte shkuar në Meke me të gjitha gratë e tjera të Pejgamberit s.a.v.s. Kur ato u nisën, ishin në dijeni të plotë se rezidenca e Osmanit ishte e rrethuar nga grupe rebele. Mbase për shkaqe sigurie të grave të Pejgamberit s.a.v.s. sahabët do të preferonin që ato të largoheshin përkohësisht nga Medinja, dhe meqenëse ishte koha e haxhit, ata preferuan t'i dërgojnë në Mekë.

Kur mbaruan haxhin ato u nisën për në Medinë, por rrugës u informuan për vrasjen e Osmanit r.a. dhe gjithashtu mësuuan se Aliu ishte zgjedhur kalif. Për dallim nga gratë tjera, Aisha r.a. pasi dëgjoji këtë lajm të hidhur, kërkoi që menjëherë të kthehej për në Mekë. E mllëfosur dhe mbase pak e shantazhuar nga Abdullah Ibën Zubejri, ajo mbajti një fjalim në Mekë, në të cilin kërkoi me çdo kusht vrasësit e Osmanit r.a.⁵

Ajo gjithashtu u kërkoi edhe grave të tjera të Pejgamberit s.a.v.s. të bëheshin pjesë e 'ndihmës' së saj⁶. E emocionuar dhe tronditur për vrasjen e Osmanit, Aishja r.a. ishte gruaja e parë, e cila ngriti zërin dhe filloi përgatitjet për hakmarrje. Shumë analistë mendojnë se zëri i saj nuk do të duhej të dëgjohej në atë mënyrë⁷, përveç zërit të arsyes dhe afirmimit e djemve të tyre, sepse sikurse ajo edhe të gjitha gratë e tjera të Pejgamberit

s.a.v.s. konsiderohen në Kur'an si nëna të besimtarëve. Tani në Mekë kishin arritur një numër i konsiderueshëm i sahabëve të mëdhenj të Pejgamberit s.a.v.s. dhe pritej një vendim.

Sidoqoftë zëri i saj nuk ishte politik, por tingëllonte si i tillë, sepse ndikoi thellë në politikë. Duke qenë se ajo ngriti zërin e hakmarrjes, prefekti i Mekës Abdullah Ibën El Hadramij u ndikua prej saj dhe tregohet se nuk ishte betuar për besnikëri kalifit të ri. Një gjë të tillë akoma nuk e kishte bërë as Muaviu, sepse ai në përgjigjen e tij në letrën kthyesë për Aliun (*Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij*) nuk i kishte thënë se nuk e pranonte atë për kalif. Vërtet, letra e tij ishte përgjigje metaforike. Përgjigjja e tij kishte dy ose shumë kuptime, prandaj nuk mund të thuhet se ai e refuzonte Aliun për kalif. Por zëri i Aishes sikur ua shtoi kurajën të gjithë atyre që mendonin për hakmarrje, në veçanti familjes së emevitëve, të cilët në kohën e Osmanit r.a. ishin në poste shumë të larta të qeverisë.

5. Qëndrimi i Talhas dhe Zybejrit

Pasi ia kishin dhënë besën Aliut r.a., një ditë këta dy kërkuan prej tij të mësonin se si do të hakmerrej ndaj vrasësve të Osmanit r.a. Ndërsa Aliu r.a. i siguroi ata se ajo ditë do të vinte, por për momentin kushtet dhe rrethanat ishin në favor të komplotistëve. Ata për ta përforcuar pozitën e Aliut në Medinë, kërkuan prej tij që Zubejrin ta përcaktonte prefekt të Kufës, ndërsa Talhan prefekt të Basrës. Synimi i tyre ishte që të bindnin popul-



lin e këtyre dy krahinave për besnikëri të plotë ndaj kalifit dhe më pas të ktheheshin për ta ndihmuar atë. Aliu (*Zoti e fisnikëroftë fytirën e tij*) nuk mendoj se ishte një zgjidhje e mirë për momentin. Ai kishte parapëlqyer që ata të dy ta ndihmonin aty, sepse hëpërhë kishte nevojë më shumë në Medinë. Si duket këta dy, nuk u ndanë të kënaqur nga përgjigjja e tij dhe pas disa ditësh të tjera⁸ kërkuan prej tij të shkonin për umre në Mekë. Ai i lejoi edhe pse ishte i bindur se qëllimi i tyre nuk qe umreja.

Me të shkuar në Mekë, atje ata iu bashkëngjitën mendimeve të Aishes r.a., e cila edhe ajo ishte e vendosur të hakmerrej për gjakun e Osmanit r.a.. Ajo u informua nga këta dy edhe më në detaje, se Aliu r.a. ishte peng i komplotistëve dhe nuk kishte fuqi të hakmerrej. Por, ajo që bëhet më e pakuptimtë për muslimanët e sotëm, është thyerja e betimit nga ana e Talhas dhe Zubejrit, të cilët e përkrahën mendimin që të shkonin në Basra për të luftuar vrasësit dhe më pas ushtrinë e Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytirën e tij*), e jo për ta ndihmuar.

6. Forca e dobët ushtarake e Aliut r.a.

Mund të thuhet se një prej shkaqeve të luftërave civile ishte edhe ushtria e vogël ose e dobët e kalifit. Situata për qeverisje të mirë, ditë e më shumë, po dilte nga kontrolli. Duke qenë se ai ishte i vetëdijshëm se ç'po zihej brenda shtetit, thirri për mobilizim qytetarët e lirë të Medinës, por numri i vullnetarëve, të cilët iu përgjigjën ftesës së tij ishte i vogël, krahasuar me ushtritë që dispononin krahinat e tjera përreth Medinës. Ky numër i vogël i ushtarëve të kalifit ishte sinjal për të gjithë ata që mendonin të përfitonin nga kjo situatë e turbullt. Sikur Aliu r.a. të kishte në dispozicion një numër pak më të madh ushtarësh, thuhet se nuk do të kishte vëllavrasje e as konflikt të gjerë të armatosur civil.

Aliu r.a., edhe pse kishte këtë ushtri të vogël, mbetej luan dhe nuk tërhiqej nga padrejtësitë. Ai, edhe me këtë numër të vogël, urdhëroi marshimin drejt Shamit, sepse për të vetëm Muaviu ishte rivali kryesor, sepse ishte i pabindur në njohjen e tij për kalif. Por kur Aishja r.a. doli me ushtrinë e saj nga Meka për në Basra, Aliu r.a. u detyrua ta ndërrojë destinacionin e vet. ■

¹ Kjo lloj kërkese jep shenja të një arsytimi të kohës së injorancës. Në kohën kur Aliu po përgatiste terrenin për t'i gjykuar vrasësit e vërtetë sipas shariatit, ai do të pengohet me kërkesa të vazhdueshme për hakmarrje, ose atë do ta akuzonin duke i thënë se në një mënyrë po i mbronin vrasësit.

² Shikuar nga këndi fisnor ose kombëtar, përpara ardhjes së Islamit, këto dy familje e kishin të ndarë pushtetin e brendshëm dhe të jashtëm. Hashimitët kujdeseshin për Qaben brenda Mekës, ndërsa emevitët për punët e jashtme. Këta të fundit merreshin me tregti dhe kishin mbi supe ushtrinë. Me ardhjen e Muhamedit pejgamber, roli i hashimitëve ndryshoi dhe pa ndonjë qëllim paraprak të xahilijetit (injorancës) hashimitët ishin pishtarët e ndryshimit të madh botëror, fetar dhe politik.

³ Prefektët e Osmanit, shumica dërmuese prej tyre ishin të afërmit e tij. Ata, duke shfrytëzuar pozitën e tyre, kishin krijuar prona dhe patundshmëri të mëdha brenda krahinave ku ata vepronin.

⁴ Që kur Aliu u zgjodh kalif, midis tij dhe Muaviut ishin shkëmbyer disa letra. Ne nuk do të merremi tani me letrat e tyre sepse do të duhej një libër i tërë, por ajo që është më esenciale për ne është se shumica e letrave që ne i posedojmë nuk përkohjnë me realitetin. Si duket shumë letra janë shkruar nga politikanë që i kanë shërbyer kohës së tyre. Disa prej tyre favorizojnë politikën e Muaviut, e disa politikën të Aliut (*Zoti e fisnikëroftë fytirën e tij*). Ndërsa ne, duke paraqitur historinë pa ndonjë ngarkesë nga e kaluara, mundohemi t'i sjellim ngjarjet ashtu siç kanë qenë. Por vetëm Allahu i Lartmadhëruar e di më së miri.

⁵ Disa historianë duan të thonë se Aishja r.a. nuk e kishte qejf Aliun r.a. dhe mendja e saj kërkonte zgjidhje të re. (Ahmed Shelebi: 1/616 dhe disa historianë të tjerë) Shumica e tyre bazohen në rastin e shpifjes ndaj saj, por pak ka të ngjarë se Aishja r.a. e urrente Aliun r.a. Si argument kemi shumë thënie të saj, por, më i përzgjedhuri nga unë është hadithi i saj kur ajo tregoi dashurinë e saj dhe të pejgamberit s.a.v.s. për Aliun dhe familjen e tij (Ehlu Bejt), e cila tha: "Një mëngjes doli Pejgamberi i Allahut, ndërsa mbi supe kishte një gunë të larme të punuar prej leshi të zi, mandej iu afrua Hasani, i biri i Aliut, dhe ai e mbuloi atë me gunë. Pastaj iu afrua i vëllai i tij Hysejri, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. e mbuloi edhe atë. Pas pak erdhi Fatimja, të cilën edhe atë e mbuloi, ndërsa pas saj u afrua edhe Aliu, të cilin e mbuloi gjithashtu, pastaj recitoi ajetin: "Allahu dëshiron që prej jush, o familja e Pejgamberit, të largojë mëkatet dhe t'u pastrojë tërësisht" (transmeton Muslimi, ajeti suretul Ahzab 33)

⁶ Gratë e Pejgamberit fillimisht iu përgjigjën pozitivisht thirrjes së Aishes r.a., derisa ajo iu kishte thënë se do të shkonin në Medinë. Kërkesa e tyre ishte e qartë: ato do t'i kërkonin kalifit të sapozgjedhur t'i dorëzonte vrasësit e Osmanit r.a. Kur Aishja e ndryshoi destinacionin, nga Medina për në Basra, disa prej tyre ndryshuan mendje dhe nuk e përkrahën. Me t'u bashkuar

me Talhan dhe Zybejrin, Aishja u pajtua të shkolin në Basra, për ta rritur numrin e ihtarëve të Aishes, me të cilët do të luftonte 'pamundësinë e Aliut' (*Zoti e fisnikëroftë fytirën e tij*), nëse nuk do t'i dorëzonte vrasësit. Hafsa, e bija e Omerit, sikur pajtohej me të gjitha vendimet e Aishes edhe pas këtij ndryshimi për të shkuar në Basra, por atë do ta ndalonte vëllai i saj Abdullah Bin Omeri dhe kështu Aishja ngeli e vetme nga gratë e Pejgamberit. (Ejub: 236)

⁷ Disa historianë mendojnë se Aishja r.a. veproi kështu ngase ajo nuk e kishte qejf Aliun r.a. për disa arsye.

1. Se ajo kohë më parë kishte kaluar një situatë shumë të vështirë me bashkëshortin e saj Muhamedin s.a.v.s., kur në adresë të saj kishin shpifur, kinse ajo e kishte tradhtuar bashkëshortin e saj. Janë thënë disa kujtime të asaj kohe prej saj, rreth qëndrimit të Aliut në dëm të saj. (Xhahit: f. 146 dhe Shelebi: 1/617)

2. Se ajo nuk dëshironte ta pranonte atë për kalif, për shkak se Aliu r.a. nuk e kishte pranuar babanë e saj për kalif, që në ditën e parë. Ditën e parë Aliu ishte i zënë me xhenazen e Muhamedit s.a.v.s, ndërsa disa sahabë mendonin se Aliu do të ishte më i përshtatshmi për kalif. Kështu nuk ia kishin dhënë betimin Ebu Bekrit sepse ishte e mundur që ai të zgjidhej si kundërkandidat i tij. Atë ditë Aliu r.a. kishte thënë për Zubejri Ibën Avam se ai do të tërhiqte përkrahjen ndaj tij, sepse tek ai do të ndikonte djali i tij (Abdullahu). Vërtet të nesërmen Zybejri u tërhoq dhe ia dha besën Ebu Bekrit, më pastaj shkuan të gjithë të familjes së Hashimit dhe ia dhanë besën Ebu Bekrit. (Dinuri, f. 10)

3. Se ajo (Aisha) kishte debulesë ndaj djalit të Zubejrit dhe Esmës-Abdullahut. Asaj shpeshherë i thoshin nëna e Abdullahut. Meqenëse Aishja r.a. nuk kishte fëmijë, ajo e kishte marrë në mbikëqyrje djalin e motrës së saj, e cila ishte gruaja e Zubejri Ibën Avamit. Ai pretendonte të bëhej kalif dhe e xixiste 'nënë' e tij të ndikonte me autoritetin e saj në shoqëri... (Shelebi: f. 1/618) Se ajo i besonte shumë atij, na e vërteton edhe besimi i saj ndaj tij, kur ajo i besoi gënjeshtrës së tij derisa ushtria e saj po pushonte te Pusi i Havebit. Një prej mrekullive të Muhamedi s.a.v.s. është edhe thënia e tij: "Sikur ta dija se cilës prej jush do t'i lehin qentë e Havebit. "Kur Aishja i paska dëgjuar të lehurat e qenve, paska pyetur, mos vallë jemi te Pusi i Havebit dhe qenkam shkatërruar. Asaj fillimisht i paskan thënë se po, ndërsa ajo menjëherë paska kërkuar që të kthehej në Mekë, sepse vazhdimi i saj sipas paralamërimit të Pejgamberit s.a.v.s. ishte shkatërrim për të. Por, në këtë rast paska ndërhyrë Abdullah Ibën Zubejri dhe e paska bindur Aishen se nuk jemi te Pusi i Havebit dhe ajo më pas paska vazhduar rrugën për në Basra. (Taberi: 4/310, Ibën Kethir: 5/463, Shelebi: 1/619, Ejub: 236)

⁸ Shumica e historianëve vërtetojnë se Aliu kishte vetëm katër muaj në pushtet kur Talha dhe Zubejri kërkuan prej tij të shkonin për në Mekë.

Muslimanët ndërmjet Oksidentit dhe Orientit (2)



Dr. Murad W. HOFMANN

Mle joni të ilustruj disa momente absurde që mund t'i zbuloni kur të krahasoni Oksidentin me Orientin:

1. Vahji / shpallja kur'anore ka filluar me imperativin "ikre" (lexo!). Shikuar nga ky këndvështrim muslimanët duhet të jenë Ehlul-kitab (populli i librit) par excellence. Por megjithatë, analfabetizmi sot është tipik për vendet muslimane dhe praktikisht nuk ekziston në Perëndim.

2. Muslimanët kanë ndjenjë dhe vetëdije më të zhvilluar shoqërore se kushdo tjetër, duke iu falënderuar sadakasë dhe zekatit. Mes të tjerash, muslimani nuk mund të shkojë në haxh, gjersa komshiu i tij lëngon nga varfëria. Por, megjithëkëtë, dallimi ndërmjet të pasurve dhe të varfërve në vendet muslimane është i tmerrshëm. Para prezantimeve në netët festive në cilësinë e ambasadorit gjerman, shpesh ndodhte që bashkëshortja ime më ankohej ngaqë nuk mund të konkurronte karshi zonjave vendore, krahas faktit që përfaqësonte një shtet të pasur, pasi pasaniket e këtyre shteteve të vobekta kishin shumë margaritarë, diamante, smeralde dhe rubin. Atë e qetësoja, duke i sqaruar se personalisht ne nuk jemi të pasur, si këta persona pasanikë, por përfaqësonim shtet të pasur, kurse shteti i tyre është i varfër. Absurd, por realitet. Në Gjermani personat e papunë marrin ndihma më të mëdha sesa rroga mujore e dikujt që punon në një ndërmarrje tekstili në botën muslimane.

3. Në Perëndim nëse ndihmoni dikë në cilësinë zyrtare vetëm ngaqë është i afërt i juaj, gjykoheni për korrupsion. Në botën muslimane nepotizmi konsiderohet superioritet, sikur qëllimi për t'i ndihmuar të afërmit justifikon padrejtësinë ndaj të tjerëve. Rëndon, nepotizmi çon në situatë ku shumë poste

me rëndësi në shtet, ekonomi, madje edhe në shkencë, u dhurohen personave të pakualifikuar. Shteti i këtillë asnjëherë nuk mund të sfidojë barrierat për të arritur një zhvillim të mirëfilltë dhe është i gjykuar të qëndrojë nën mundësitë vetjake. Kjo është kostoja e korrupsionit, të cilën duhet ta paguajnë të gjithë.

4. Në praktikën e shoqërisë muslimane, autoriteti suprem i Allahut xh.sh., në një mënyrë është reflektuar në autoritetin ekskluziv të atit, vëllait më të madh, policisë, në veçanti, mësuesve dhe dijetarëve. Ky fenomen, i kombinuar me doktrinën e pafat të taklidit (imitimit të verbër), ka nxjerrë në pah mentalitetin imitues jokreativ. Arritja e rezultateve madhore në shkencë do të thotë skepticizëm struktural. Poeti gjerman shprehet bukur kur thotë: "çdo kush duhet mësuar/ të arrijë atë që ka trashëguar, që ta posedojë në të vërtetë".

5. Në historinë islame, shkencat humane kanë pasur prestigj të theksuar karshi shkencave natyrore. Si rezultat i kësaj, bota islame ka humbur superioritetin që ka pasur më herët kundrejt Perëndimit. Dekadencia në fjalë ka provokuar kolonializmin. Dekadencia nuk ka qenë rezultat, por shkak i kolonializmit. Gjersa edhe sot, nëse e lëmë mënjane profesorin pakistanez Abdusselam, i cili përndryshe ka qenë kadiani, nuk ka asnjë musliman që ka fituar çmimin prestigjioz Nobel në shkencat natyrore dhe mjekësi. Muslimanët akoma mburren me Ibni Sinanë, por vetëm në poezi.

6. Gjysma e njerëzimit në botë janë të gjinisë femërore. Sipas të drejtave dhe pozitës që u jep fjala e Zotit, femrat de facto nuk do të duhej të trajtoheshin si qytetarë të dorës së dytë, por si partner komplementar i mashkullit, në përputhshmëri me rolin që kanë luajtur në luftën e Uhudit dhe në përputhshmëri me rolin që ka luajtur Hatixhja r.a., megjithatë formulimi kur'anor "errixhalu kavamune alen-nisa" (En-Nisa, 34) komentohet nga meshkujt konform modës macho dhe shpirtit të injorancës.

Femrat në këtë mënyrë janë larguar

nga jeta politike, duke u reduktuar në analfabete, nga të cilat pritet të edukojnë djem me shpirt burri të vërtetë. Ky diskriminim ndaj femrave, është pretekst për dëm të dyfishtë: për prishjen e imazhit të Islamit në botë dhe pengon zhvillimin e shoqërisë muslimane. Në një mënyrë, kjo është një vetëvrasje. Femrat muslimane duhet t'i këshillojnë burrat e tyre që formulimin e lartpërmendur kur'anor mund dhe duhet ta lexojnë si "meshkujt janë mburojë e femrave".

7. Kam përshtypjen se në disa vende muslimane ekzistojnë oferta të panumërta, vetëm për në diell, zbavitje/ argëtim, fëmijë dhe kohë. Është interesante se perëndimorët - të cilët e konsiderojnë kohën para - asnjëherë nuk kanë kohë. Duket se jetën e tyre e shpejtojnë në mënyrë konstante. Në të kundërtën, popujt e Orientit duket se çdoherë kanë kohë. Për këtë shkak nuk ndihen fajtorë kur vonohen në randevu/takime. Në Perëndim, treni nis, p.sh. në 9 : 14 h. ose në 9 : 16 h. Në botën muslimane ata herë nisen në mëngjes herë në darkë. Humbja komulative, si pasojë e papërpikshmërisë është anormale. A thua në Islam është e lejuar humbja e kohës?

8. Gjermanët kanë tendencë për të qenë prefeksionistë - që akoma nuk është superioritet - dhe për këtë shkak i mësojnë automekanikët e botës muslimane të servisojnë dhe riparojnë Mercedes-in dhe Volkswagen-in në mënyrë perfekte. Por, kur këta automekanikë kthehen në vendet e tyre, nënçmohen nga bashkëvendësit, nga që mundohen kot. Kush brengoset se a do të punojë makina në vitin e nëntë të prodhimit, nëse e njëjta punon nesër?! Kjo është logjika e njerëzve, të cilët nuk kuptojnë se vlera e makinës nuk varet nga çmimi i blerjes, por nga ajo se sa kushton qëndrueshmëria e saj.

9. Në vendlindjen time, nëse ndonjë person arrestohet për burgosje, i njëjti fillimisht kërkon nga autoritetet e punëve të brendshme dokument identifikimi, më pas pyet për pretekstin e arrestimit. Më pas i burgosuri informohet rreth të drejtave: si të mbrohet para gjyqit, etj. Në

grykatë mundësitë që pushteti të fitojë janë statikisht të vogla karshi të paditurit, i cili mbron vetveten. Nëse gjatë arrestimit ka pasur kërcënime dhe frikë – nuk vjen në shprehje tortura – rasti ndërpritet, kurse policët pjesëmarrës në akt ndiqen në forma të ndryshme. Të drejtat e njeriut janë të garantuara edhe për të huajt, muslimanë dhe pjesëtarë të feve të tjera. Muslimanët mund të kërkojnë dhe të fitojnë që të ndërtojnë xhami dhe të shfrytëzojnë minaret për thirrje në namaz. Ata mund të paditin dhe të fitojnë autoritetet për të ndarë vajzat e tyre nga sportet e kombinuara. Femrat muslimane mund të paditin dhe të fitojnë punëdhënësit, të cilët pengojnë veshjen islame. Pyes: a thua këta rregulla vazhdojnë qoftë edhe për një shtet musliman?

10. Në vendlindjen time, si dhe në çdo shtet tjetër perëndimor, mbahen zgjedhje politike të rregullta, ku pjesëmarrja u mundësohet edhe partive fetare. Nuk ka nevojë për vëzhgues të jashtëm. Kutitë e votimeve janë të zbrazura kur sillen nëpër vendvotime. Askush nuk tenton të blejë/vjedhë vota. Votat numërohen nga përfaqësuesit e partive pjesëmarrëse në votime, e jo nga pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Duke pasur parasysh që gjithmonë ekziston një potencial që abstenon nga votimet, të sëmurë ose që kanë vdekur, asnjëherë përqindja e pjesëmarrësve në votime nuk arrin 99%. Partia që humb zgjedhjet, ia dorëzon postin të porsazgjedhurve. Tash u lë që ju vetë të gjykoni se cilat vende të tjera ndjekin një procedurë të kështillë.

IV

Nëse ju kujtohet si kam kritikuar vis-à-vis Perëndimin pak më parë dhe si e çmoj po këtë Perëndim tash, mund të pyesni se a po flas për të njëjtin fenomen. Po, Oksidenti është kombinim i shumëllojshëm: ajo që është e shëmtuar, është e keqe, ajo që është e pranueshme, është e mirë. Mu për këtë duhet potencuar që muslimanët nuk guxojnë të pranojnë dhe të konsiderojnë Oksidentin si alternativë të vetme ekzistente, e cila duhet ndjekur tërësisht ose refuzuar tërësisht. Të refuzosh ose të kopjosh është lehtë. Përzgjedhja është e rëndë. Por, duke u nisur nga ajo që prezantuar më lart, ne duhet të jemi selektivë.

Gjatë zgjedhjes së më të mirës, ndër sfidat më të mëdha që ballafaqohemi

është fakti që preferencat tona mund të kenë pasoja afatgjate ideologjike dhe morale, siç është rasti me automobilin dhe telefonat celularë. Edhe kur bëjmë zgjedhje, në atë që ofron Perëndimi, duhen pasur kujdes pasojat etike dhe ideologjike. Për këtë shkak themi se kur prekim teknologjinë perëndimore me gisht, ekziston mundësia që e njëjta të na tërheqë për dorë. Pjesërisht dhe vetëm pjesërisht, teknologjia perëndimore është zhvilluar nga një civilizim specifik, me paragjykime specifike afetare dhe amonale. Automobili paraqet liri fundamentale, me të cilën perëndimori fiton liri, madje, edhe nga prindërit. Telefonat celularë realizojnë ëndrrën për lidhje të pandërprerë. Po ashtu, ai zbulon se është a nuk është zonja e shtëpisë në shtëpi kur e thërret burri i saj. Disa makina janë të konstruara në atë mënyrë që detyrimisht duhet të punojnë pandërprerë, e cila implikon që njeriu të jetë vazhdimisht shërbyes teknik i saj, qoftë ramazan, kohë namazi ose jo.

Problemi tjetër me të cilin ballafaqohen muslimanët në Perëndim është fakti se Islami nuk është vetëm religjion, por është edhe civilizim. Kjo çështje nuk është problematike gjersa personi jeton në botën muslimane, me përjashtim nëse ndonjë person, i cili në përputhshmëri me shpirtin vehabi, nuk mundohet të mënjanojë disa risi, të cilat janë të pranuar nga komuniteti musliman dhe janë bërë pjesë e traditës së tyre, siç është kulti musliman i “shenjtorëve” i formësuar rreth tyrbeve; si p.sh. tyrbeja e Sejide Zejnebit në Kajro dhe ajo në periferi të Damaskut. Në Perëndim problemi qëndron ndryshe. Atje muslimanët detyrimisht duhet të vendosin se a është islame puna e tyre që punojnë, ose që kërkohet që ata të kryejnë dhe, nëse është, a është ajo pjesë e fesë së tij, ose vetëm pjesë e kulturës muslimane? Nëse është çështje e fesë, ne nuk kemi mundësi të bëjmë kompromis. Mu për këtë kur blejmë produkte ushqimore, harxhojmë mjaft kohë duke lexuar dhe kontrolluar paketimet se a përmbajnë ata mish derri. Do të vazhdojmë të luftojmë për të drejtën e therjes hallall dhe të varrimit në mënyrë tonë. Kam përshtypjen se këto momente dhe ezani duken si gjëra sekondare. Por, kur fillojmë të bëjmë kompromise në çështjet e sheriatit, qëndrojmë në sipërfaqe rrëshqitëse të përpjetë. Ku është

fundi i lëshimeve tona? Nuk ka veshje islame për femrat? Nuk ka agjërime gjatë ushtrimeve ushtarake? Nuk ka namaz në vendin e punës? Disa nga qeveritë perëndimore me të vërtetë shpresojnë se imigrantët myslimanë - tash p.sh. në Gjermani jetojnë mbi 2.7 milionë imigrantë myslimanë - do të asimilohen deri në atë shkallë sa do të paraqesin për shtetin, thjesht, një problem të vogël, siç është rasti me punëtorët e krishterë nga Spanja dhe Italia. Nëse ndodh një gjë e tillë, muslimanët do të humbin identitetin e vet dhe mundësinë të kontribuojnë në përmirësimin themelor të kulturës perëndimore. Politika jonë duhet të jetë jo ajo e asimilimit, por ajo e normalizimit. Muslimanët nuk duhet të asimilohen me qëllim që të jenë të pranueshëm nga të tjerët. Në anën tjetër, mund të bëhen kompromise në aspektet të cilat janë thjesht produkte të civilizimit, ose të cilat nuk bëjnë pjesë në suaza të detyrimeve të Sunetit. P.sh. nuk është e detyrueshme që ne të hamë ushqim në çarçaf të shtrirë në tokë, ose të pastrojmë dhëmbët me misvak, nëse posedojmë një, brushë dhe pastë. Mund të shërbehemi me thikë dhe pirun, gjegjësisht me dy duar, ngaqë në këtë mënyrë nuk e hamë ushqimin me dorën e majtë. Nuk është kusht të veshim gelabi ose thawb. As që kushtëzohemi të dimë gjuhën arabe. Thënë ndryshe, nuk duhet të shndërrohemi në arabë të shekullit të XVII-të për të qenë muslimanë të mirë. Islami nuk është fe arabe, as vetëm për arabët. Sipas jurisprudencës islame, për ne si muslimanë perëndimorë, është e lejuar, madje është edhe detyrë e jona, të respektojmë ligjet vendore, derisa të njëjtat na mundësojnë të ndjekim dhe kryejmë detyrat themelore të fesë sonë. Muslimanët historikisht kanë vepruar në këtë mënyrë kur ata kanë jetuar jashtë kufijve të Daru-l-Islamit. Prezenca e Islamit në vendet e jashtme, gjithmonë ka qenë avantazh për fenë tonë. Sot, muslimanët e Perëndimit mund t'i shërbejnë Islamit duke i ndihmuar që përsëri të zbulojë dhe jetësojë trashëgiminë demokratike.

Hulefai-rashidinët kanë qenë të zgjedhur secili në mënyrën e vet. Në rastin e Ebu Bekrit janë zhvilluar debate të hapura lidhur me çështjen se halifja i parë duhet të jetë nga radhët e ensarëve a muhaxhirëve, si dhe të jetë Ebu Bekri apo Omeri. Askund në botë nuk janë zgjedhur udhëheqësit aq demokratiki-

sht aq herët. Muslimanët jo vetëm që duhet të jenë pjesëmarrës në zgjedhjet në Perëndim, por ata duhet t'i llogaritin proceset zgjedhore si pjesë e bahçes islame. Po ashtu, sot muslimanët duhet të kuptojnë që shura, si marrëveshje mes pushtetit dhe elektoratit, në përgjithësi, kërkon përfaqësim parlamentar dhe duhet që të çojë drejt rezultateve të cilat janë detyrë e pushtetit. Kjo gjithashtu është pjesë e kopshtit islam. Mund të përkujtojmë momentet para luftës së Uhdit, kur Pejgamberi a.s. veproi sipas qëndrimit të shumicës, kur ishte në pyetje mbrojtja e qytetit.

Plotësisht e kuptoj rezervën dhe dyshimin që kanë të bëjnë me termin "demokraci", nga aspekti i qëndrimit ideologjik mbi "sovrانيتin" popullor, e jo të Allahut- si dhe për shkak të rolit të demokracive perëndimore në periudhën e kolonializmit. Nëse termi "demokraci" është i papërshtatshëm, flas si shejh Nahnah në Algjeri, mbi "shurokratinë", esenciale është që ne muslimanët, në Perëndim, si dhe shoqëria moderne egjiptiane e jordaneze dhe lëvizja En-Nehda në Tunizi me shejh Ganijsin, haptazi të favorizojmë mekanizmat që do të mundësojnë riorganizimin periodik të qeverisë dhe kontrollin e saj gjersa e njëjta është në pushtet, respektivisht, demokracinë në kuptim primar.

Më lart potenciam se muslimanët kanë mundësi të kontribuojnë në shumë aspekte për një të ardhme më të mirë të Oksidentit, duke ndihmuar në tejkalimin e krizës morale dhe shoqërore në të cilën gjendet për momentin Oksidenti. Jam plotësisht i bindur se Perëndimi ose do të mësojë nga Islami të respektojë dhe të çmojë disa vlera themelore të cilat atje janë të harruara, ose do të përfundojë në një katastrofë. Mund të jetoni kundër ligjit hyjnor përkohësisht, e jo përgjithmonë. Më lejoni të cek dymbëdhjetë kontribute potenciale nëpërmjet të cilave Islami mund të kontribuojë – jo për ngjyrosjen e Perëndimit me të gjelbër – por, për kurimin e tij.

1. Perëndimi lëngon nga paragjykimet racore. Islami, edhe pse nuk ka arritur që të eliminojë në tërësi këtë fenomen, megjithatë nuk ekziston religjion tjetër i cili ka arritur rezultate të mira si Islami në luftë kundër racizmit.

2. Perëndimi, krahas imperativit biblik "duaje komshiu si vetveten", definitivisht lëngon nga marrëdhënie të ftohta ndër-

shoqërore. Madje shumica e atyre që jetojnë në qytete, nuk kanë fare kontakte me komshinjtë dhe të afërmit e tyre. Umeti musliman dhe muslimanët në Perëndim demonstrojnë ngrohtësi, miqësi dhe gatishmëri për ndihmë reciproke, e cila u mungon fëmijëve të Perëndimit.

3. Të rinjtë në Perëndim urrejnjë hierarkinë në çdo aspekt të jetës: në punë, në kishë dhe familje. Islami është pluralist, madje, nuk njih sakramente, të cilat duhet t'i udhëheqë dhe realizojë kleriku. Nuk ka Papë në Islam. Muslimani i drejtohet drejtpërsëdrejti Allahut kudo që të gjendet, pa nevojë ndërjetësimi. Muslimani është besimtar i lirë nga kushdo tjetër. Edhe emancipimi është "in" (në të)!

4. Perëndimi mburret me racionalizëm. Por, në realitet, në vete ngërthen dogmat, si: mëkati fillestar, triniteti, mishërimi hyjnor, për këtë shkak nuk mund të konsiderohet racional si Islami. A nuk është Islami feja e vetme, Libri i shenjtë i të cilit i thërret njerëzit vazhdimisht të mendojnë, të meditojnë dhe të gjykojnë?

5. Muslimanët nga natyra janë popull që gjithmonë janë të vetëdijshëm e të arsyeshëm që paraqiten para Zotit dhe janë ata që u ndihmojnë të dehurve, që pas zbatimjeve të gjejnë shtëpitë e tyre. Sa i përket varshmërisë nga droga, dhe të ngjashme me të që sundojnë në Perëndim, muslimanët janë shpresa e vetme, qoftë në Los Anxhelos ose në Johaneshburg.

6. Asnjë shoqëri dhe shtet nuk mund të përballojë shkatërrimin e familjes. Në një ambient ku vetëm homoseksualët luftojnë për mbrojtjen e institucionit të kurorës (për vete), qëllimi i Islamit për ruajtjen e familjes bëhet esencjal.

7. Femrat në Perëndim përqendrohen në ruajtjen e dinjitetit të tyre. Gjatë procesit të emancipimit ato krahasohen me meshkujt, duke i kopjuar. Ato kanë fituar edhe vende pune dhe pavarësi ekonomike. Por, ato nuk kanë arritur të ruajnë dinjitetin personal. Femrat në Perëndim vazhdojnë të jenë objekt seksual, si deri më tash, duke ekspozuar çdo nuancë të bukurisë. Në këtë kontekst, muslimanet demonstrojnë qëndrimin si të ruajnë dinjitetin femëror.

8. Njerëzit në Perëndim janë në stres të përhershëm dhe për këtë shkak kanë nevojë për ndihmë psikiatrike. Namazi, lidhja e rregullt e muslimanëve me Zotin, është shumë efektive në kurimin e tëhuajësimit dhe mëvetësisimit, nga të

cilat lëngon njeriu modern.

9. Ashtu siç plakët shoqëria perëndimore, kapitali i madh gjendet në duart e vejanëve dhe sistemi kapitalist i stërngopur është në gjendje të humbasë vitalitetin e vet. Sigurimi çmohet më së shumti. Ekzistojnë sigurime nga çdo rrezik i mundshëm. Islami ndihmon në ruajtjen dhe mbrojtjen e shpirtit produktiv, duke insistuar që kapitali të jetë i shfrytëzueshëm jo për dobi fikse, por në mënyrë të ndarjes së fitimit dhe humbjes.

10. Po ashtu, Islami mund të njoftojë Perëndimin për qëllimin e mjegulluar që të vendosë interesat njerëzore në qendër të politikës ekonomike, duke kërkuar që të drejtave shoqërore dhe dinjitetit njerëzor t'i jepet primat para qëllimeve ekonomike.

11. Njeriu perëndimor, gjithnjë e më tepër, është i vetëdijshëm për dëmet që sjellin llojet e gabuara të ushqimeve. Ata mund të zbulojnë se muslimanët kanë pasur të drejtë çdoherë kur kanë refuzuar ngrënien e mishit të derrit, si ushqim i dëmshëm për organizmin e njeriut.

12. Për brengën e tyre të shëndetit, të mbështetur në kontrollin e peshës dhe parimet dietore, perëndimorët mund të zbulojnë Islamin dhe shtyllën e tij ramanin/agjërimin si një element modern.

Këto janë dymbëdhjetë kontributet individuale që mund t'i ofrojnë muslimanët për kurim/rehabilitim shoqërisë perëndimore. Ndoshta, ata një nga një nuk do të kenë ndonjë ndikim të konsideruar, por, kur këto qëndrime dhe besime do t'i pranojnë si tërësi, kjo do të paraqiste një revolucion shoqëror dhe moral. Megjithatë, dikush mund të thotë se këta komponentë nuk u takojnë vetëm muslimanëve. Kjo është e vërtetë, por dekrizterizimi i Evropës – jo edhe i Shteteve të Bashkuara – ka arritur pikën ku krishterizmi tashmë nuk ka asnjë shans që të bëjë revolucion moral, të detyrueshëm, për të shpëtuar Perëndimin. As që do ta bënte një gjë të tillë ndonjë "religjion" artificial, siç është shamanizmi modern. Vetëm Islamizimi i pjesshëm i Perëndimit mund të ndërrojë drejtimin e timonit, nga gjendja momentale, e cila po e çon Perëndimin në shkatërrim. Tash ngelet të presim se a do ta marrë Oksidenti barrën në këtë tavolinë. Ngelet që ju të vlerësoni. ■

**Nga boshnjakishtja:
Mr. Nasir REXHEPI**

Rini HYSENI

Në analizat e gjuhëtarëve, kjo temë është relativisht e re.

Për zhdukjen e gjuhëve është folur që prej vitit 1981, kur gjuhëtarja britanike Nancy Dorian publikoi një roman për zhdukjen e gjuhës galeike skoceze. Një vit më pas, Komisioni Evropian financoi krijimin e zyrës evropiane për gjuhët më pak të përhapura.

Po të shohim me kujdes, do të kuptojmë se ka një ndryshim të vazhdueshëm të gjuhëve: disa prej tyre vdesin, por ndërkohë lindin edhe të tjera. Zhdukja mund të ketë shkaqe të ndryshme. Një popull mund të zhduket ose të ndryshojë gjuhë. Megjithatë, ndonjëherë ndërhyjnë edhe faktorët politikë, si për shembull presioni kulturor i kolonizimit, i cili ka shkaktuar zhdukjen e shumë gjuhëve, sidomos në Amerikë dhe Australi, e gjetiu.

Në vitin 1899, një ligj japonez i detyroi ainutë, vendasit e ishullit të Hokaidos, të hiqnin dorë nga kultura dhe gjuha e komunitetit të tyre. Ligji u shfuqizua në vitin 1997, por sot gjuha aiun-e, që në të kaluarën flitej edhe në ishujt Sashalin, Honshu dhe Kurili, ka vetëm disa dhjetëra folës. Për t'i zhdëmtuar aiun-të u vendos që shenjat e qarkullimit rrugor të ishin dygjuhëshe.

Në skajin tjetër të botës, në Kamerun, në vitin 1995, gjuha luo ose kasabe flitej vetëm nga një person. Kur studiuesi që kishte bërë këtë zbulim, Bruce Connell nga Universiteti i Nju Jorkut, shkoi në atë vend në vitin 1996 për ta takuar, mori vesh se personi që kërkonte kishte ndërruar jetë prej pak kohësh.

Rreziku i zhdukjes së gjuhëve mund të vijë si nga faktorët e jashtëm – dominimi ushtarak, ekonomia, besimi, kultura – ashtu edhe ata të brendshëm, për shembull perceptimi i gabuar që ka një komunitet për gjuhën e tij. Gjithashtu, ka popuj që heqin dorë nga gjuha e tyre, sepse e konsiderojnë një pengesë ndaj progresit. Sot, zhdukja e gjuhëve është shpejtuar edhe nga dy tendenca: globalizimi i shkëmbimeve komerciale dhe urbanizimi në shkallë të gjerë, i cili favorizon homogjenizimin lingvistik (sot mbi 50 për qind e popullsisë së botës jeton në qytet). Studiuesit më pesimistë parashikojnë se gjatë këtij shekulli do

Zhdukja e gjuhëve


të zhduket 90 për qind e shtatë mijë gjuhëve që fliten aktualisht.

Në vitin 1996, UNESCO bëri botimin e parë të "Librit të kuq të gjuhëve në rrezik". Që nga ajo kohë veprat mbi argumentin në fjalë pothuajse janë trefishuar. Në vitin 2000, për shkak të frikës së fundshekullit, u publikuan shumë studime mbi të ardhmen lingvistike të planetit. Disa prej këtyre studimeve kishin tituj alarmues, si për shembull: "Vdekja dhe rilindja e gjuhëve", "Ndryshimet e gjuhës si trashëgimia e njerëzimit". Në raste të tjera toni ishte katastrofik, si "Zërat e heshtjes" dhe "Në gjurmët e gjuhëve që po zhduken", autorë të të cilëve ishin Daniel Nettle dhe Suzanne Romaine. Ndërsa disa studime të tjera kishin prekur çështjen e pasurisë, si për shembull "Vdekja e gjuhëve" e autorit David Crystal. Por, a është thelluar më tej kjo frikë? Për t'u përgjigjur kësaj pyetje, duhet të kemi parasysh përhapjen e gjuhëve nëpër botë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë se kontinentet nuk kanë të njëjtën dendësi gjuhësh: në Evropë flitet 3 për qind e totalit të gjuhëve, në Azi 33 për qind dhe në Afrikë 30 për qind. Kështu, duke pasur parasysh këto të dhëna, dimë se ka kontinente që janë të pasura me shumë gjuhë, të tilla janë Azia, Afrika dhe Oqeania e të tjera tepër të varfra si Evropa dhe dy Amerikat. Kjo shpërndarje e pabarabartë lidhet me vjetërsinë e shteteve dhe centralizimin e tyre. Ka gjasa që shtetet afrikane dhe ato aziatike do të bëhen centralizuese, duke humbur kështu pjesë të rëndësishme të gjuhës së tyre. Dihet që jo të gjitha gjuhët kanë të njëjtën peshë. Dymbëdhjetë gjuhët e para në botë, pra ato që fliten nga njëqind milionë persona, përfaqësojnë 0.2 për qind të totalit dhe 44.3 për qind të folësve të planetit. 72 gjuhët pasardhëse, që fliten nga dhjetë deri në njëqind milionë persona, përfaqësojnë 1.2 për qind të gjuhëve botërore dhe 38 për qind të folësve. 84 gjuhët e para të planetit (1.4 për qind e totalit) fliten nga 82.3 për qind e folësve. Ndërsa 55 për qind e gjuhëve flitet nga dhjetëmijë persona. Gjuhëtarët theksojnë që një gjuhë e folur nga më pak se njëqindmijë persona është në rrezik. Kur ka më pak se dhjetëmijë folës, gjuha është drejt një

fundosjeje të pakthyeshme. Këto janë vetëm disa nga të dhënat, por sipas studiuesve është e mjaftueshme për të parashikuar se në shekullin XXI mund të zhduken mesatarisht në harkun kohor të dy muajve nga 50 deri në 90 për qind e gjuhëve. Sigurisht që këto janë shifra mjaft shqetësuese, por gjërat nuk janë kaq të thjeshta. Në fakt, numri i folësve të një gjuhe nuk është treguesi i vetëm i vlerës së saj. Disa libra që lidhen me peshën e gjuhëve tregojnë ndikimin e parametrevave të tjerë, si për shembull: interneti, funksioni i gjuhës zyrtare dhe fluksi i përkthimeve. Një gjuhë e folur nga dhjetëmijë persona, të cilët as nuk e shkruajnë, as nuk e përdorin në internet dhe as nuk e konsiderojnë gjuhën e tyre zyrtare është më e rrezikuar se sa një gjuhë e folur nga një numër personash. Gjithashtu, një gjuhë jo shumë e përdorshme, folësit e së cilës jetojnë pa kontaktuar me botën e jashtme, për shembull jetojnë në një ishull të humbur, ose në qendër të një pylli amazonik, është më pak e rrezikuar se një gjuhë që është më e përhapur, por që flitet nga persona të cilët jetojnë në një qytet ku fliten shumë gjuhë. Studimi i historisë së gjuhëve na jep mjaft të dhëna. Në bazë të informacioneve që kemi, dimë se vetëm pak gjuhë ekzistojnë prej dymijë vjetësh, përveç ndonjë gjuhe të shkruar, siç është ajo kineze, sanskrite ose greqishtja (e cila ka pësuar ndryshime me kalimin e viteve). Megjithatë, disa gjuhë kanë lënë gjurmë të rëndësishme, edhe pse janë zhdukur. Për shembull, latinishtja është një gjuhë e vdekur, por u ka dhënë jetë shumë gjuhëve të tjera. Gjithsesi, latinishtja vazhdon të ekzistojë e mishëruar nga gjuhë të tjera. Sigurisht që gjatë historisë së tij njeriu ka folur shumë gjuhë, prej të cilave nuk kanë mbetur gjurmë. Sipas gjuhëtarit Mark Pagell nga Universiteti i Reading, numri i gjuhëve të folura nga njeriu (mes atyre të zhdukurave dhe aktuale) është rreth 140 mijë. Por, nëse sot janë rreth shtatëmijë gjuhë, kjo do të thotë se janë zhdukur 130 mijë të tjera. Ndërkohë, UNESCO flet për 30 mijë gjuhë të humbura. Megjithatë, në bazë të kësaj të dhëne mund të kuptojmë se sa e vështirë është të gesh numrin e saktë të gjuhëve të humbura. ■

Në teatrin 'Oda' është dhënë premiera e filmit "Në tokën mes kufijve" e regjisorit Arben I. Kastrati. Filmi ka për bosht identitetin.

Në tri toka



Identitetit është problem të cilin e kam trajtuar gjithmonë në veprat e mia". Me këtë fjali të regjisorit Arben I. Kastrati do të mund t'i qasëshim më lehtë filmit të tij më të ri. Edhe ky film i Arben I. Kastratit e trajton këtë problem në një mënyrë të veçantë, duke na paraqitur një histori, për një kohë të caktuar, të tre shqiptarëve nga tri vende të ndryshme: Kosova, Shqipëria, Maqedonia – të cilët kanë nevojë të ikin. Arben I. Kastrati, skenaristi dhe regjisor i filmit, takon rastësisht "në tokën mes kufijve" tre shqiptarët, shqiptarin nga Kosova, i cili ndien mungesën e atdheut, mungesën e identitetit kombëtar; shqiptarin nga Shqipëria, që ndjen pasojat e atdheut komunist që e ndjek, e dhunon; dhe shqiptarin nga Maqedonia të cilin shteti as që e trajton. Ky takimi i rastësishëm na sjell dramën që i përshkon këto tri personazhe, të cilët, si pasojë e besimeve dhe botëkuptimeve të ndryshme që kanë për atdheun, identitetin, kombin, botën, hasin në ndryshime dhe, shpesh, kjo sjell konfliktin. Të tre përfundojnë ndryshe nga ajo që kanë synuar.

Edhe pse premierë, salla bosh.

Sipas Kastratit "problem i identitetit e përcjell fatkeqësisht edhe në këtë kohë shoqërinë tonë, edhe pse ngjarja e filmit zh-

vilohet në vitin 1983, shqiptari nga Kosova vazhdon të kërkojë atdhe, në një mënyrë identitet të vetin, shqiptari nga Shqipëria vazhdon të ikë nga atdheu, në Maqedoni nuk trajtohem si shqiptarë, kështu që ne ende kemi probleme të pazgjidhura, të cilat mendoj që duhet të zgjidhen. Prandaj s'duhet të kemi frikë t'i zgjidhim problemet, por, përkundrazi, të ballafaqohemi dhe të merremi me probleme tona". Për këtë film është bërë gjithçka falë bashkëpunimit që mund të bëhej, me një buxhet shumë të vogël, "qesharak" - e cilëson vetë regjisorin.



Filmi është pothuajse komplet i financuar nga fondi i filmit të Maqedonisë dhe një pjesë nga Digjitalb. Kastrati, përveç skenarit dhe regjisë, ka luajtur edhe rolin e "shqiptarit" nga Kosova. Kjo, sipas tij, ka ndodhur nga pamundësia materiale. "Vullnetarizmit i ka ardhur fundi. Sikur të kisha më shumë buxhet, sigurisht, do të merrja aktorë, ndoshta dhe regjisor tjetër. Ne gjithë kohën ankohe mi për buxhet. Thjesht, kur do që të punosh, punon me aq sa ke".

Ai deklaroi se nuk ka punuar asnjëherë me buxhet të madh. Gjithmonë kur shkruan që të bëjë një film, e shkruan në atë mënyrë se si do të realizohej ai me buxhetin që do të duhej, mirëpo në pamundësi mandej e redukton krijimin, duke ia përshtatur buxhetit që ka. "Në tokën mes kufijve", përveç Arben Kastratit, luajnë dhe Adem Karaga, Muzbajdin Qamili, Vedat Haxhislami, Besnik Krapa, Ernest Zymberi, Denalda Teli. Aktualisht Kastrati është duke punuar në një projekt filmik tjetër dhe me një buxhet edhe më të vogël se "Në tokën mes kufijve". Xhirimet kanë filluar me 15 mijë euro. "A do ta kryej me ato para ajo, është temë tjetër" - thotë ai, mjafton vullneti për të krijuar.

Përgatiti: Flamur MALOKU

Kosova në ngërçin mes kul

Avni RUDAKU

Ekziston një vëshirësi e patejkalueshme për të filluar ndonjë refleksion mbi kulturën, e veçmas për kulturën në Kosovë. Megjithatë, do bëj përpjekje sizifi! Vetë kultura si nocion hap diskurs të ndërlikuar përkufizues. Në rezonimin mbi kulturën/kontrakulturën/vetëkulturën, madje çuditërisht nga orali i (jo)profesionistëve të shkencave sociale, hasim gabime koherente dhe semantike përkitazi me kulturën. Parafytyroni çfarë tërbimi na sjellin shprehjet kuturu që besohet se përkojnë me diagnoza vlerësuese për atë që është “kulturë” dhe “jokulturë!” “Ai nuk ka kulturë!”, “Shoqëri pa kulturë!”, “Sjellje pa kulturë!”, “S’ka kulturë në Kosovë!”, e të ngjashme. Sidomos për sociologun e antropologun nuk ekziston asnjë shoqëri pa kulturë. Kultura është elementi më universal njerëzor dhe shoqëror, që përfaqëson metaforikisht “thelbin metafizik e frymor të vetë qenies njerëzore”. Madje dhe fiset e ashtuquajtura me kalemin egocentrik “fise primitive”, kanë njëfarë kulture komplekse. Kultura, në fakt, shpreh kultivim, tendencë për zhvillim dhe vetëzhvillim. Synimet për përsosje, perfeksionizëm, vetënjohje e njohje, vetërealizimin e personalitetit të secilit, janë në interes të programohen përmes kulturës. Shpërfaqja e shpirtit kolektiv dhe individual nuk ka rrugë më qenësore të shprehet sesa përmes kulturës, respektivisht përmes vallëzimit, këndimit, poetizimit, prozës, filmit, me mënyrën se si flet, si komunikon... “Kultura përfshin në fakt gjithë mënyrën e jetesës së anëtarëve të një shoqërie. Mënyra e veshjes, sjelljes, pirjes, ritualet religjioze, arti, etj., janë çështje kulturore”. (Anthony G.) Por ajo që manifeston mutacionin kulturor të një shoqërie, siç është ta zëmë ky i shoqërisë kosovare, është “legjitimiteti i hapur” i “kontrakulturës” dhe “pashprehësia adekuate kulturore”.

Kultura krijohet në relacione ndërvepruese njeri-njeri, njeri-shoqëri dhe njeri-natyrë. Në këto polemika gnoseologjike, qeniet njerëzore shprehen dhe vetëshpre-

hen. Kur nuk shprehemi dot, ndrydhem në botën tonë të thellë subjektive, duke rrezikuar në njëfarë kuptimi dhe kalimin në “neurozë kolektive apo personale” (Freud). Me gjithë frojdizimin teorik që dhe vetë arti është një lloj metamorfoze neurotike, një gjë është më se e shëndetshme për proceset psikike njohëse, emocionale dhe motivuese të njerëzve: aftësia për të kanalizuar rrebet e instinktit përmes “rrugës kulturore/artistike”, që kodifikohet në mënyrë të pranueshme e të dobishme shoqërore. Kultura nuk është vetëm pragmatizëm i drejtpërdrejtë antropologjik, por tërthorazi na përvjedh qenësinë tonë. Hëpërhë duhet vënë në pah se kultura e diferencoi njeriun, evolucionarisht ose a priori, nga primatët e hershëm.

Sfidat e shoqërisë kosovare dhe kultura

Çfarë paraqitet si sfida për kulturën e sotme në Kosovë, respektivisht të një elementi të njëtrajtshëm të stërpërmendur të kulturës, siç është arti? Na sfidojnë disa devijime të natyrës etnopsikologjike, sociokulturore dhe botëkuptimore:

1. Pamundësia për t’u çliruar nga “robëria psikologjike” dhe ndikimi i frikës, për të thënë atë që ndiejmë, mendojmë ose atë që na dhemb;
2. Na pengon mosrealizimi në mënyrë të plotë i ndjenjës së çlirimit, së pari nga vetvetja e mandej nga të tjerët;
3. Sfidë jashtëzakonisht relevante na mëton joinsistimi maksimal, madje as minimal, për të lidhur traditën/modernen, të vjetrën/të renë/, nacionalen/kozmopoliten, personalen/lokalen/universalen;
4. Mungesa e një fryme të individualizmit kulturor kooperues dhe theksimi i modusit të shëmtuar të individualizmit snobist: individualizmi autik;
5. Të mosvepruarit për të inkurajuar artin si mënyrën më “ekonomizuese” për “popujt e vegjël”, të cilët për botën/kombet e mëdhenj nuk janë vetëm barrë/krizë/konflikt, por që pasurojnë jetën kulturore dhe artistike të mbarë njerëzimit. Pra, janë të varfër ekonomikisht, por të pasur në shpirtin kreativ për të dhënë diçka të karakterit universal (jo partikularitet);

6. Shoqërisë kosovare i çakërdiset deficit i lirisë psikologjike për të artikuluar të kaluarën, të tashmen dhe projektimin e të ardhmes. Duket si një ngërç i përdalë, që nuk lejon as përpunimin (lexo: kultivimin kulturor) mbi bazën e historisë, as mbi prurjet moderne “këtu dhe tash”, por as zhvillimin e shkallës së aspiratës, ambicies për të prodhuar të ardhmen nga vetvetja dhe të tjerët; nga relacioni me vetveten dhe për vetveten, si dhe nga vetvetja për të tjerët;

7. Indiferenca politike ndaj kulturores. Është një atmosferë e tanishme në Kosovë kur politika e sheh kulturën në distancë ekstreme me vetveten apo si “mbetje teknologjike”. Nëse politika shpreh “teknicitetin organizativ shoqëror/institucional”, atëherë kultura shpërfaq kontekstin shpirtëror/imagjnativ të këtij “tekniciteti sociologjik”. Politika kosovare çështjen e financimit/mbështetjes/stimulimit të zhvillimit të krijimtarsisë kulturore/artistike, e sheh



Kulturës dhe vetëkulturës (1)

akoma si diçka luksoze. Kulturorja gabimisht trajktohet si sekondare, jo e domosdoshme, jo produktive, jo aq e rëndësishme, jo prioritare... Investimi në imazhin e Kosovës do të ishte "çështja më kulturore", por përmes aksioneve në kulturë, gjegjësisht art;

8. Shoqërisë kosovare i duhet një "shpirt lëvizës", dialog sistematik ndërshoqëor, legjitimitet i garës/rivalitetit për vlera artistike, në përgjithësi, kulturore. Përveç idesë së pluralizmit politik, ngarendja të vjen edhe për llojllojshmërinë kulturore/zhanrore/lokale. Heqja dorë nga uniformizmi, por edhe nga snobizmi infantil. Investimi për kultivimin e një hapësire të "lojës" për të prodhuar artistiken përmes shtysave institucionale, qytetar, mediatic, autorial. P.sh., nëse përurohet një libër, duhet të iniciohet promovimi përgjatë emisioneve (ose imponohet) për audiencën e gjerë të mediave kosovare. Një shembull i mirë mund të jetë show televiziv në Shqipëri,

si "Zona e lirë", ku opinioni publik informohet tërësisht për publikimet e reja dhe njihet me autorët. Nuk ka nevojë autori të bëjë, së pari një gazetar mik, e pastaj të vijë në përrurim, ose t'i bëjë patjetër ftesë. Një përrurim libri është ngjarje kulturore/risi/lajm kolektiv dhe, jo një dasmë personale autoriale. Kjo e fundit më ra ndërmend kur botova librin "Poezi pa frymë", kur një mike më tha: "Të ishte parti/aheng, hing-me-hing kamera mediatike do të ishin aty prezente dhe, do të pyesnin: tung, tung, qa ka '3?'"

Vetëkultura kosovare

Konsideroj se dobia më e lartë në kontekstin e kulturës kosovare është ngacmimi shtjellues mbi vetëkulturën. "Ndër kërkesat e lashta të vetëkulturës është kujdesi për veten (kultivimi i vetes), e gjithë ajo që nga grekët e lashtë është quajtur më së shpeshti 'epimeleia heuatoú', e nga latinët 'cura sui'. Kjo kërkesë mund të shërbejë në një mënyrë si qark referues

e suazë e përbashkët për të gjitha ato që e shprehin kontekstin e vetëkulturës, sepse nuk mund të kujdesesh për veten pa e kërkuar, pa e njohur e zotëruar atë... Kujdesi për veten varet nga ajo se sa ka arritur individi ta njohë veten, t'i njohë motivet e veprimeve të tij, të gjykojë racionalisht për vetveten; domethënë, sa ka arritur si të bëhet i vetëdijshëm për veten e vet dhe për botën në të cilën jeton, ta njohë vetveten në tjetrin dhe tjetrin në veten e tij (ta tejkalojë partikularitetin e vet) dhe ta realizojë vetveten." (Bobi Gani: "Konteksti i vetëkulturës", (vepra-3) Dukagjini, Pejë, 1997, f.10-11)

Si shoqëri, e a njohim vetveten? A e dimë se çfarë dëshirojmë dhe ku synojmë të shkojmë? Çfarë fshihet e gugariset brenda nesh? A jemi shprehur sa kemi dëshirë? Sa e kemi lirinë individuale të realizojmë vetveten? Sa na bën presion ky kontekst yni shoqëror për t'u vetërealizuar? Si janë puqur kushtet për të komunikuar me vetveten dhe të tjerët e bashkësisë sonë qytetare e kulturore, ose edhe më gjerë, në ndërveprimin kulturor të arealit global? Të gjitha këto pyetje në fakt përbëjnë strumbullarin e vetëkulturës. "Edhe në filllet e nocionit të kulturës, që në formulimin e Ciceronit 'cultura animi', me të cilin nis historia e këtij nocioni, është postular ideja e vetëkulturës, si nevojë e domosdoshme e individit të kultivojë shpirtin dhe frymën e tij, që të kujdeset për zhvillimin e mëtejshëm të dhuntive e të virtyeteve të veta." (Po aty, f. 14)

Për ta kultivuar sensin sokratik mbi veten tonë individuale e shoqërore, nuk na mjafton vetëm mësimi, madje edhe disa gjëra të këtij mësimi, vetëm se na frenojnë për vetënjohje. Neve do të na ndihmonte sidomos çmësimi, siç shkroi dikur një ndër sociologët e rrallë shqiptarë të kulturës, Gani Bobi. "Kusht i parë dhe kryesor i pajisjes me diskurse të vërteta është (ç)mësimi (de-discere) nga mësimet e gabuara, sjelljet dhe shprehitë e këqija që mund të fitohen, qoftë nga mësuesit (prindërit, edukatorët, etj.), qoftë nga turma. Duke u (ç)mësuar individi tregon jo vetëm se e ka arsyen, por edhe se ka vendosur ta përdorë atë." (Po aty, f. 17) ■

(Vijon në numrin e ardhshëm)



Gjumi – “buton me natyrë”

**Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI**

Gjumi është një gjendje e natyrshme e pushimit të rregullt trupor. Ai është e kundërta e zgjimit dhe nuk është një gjendje e pavetëdijshme, por më tepër është një gjendje prehjeje trupore e mendore.

Gjumi karakterizohet nga një zvogëlim i vullnetshëm i lëvizjeve trupore, rënie e reaksioneve ndaj ngacmimeve të jashtme. Gjersa vetëdija është kujdesi ndaj mjedisit, gjumi është vetëm një gjendje e tjetërsuar e vetëdijes.

Dy veçori themelore e dallojnë gjumin me gjendjen e të qenit zgjuar: e para është që gjumi ngre një pengesë perceptivë (ndijore) midis botës së vetëdijshme dhe botës së jashtme, e dyta është që një ngacimim shqisor (p.sh. një zhurmë e fortë) mund ta tejkalojë këtë pengesë dhe ta zgjojë të fjetur.

Gjumi zë një kohë të rregullt të ciklit biologjik të njeriut, gjatë së cilit muskujt çlodhen, frymëmarrja ngadalësohet, po ashtu edhe rrahjet e zemrës. Truri punon shumë ndryshe, derisa disa qeliza të trurit ulin funksionin e tyre në minimum, disa të tjera e rrisin funksionin e tyre 5-10 herë.

Koha e gjumit është e kontrolluar nga ora cirkadiane. Kjo orë është një rregulluese e kohës së brendshme, ndryshimit të temperaturës, “pajisje” kontroluese e enzimeve - punon së bashku me adozinin (një neurotransmetues që është shumë i lidhur me proceset trupore me vigjilencë). Ritmi circadian është ai që e përcakton kohën ideale të një episodi të gjumit saktësisht të strukturuar.

Çdo cikël gjumi zgjat 90-110 minuta mesatarisht dhe çdo fazë mund të ketë një funksion të veçantë fiziologjik.

Fazat e gjumit janë përshkruar për herë të parë në vitin 1937 nga Alfred Lee Loomis dhe bashkëpunëtorët e tij. Ata i ndanë në bazë të elektroencefalografisë (EEG) tiparet e gjumit në pesë nivele (A deri E). Kjo i referohej spektrit nga syçeltësi deri në gjumë të thellë.

Tek gjitarët dhe shpendët gjumi është i ndarë në dy lloje: 1. Lëvizja e Shpejtë e

Syve (REM) dhe 2. Lëvizja Jo e shpejtë e Syve (NREM). Akademia Amerikane e Mjekësisë Për Gjumë, llojin e gjumit NREM e ndanë më tej në tri faza: N1, N2, N3.

Ciklet e gjumit REM dhe NREM normalisht fillojnë më fazat N1 → N2 → N3 → N2 → REM.

Faza N1 -Në këtë fazë gjumi është aq i lehtë sa që një individ që zgjohet gjatë kësaj gjendje thotë se nuk është e vërtetë që ka qenë duke fjetur.

Faza N2 -Kjo fazë zë 45% në 55% të gjumit të të rriturit. Këtu flihet pak më thellë dhe quhet gjumë themeltar.

Faza N3 -Këtu flihet më thellë dhe gjatë kësaj faze trupi e merr veten.

Gjumi me Lëvizjen e Shpejtë të Syve ose gjumi REM, përbën 20% -25% të kohës totale të gjumit të të rriturit.

Ëndërrimi është perceptim ndijor i imazheve dhe tingujve gjatë gjumit, në një sekuencë, në të cilën ëndërruesi zakonisht percepton më tepër si një pjesëmarrës i dukshëm, sesa si një vëzhgues. Ëndërrimi është i stimuluar nga struktura trunore e quajtur Pons dhe ndodh kryesisht gjatë fazës REM të gjumit.

Hulumtimet sugjerojnë se modelet

përdorim të dritës artificiale, nga mesi i shekullit 19-të, edhe “modelet” e gjumit kanë ndryshuar ndjeshëm kudo ku është futur ndriçimi, duke iu larguar kështu traditës së fjetjes me errësim dhe zgjimit me zbardhjen të ditës.

Njerëzit, në një sërë vendesh, flenë sipas kulturës së vendit dhe rrethanave të tjera. Disa flenë drejtpërdrejt në dysheme, të tjerët në një lëkurë ose batanije, të tjerët flenë në shtretër. Disa flenë të mbuluar me batanije, disa me rroba, disa me pizhame të thjeshta, disa me ose pa mbështetës të kokës-jastëk. Këto zgjedhje rrjedhin nga një varg faktorësh, të tillë si klima, mbrojtja nga grabitqarët, lloji i strehimit, teknologjia, kultura, kushtet socioekonomike etj. Në ditët e sotshme është instaluar nevoja e të fjeturit me jastëk si ndihmë për shtendosjen e muskujve dhe rehatinë e të fjeturit.

Truri dërgon sinjale elektrike, të cilat mund të maten me instrumente të veçanta. Këto sinjale të trurit ndryshojnë si te njeriu ashtu edhe te gjitarët e tjerë, ose edhe te një zog kur bie në gjumë. Por nuk vërehen ndryshimet në kafshë të tilla si peshku ose bretkosat, edhe kur këto kafshë duken sikur janë duke fjetur. Është

Kafsha	Koha e gjumit gjatë ditës në përqindje	Orët në gjumë gjatë 24 orëve
Tigri	65.8%	15.8 orë
Luani	56.3%	13.5 orë
Macja	50.6%	12.1 orë
Qeni	44.3%	10.6 orë
Peshku	29.1%	7 orë
Lopa	16.4%	3.9 orë
Elefanti Aziatik	16.4%	3.9 orë
Delja	16%	3.8 orë
Kali	12.0%	2.9 orë
Gjirafa	7.9%	1.9 orë

e gjumit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në kulturat e ndryshme. Disa popuj shfaqin një model të copëzuar të gjumit, ku njerëzit flenë në kohë të ndryshme të ditës dhe natës dhe për periudha të ndryshme. Me futjen në

vërejtur se sa më shumë mishngrënëse të jenë gjallesat, aq më e madhe është koha e tyre e nevojshme për gjumë.

Sasia optimale e gjumit nuk është një koncept kuptimplotë, ngase gjumi shikohet në lidhje me ritmin circadian


pushimi”

të një individi. Episodi i madh i gjumit është relativisht i efikas dhe i joad-ekuatur kur ndodh në kohën "e gabuar" të ditës. Duhet të shkohet në gjumë të paktën gjashtë orë para temperaturës më të ulët të trupit. Koha optimale e gjumit është kur parametrat cirkadian të poshtëshënuar ndodhin pas gjysmës së episodit të gjumit dhe para zgjimit:

- Përqendrimi maksimal i hormonit melatonin dhe
- Temperatura minimale e organeve vitale.

Meqë sasia optimale e gjumit nuk është një koncept strikt, edhe koha e nevojshme për gjumë të njeriu mund të ndryshojnë sipas moshës dhe mes individëve.

Fëmijët kanë nevojë për më shumë gjumë në ditë, deri në 18 orë për bebet e porsalindura, me një rënie të kohës për gjumë të rriturit dhe të moshuarit.



gjumë), kur gjumi përcillet me makt të natës, ëndrra të frikshme, jermi, zgjim të përnjëhershëm etj.

Çrregullimet kuantitative janë dy, më e shpeshtë është Insomnia (e merr gjumi me vështirësi dhe zgjohet herët) dhe Hipersomnia (gjumi i tepërt) është më e rrallë dhe konsiston në gjendjen e "etur për gjumë". Tek Ariu kemi një "hipersomni" normale që karakterizohet nga i ashtuquajturit 'gjumi dimëror'.

janë kafshët më të afërta me njerëzit, disa mendojnë se kjo cilësi biologjike mund të përdoret edhe nga njerëzit!

Ndër më të interesuarit për arritjen e vënies së njeriut në gjumë dimëror është enti i qeverisë amerikane për hapësirën NASA, e cila shpreson që një ditë të arrijë të dërgojë njerëz drejt galaktikave të reja dhe qytetërimeve jashtëtokësore. Që njerëzit në anije kozmike të rronin kaq gjatë, atyre do t'u duhej të flinin me muaj a me vite.

Nëse do të arrihej të viheshin në gjumë dimëror, organe të veçanta të trupit të njeriut do të mund të ruheshin me muaj të tërë, gjë që do të përbënte një revolucion në mjekësinë e transplantimeve, sepse sot për sot organet duhet të transplantohen brenda disa ditësh, nga shkëputja prej trupit.

Funksionet e gjumit

Janë propozuar teori të shumta për të shpjeguar funksionin e gjumit. Është e mundshme që gjumi ka evoluar për të përbushur një funksion të hershëm dhe ka marrë përsipër funksionet e shumta me kalimin e kohës. Ato pjesë të trurit që kanë qenë në veprim gjatë ditës, janë në veprim edhe gjatë natës. Mendohej se gjumi ishte vetëm një periudhë pushimi, por kohët e fundit është parë një lidhje midis kujtesës dhe gjumit. Ngase, pas një gjumi të rregullt, të nesërmen njerëzit kanë qenë më të përgatitur për të kryer zanatin e ri që kanë nisur ta ushtronin një ditë më parë.

Është vërejtur edhe se ata që nuk flenë sa duhet, e kanë të vështirë të mësojnë gjëra të reja.

Një gjumë i përshtatshëm është biologjikisht i domosdoshëm dhe duket i nevojshëm për të ndihmuar jetën. ■

Mosha	Koha optimale për gjumë gjatë ditës	Përqindja në 24 orët e ditës
I Porsalinduri	Deri 18 orë	75%
1-12 Muaj	14-18 orë	58% - 75%
1-3 Vjeç	12-15 orë	48% - 60 %
3-5 Vjeç	11-13 orë	44% - 52%
5-12 Vjeç	9-11 orë	36% - 44%
Adoleshentët	9-10 orë	36% - 40%
Të rrituri, përfshi edhe të moshuarit	7-8 (+) orë	28% - 32%
Gruaja shtatzënë	8 (+) orë	32%

Sipas zëdhënësit të shoqërisë gjermane të studimeve për gjumin dhe ilaçet për gjumë (DGFM) Göran Hajak, ata që flenë në kohë dhe sa duhet kanë shanse dy herë më të larta për të bërë karrierë më të mirë dhe për të pasur suksese në krahasim me ata që nuk flenë mjaftueshëm.

Çrregullimet e gjumit ndahen në kuantitative ose sasiore dhe në kualitative ose cilësore. Në kuadër të çrregullimeve kualitative të gjumit bënë pjesë Parasomnia (çrregullime të sjelljes në

Gjumi dimëror është ai në të cilin bien disa kafshë me fillimin e dimrit për t'u zgjuar përsëri në pranverë. Gjatë këtij gjumi procesi i metabolizmit në trup, që normalisht kryen djegien e karbohidrateve-sheqernave, ndërrohet gjendjen, duke u kthyer kështu në djegie të dhjamtit dhe yndyrave.

Në Marburg të Gjermanisë u zbulua, për herë të parë, se qysh bie në gjumë dimëror një lloj majmuni i familjes Lemure nga Madagaskari. Meqë majmunët

Sporti mbetet ende i izoluar

Me gjithë faktin se Kosova e shpalli pavarësinë dy vite më parë, sporti kosovar vazhdon të mbetet i izoluar, pasi kërkesat e shumta për anëtarësim në asociacione të ndryshme evropiane u refuzuan. Udhëheqësit e federatave kosovare ia hedhin fajin për këtë politikës, ndërsa besojnë se viti 2010 do të jetë vendimtar për pranimin e tyre në arenën ndërkombëtare



Alban BILALLI

D y vite pas shpalljes së pavarësisë, sporti kosovar u karakterizua nga shumë probleme. Kushtet e vështira financiare, mungesa e stadioneve dhe e palestrave sportive – ishin vetëm disa nga vështirësitë. Me gjithë këto vështirësi, garat vazhduan. Krerët e sportit kosovar bënë përpjekje maksimale që të anëtarësoheshin në federatat ndërkombëtare të sportit.

Kur më 17 shkurt u shpall Pavarësia e Kosovës, krerët e Federatave i shtuan apetitet se ai vit do të ishte fundi i vuajtjeve për njohjen ndërkombëtare të sportit kosovar. Tri janë arsytet pse sporti kosovar nuk pranohet ndërkombëtarisht: 1. Komiteti Olimpik i Kosovës nuk është pranuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), 2. Kosova ende nuk është anëtare e OKB-s dhe 3. Serbia dhe aleatët e saj po llojnë kundër sportit kosovar. Por, kundërshtarët më të mëdhenj janë federatat serbe që po llojnë kundër pranimin të sportit kosovar në federatat ndërkombëtare. Si pasojë e mospranimin të sportit kosovar, shumë talent dhe talente po shuhen. Por edhe ata sportistë, të cilët kanë arritur suksese në klubet e tyre, po i derdhen djersët për kombëtare të huaja e jo për atdheun e tyre, si Luan Krasniqi i cili bokson nën flamurin dhe himnin e Gjermanisë, Valon Behrami në atë të Zvicrës dhe shumë e shumë sportistë të tjerë.

Futboli

Ndërkombëtarizimi i sportit ishte në agjendën e çdo federate edhe në vitin 2009.

Federata e Futbollit të Kosovës po bën çështje e mundur që të pranohet në Federatat Ndërkombëtare të Futbollit FIFA dhe UEFA. Shumë shkresa me vulë të FFK-s dhe të kryetarit të saj janë dërguar në adresë të këtyre dy shtëpive të futbollit. Por përgjigjja e tyre ishte se

Kosova duhet së pari të pranohet si shtet ndërkombëtarisht, e më pas të pranohet prej tyre. Më 5 nëntor të vitit të kaluar u mbajt takimi më i rëndësishëm për futbollin e Kosovës, ku në selinë e FIFA-s krerët e futbollit të Kosovës, me në krye Fadil Vokrri, u pritën nga kreu i FIFA-s Sep Blater. Delegacioni i drejtuar nga Fadil Vokrri paraqiti tri kërkesa mjaft të rëndësishme: 1) Kosova të bëhet anëtare e FIFA-s dhe UEFA-s, 2) Kosova të lejohet që të luajë ndeshje miqësore deri në pranimin në këto dy organizma dhe 3) të rregullohet transferimi i lojtarëve kosovarë, ku nga transfertat e tyre, klubeve t'u paguhet dëmshpërblimi për prishjen e kontratave. FIFA ka premtuar se do të gjejë zgjidhje sidomos për transferimet e lojtarëve, por deri më sot asgjë konkrete nuk ka.

Basketbolli

Me të njëjtin problem si futbollit ballafaqohet edhe basketbolli. Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Erolld Belegu dhe asociacioni që ai drejton, do të provojnë edhe gjatë vitit 2010 që të pranohen në Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit FIBA. FBK-ja, në nëntor të vitit 2009, kishte dërguar një kërkesë në Bordin e FIBA Evropës, që kjo e fundit t'i rekomandojë FIBA Botës që ta pranojë Federatën e Basketbollit të Kosovës, nëse jo me të drejta të plota, të paktën me kushtëzime, por kërkesa e tyre nuk ishte marrë në shqyrtim fare. Kosova është i vetmi vend nga Ballkani që nuk bën gara as në ligën ballkanike të basketbollit. Edhe pse kjo ligë u zgjerua në vitin 2010, Kosovës iu refuzua kërkesa për pjesëmarrje në këtë ligë.

Duhet cekur se Federata e Basketbollit të Serbisë ka një ndikim të madh në FIBA dhe arsytet e refuzimit të kërkesës mund të jenë më shumë politike. FBK-ja pret që gjatë viti 2010 të bëhen zgjedhjet e reja në FIBA dhe shpreson që do të largohen disa anëtarë serbë që janë në Bordin drejtues të FIBA-s.

Hendbolli

Federata e Hendbollit të Kosovës është pranuar, me të drejta të kufizuara,

në Federatën Ndërkombëtare të Hendbollit më 18 dhjetor 2004, në Kongresin e 7-të të jashtëzakonshëm të mbajtur në Budapest. Tani për tani FFH-ja, ka të drejtë të zhvillojë ndeshje vetëm me klubet e saj, por jo edhe me përfaqësues. Me përfaqësues ka të drejtë të zhvillojë vetëm ndeshje miqësore. Gjatë vitit 2008, ajo ka zhvilluar ndeshje miqësore me Turqinë, Egjiptin etj. Kurse gjatë vitit 2009 nuk u zhvillua asnjë ndeshje mes përfaqësueses së Kosovës me ndonjë shtet tjetër. Kryetari i FFH-së, Mexhid Devaja dhe stafi i tij po llojnë nëpër vende të ndryshme që hendbolli i Kosovës të pranohet me të drejta të plota.

Sportet luftarake

Edhe sportet luftarake shpresojnë që të pranohen sa më shpejt ndërkombëtarisht dhe forcat e tyre t'i masin me sportistët e huaj.

Federata e Boksit të Kosovës, në shkurt të vitit 2009, priste nga Federata Ndërkombëtare e Boksit AIBA, që t'i pranonte nën ombrellën e saj. Kërkesa e Federatës së Boksit të Kosovës (FboxK) për anëtarësim në Federatën Botërore të Boksit Amator (AIBA) është refuzuar



Majlinda Kelmendi

më 18 shkurt 2009. Ky vendim është marrë në Kongresin e AIBA-s, i cili është mbajtur në Milano të Italisë. Refuzimin e kërkesës së kosovarëve e ka konfirmuar kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, i cili ka qenë i pranishëm në punimet e këtij Kongresi.

Sipas Hasanit, AIBA ka dhënë dy arsye për refuzimin e kërkesës së drejtuesve të boksit kosovar për anëtarësim në këtë asociacion.

“Kërkesa e Federatës së Boksit është refuzuar me arsyetimin se Komiteti Olimpik i Kosovës ende nuk është i njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe se Kosova ende nuk është pjesë e OBK-së.”

Deri me tani boksierët kanë marrë pjesë vetëm nëpër turne të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku sukseset nuk kanë munguar. Boksierët kosovarë presin me padurim anëtarësimin dhe kështu do t'u mundësohej rruga që t'ua “ajin hundët” kundërshtarëve të tyre.

Edhe Federata e Xhudos si dhe ajo e Karatesë presin që viti 2010 të jetë vit i pranimit të këtyre federatave në asociacionet ndërkombëtare të sportit, në mënyrë që xhudistët dhe karateistët kosovarë t'i masin forcat me kundërshtarët evropianë dhe botërorë.

Majlinda Kelmendi – ambasadore e sportit kosovar

Majlinda Kelmendi është një sportiste që po shënon suksese. Ajo nuk ka të drejtë të paraqitet me flamurin e Kosovës në garat ndërkombëtare. Herë duke përfaqësuar Shqipërinë, e herë nën flamurin e Komitetit Olimpik Botëror, ajo ka marrë pjesë në shumë gara ndërkombëtare. Tetëmbëdhjetëvjeçarja nga Gjakova, Majlinda Kelmendi, e cila vitin e kaluar e mbylli si kampione botërore në kategorinë e të rinjve, e ka nisur mbarë edhe vitin 2010. Në Kupën Botërore-kategoria A, që u mbajt në fund të janarit të këtij viti në Sofje, ajo ka fituar medaljen e argjendtë në konkurrencën e senioreve në peshën deri 52 kg, duke dëshmuar edhe një herë talentin e saj. Kjo medalje i solli Majlindës 60 pikët e para olimpike, pasi javë më parë ajo është futur në listën konkurruese për Lojërat Olimpikë “Londra 2012” nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF). Vitin e kaluar, Majlinda, në Kupën Botërore - kategoria A për seniore, që u mbajt në Pragë të Çekisë, doli e treta. ■

Me tespihe në dorë brenda dhe jashtë fushës së lojës

Trajneri i skuadrës ruse Rubin Kazan, Kurban Berdiev, për dallim nga trajnerët e klubeve të tjera në mbarë botën, mban në duar tespihe gjatë zhvillimit të ndeshjeve të skuadrës së tij, të cilën ai e drejton. Përderisa kolegët e tij si Murinjo, Benitez etj., që mbajnë në duar një laps dhe një fletë për të shënuar momentet më të rëndësishme të takimit, turkmenistani Berdiev mbanë në duart e tij tespihe gjatë gjithë takimit dhe i lutet Allahut për sukses. Ai tespihet i mban edhe kur del në konferenca për shtyp. Gjatë gjithë karrierës së tij si trajner, ai vetëm dy herë i ka harruar tespihet, dhe për ato 90 minuta është ndier në siklet të madh. Berdiev njihet si besimtar i madh i fesë islame. Çdo të premte ai shihet në namazin e xhumasë, të cilin e fal në xhami me besimtarët e tjerë. Berdiev e falënderon gjithshin e tij, i cili e mësoi të fal namaz që fëmijë dhe prej atëherë ai kurrë nuk i është ndarë namazit, edhe pse tërë jetën e tij e kaloi me aktivitete sportive. Madje ai është kundër atyre muslimanëve që për shkak të aktiviteteve sportive nuk e falin namazin. Ai u rekomandon atyre që namazet mund të falen edhe kaza, nëse ndeshja është në orar të njëjtë me faljen e namazit.

Sukseset për të dhe skuadrën e Rubinit nuk kanë munguar. Ai me skuadrën e Rubinit është shpallur dy herë kampion i Rosisë, në vitin 2008 dhe 2009. Të gjitha sukseset e tij, Berdiev ia dedikon Allahut. Kur më 2008 fitoi titullin e kampionit në Rusi, ai u nis për në Haxh për të kryer shtyllën e pestë të besimit islam, që është shkuarja në Haxh.

Rubin Kazani krenaria e Tatarisë

Kazani është kryeqyteti i Republikës së Tatarit me mbi 1 milion banorë. Me universitet qysh më 1804, i frekuentuar edhe nga Tolstoi dhe Lenini. Ky qytet është i njohur edhe për prodhimin e avionëve, kurse nafta e Tatarit përbën peshën më të sigurt në prodhimin tonësor të arit të zi në Rusi.

Klubi i Rubin Kazanit prej kur emëroi trajner Kurban Berdievin më 2001, arriti suksese të mëdha. Në vitin 2002, ai kaloi nga liga e dytë në ligën elite të futbollit rus. Më 2004 dhe 2006 ai mori pjesë në






Kurban Berdiev

garat e Kupës së UEFA-s, kurse më 2007 në Kupën INTERTOTO. Më 2008 dhe 2009 ai fitoi radhazi kampionatin e Rosisë. **Në vitin 2009, Rubin Kazani shkaktoi sensacion në futbollin evropian, duke shënuar një fitore 2-1 ndaj Barcelonës në Barcelonë.** Klubi katalan i Barcelonës nuk dinte për humbje në stadium të vet plotë dy vite. **Berdiev me armatën e tij e theu Barçën në “Kamp Nou”.**

Karriera e Berdievit

Karrierën prej futbollisti, Kuban Berdiev e nisi në moshën 19 vjeçare me klubin e vendit të lindjes Kolhozcy Aşgabat (Turkmenistan) më 1971. Ai ka luajtur në pozitën e mbrojtësit dhe të mesfushorit. Pas 6 vite qëndrimi në këtë klub, ai kaloi në klubin FC Kairat, më 1977. Pastaj e vazhdoi karrierën në skuadrat si Kolhozcy Aşgabat (1978-79), SKA Rostov-on-Don (1979-80), FC Rostov (1980-81) dhe e përfundoi karrierën e tij te klubi ku kishte luajtur më parë FC Kairat (1981-85). Pas një viti pauze, pasi vari këpucët në gozhdë, ai iu kthye futbollit, por tani në rolin e trajnerit. Së pari ai drejtoi klubin FC Khimik Dzhabul (1986-89). Më 1991 mori drejtimin e klubit FC Taraz, klub me të cilin ishte finalist në kupën e Rosisë. Për një vit drejtoi skuadrën turke Gençlerbirliği (1993-94). Në Kazakistan ai drejtoi dy klube, FC Kairat (1994-95) dhe FC Caspiy (1996-97). Në vendin e lindjes ai drejtoi klubin e Nisa Aşgabat (1997-99), duke fituar kupën dhe titullin e kampionit në Turkmenistan. Në viti 2000 u kthye në Rusi për të drejtuar skuadrën ruse FC Kristall Smolensk për një vit. Kurse më 2001 u emërua trajner i klubit Rubin Kazan, ku ende e mban me shumë sukses këtë post. ■

AGIMI GJASHI	NËN- NDARJET USHTARAKE	I DËRGUAR SPECIAL	PERKTHYESI I KUR'ANIT, AHMETI	BËRTHAMORE	ATLETI AMERIKAN, MONTGOMERI	EMNAK I AMARËS	RIPËR- TËRITJE	GRUP GJAKU	BASKET- BOLLISTI YNË, MEHMETI	LLOJ LLAMPE ELEKTRIKE	AUDIO VIDEO KERNEL		LLOJ FRUTE TROPIKALE	SHOVA				
AKTORI NË FOTO												SHKËLOJIM STOFI ROMAN I KAFKËS						
TRANS- METIMI								LLOJ EMBËLSIRE										
QË E KA SEMUNDJE NDEZJEN ME FLAKË								DORËZË TROKITESE E DERËS KIRIBATI										
HEROI I LUFTËS SË SPANJËS, VOKSHI					ROSAK KALIUMI						DAMARI I CJAKUT MËSUESE KOPSHTESH							
VARIANT I EMRIT REFIK						XEHA								TË FIKËT				
BROÇKULL										CA								
ENERGJIA	FURNIZIMET ME ARMË		SHKRONJA VII SHKELËS I RËNDË LIGJI												UNITED KINGDOM		50 ROMAK PORT DETAR	
SHKOP BILARDOJE				E VETME											FIGURË NË SHAH			
	RADIO REMOTE UNIT MONO- POLIZIMI														AUSTRIA		4 ROMAK KËNCËTARJA, HASIMI	
FJALË NË FUND TË LUTJES "FATIHA"															AJO PËR TË CILËN FLASIM			
SHKRIMTARI FRANCEZ, ALBERT															SHTET ARAB			
MEDRESEJA E MULLA IDRIZ GJILANIT															RINON			JO SHUMË
EMËR I HUAJ FEMRE										SULM, MËSYMJE	ME TË MIRË	PRISHJE E MAKINËS	NORVEGJIA	GJUHË AFRIKANE	AKTORJA, MARGARET IRNOSJE			FOSFORI ERZ
LLOJ PESHKU, LOJBE				"HYJI" ILIR I LUFTËS VARIANT I EMRIT OMAR												PJATA OPERË E VERDIT		
JO ABSOLUT													TOKA E BUKES TANTALI				DANIMARKA KALIMTARE	
IBRAHIM TUKIOI			SHUMË E GJATË MAURICIUSI											I VOGËL I DHISË				
METRI		RROTKË PENJSH KALIUMI							KAMJE, PASURI EDHE									
MBATHUR KËMBËVE					SILICI			SMALT					SHKRONJA VI					

PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



INDEPENDENT

KOSOVA

Dr. Milazim Krasniqi:
**KOSOVËS I DUHET NJË PROGRAM I RI PËR FUQIZIM,
I MBËSHETUR NË FAKTORIN SHQIPTAR**

Avni Avdiu:
'NGA KOSOVA REPUBLIKË!' NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Muhamet Jahiri:
PREKAZI MERITON MË SHUMË

Iljasa Salihu:
**SI E PËRJETUAN SHQIPTARËT E MAQEDONISË MOMENTIN
E SHPALLJES SË PAVARËSISË E KOSOVËS**

INTERVISTA ME: RAMË BUJËN, ISMET BEQIRIN,
BAJRAM KOSUMIN, NASER RUGOVËN DHE XHEVDET NEZIRAJN

Kosova në dyvjetorin e pavarësisë

Kosovës i duhet një program i ri për fuq

Kosova u bë shtet në saje të rezistencës shqiptare brenda vendit dhe kontributit të miqve të saj, por Kosova shtet stabil dhe i qëndrueshëm ekonomikisht dhe me vlera të vërteta shoqërore, nuk mund të bëhet pa ndihmën e koordinuar dhe afatgjatë të bashkatdhetarëve që janë të shpërndarë në Turqi, në SHBA dhe në Evropë



Dr. Milazim KRASNIQI

Dyvjeteri i pavarësisë së Kosovës, pavarësisht se me çfarë solemniteti do të kremtohet, shënon edhe pikën e fundit të të ushqyerit të banorëve të saj shqiptarë me idenë se pavarësia vetvetiu do t'i zgjidhë të gjitha problemet e shoqërisë në këtë vend. Edhe pse për këto dy vjet të shtetit të pavarur, nuk kanë munguar përpjekjet e qeverisë aktuale për të përmirësuar jetesën e qytetarëve të këtij shteti të ri, rezultati nuk është shumë inkurajues. Një seri e protestave dhe e grevave, përfshirë edhe një grevë problematike të disa njësive të policisë së shtetit, dëshmojnë se kërkesat sociale kanë dalë dhe po dalin me shumë ashpërsi në plan të parë. Pakënaqësia në rritje e punëtorëve të shumë sektorëve, dëshpërimi i dhimbshëm i pensionistëve dhe i të papunëve, tashmë sajojnë një tablo jo edhe aq optimiste. Storia sipas të cilës shqiptarët e Kosovës ishin populli më optimist i botës, i përket të kaluarës, kur ideja e pavarësisë kompensonte mungesat e tjera. Ai optimizëm po shkrin me shpejtësi dhe është rreziku potencial që të shndërrohet në një ortek social, i cili nëse do të keqpërdoret politikisht nga forca antiqeveritare, mund të tronditë edhe themelet e vetë shtetit.

Vetvetiu shtrohet pyetja: pse nuk ka rezultate të prekshme të zhvillimit ekonomik dhe të përmirësimit të jetesës së shumicës së qytetarëve të vendit, megjithë përpjekjet

e bëra nga qeveria dhe nga partnerët ndërkombëtar? Përgjigja, si edhe vetë pyetja, është krejt e qartë: sepse për këto dy vjet të pavarësisë dhe për ato nëntë vjetet e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, nuk është gjetur formula e aktivizimit të potencialeve të brendshme të popullit shqiptar, për të nisur një proces dinamik të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Politikat e UNMIK-ut dhe të qeverive të mëparshme të Kosovës, kanë qenë unike në një pikë: në luftimin e fuqizimit të shqiptarëve, si subjekt dhe bartës i shtetësisë dhe i marrjes së përgjegjësisë për fatet e vendit. I tërë privatizimi i pasurive publike në vitet e kaluara, është bërë duke injoruar interesat ekonomike dhe shoqërore të Kosovës, përkatësisht duke punuar ashtu që kapitali i përfituar nga privatizimi, mos të bëhej infuzion i zhvillimit

ekonomik të vendit dhe as i rritjes së punësimit. Nga procesi i mbrapshtë i privatizimit është krijuar një kastë pasanikësh që kanë akumuluar pasuri me abuzime të mëdha e të cilët pasuritë e fituara nuk i kanë vu në shërbim të zhvillimit të vendit, po të rritjes së varfërisë e të papunësisë. Mbajtja e importeve në vlera absolute, bashkë me dëmtimin e buxhetit të shtetit me fshehje tatimesh, është tregues i moralit të kësaj elite të re pasanikësh të rinj. Në tërë këtë proces, po edhe në procese të tjera administrative, është vërejtur edhe një prirje komplotiste ndaj fuqizimit të shqiptarëve në shtetin e ri: përjashtimi i bashkatdhetarëve nga mundësia e pjesëmarrjes, e konkurrimit dhe e investimit në ekonominë e re të Kosovës. Përjashtimi i bashkatdhetarëve tanë është bërë me sistem nga ana e UNMIK-ut

në fillim, me synimin që të mbajë Kosovën sa më lehtë nën sundim. Mosdhënia e dokumenteve elementare si letërnjoftimi dhe dokumenti i udhëtimit, për bashkatdhetarët tanë, ka qenë shenjë e qartë e luftimit të prezencës dhe e kontributeve të tyre në shtetin e ri. Ashtu ka filluar të zhvillohet një ftohje e tyre me Kosovën dhe një dekurajim sistematik administrativ lidhur me vullnetin e tyre për të investuar në vendin e vet të origjinës. Ideja e vetëmjaftimit të politikanëve dhe të biznesmenëve vendas, e stimuluar nga politikat proserbe të UNMIK-ut, e ka bërë gjendjen pothuajse të ngrirë. Përjashtimi i bashkatdhetarëve nga çfarëdo mundësie e investimeve dhe e kontributeve reale politike e sociale, sot për sot është fakt i kryer. Bile edhe nëse ata vijnë për të kremtuar në dyvjetorin e pavarësisë së Kosovës, duhet të paguajnë



izim, i mbështetur në faktorin shqiptar

një gjobë prej pesëdhjetë eurosh për sigurimin e veturave të tyre, përderisa serbët hyjnë jo vetëm pa pagesa të tilla, por edhe pa tabela!

Në fakt, ne sa herë që flasim për bashkatdhetarët, për diasporën shqiptare të Kosovës, në mënyrë naive mendojmë vetëm për bashkatdhetarët tanë në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, kështu ne përjashtojmë kontingjentin më të madh të bashkatdhetarëve: shqiptarët në Republikën e Turqisë. Një pjesë e kësaj diaspore ende është shumë aktive dhe e fuqishme në vullnetin e saj për ta ndihmuar atdheun e të parëve të vet, me investime në shkollim dhe në ekonomi. Por, edhe ata deri sot kanë qenë të injoruar, sa nga mosnjohja e potencialeve të tyre, aq edhe nga paragjykimet që ka injektuar historiografia serbe ndaj Turqisë. Edhe pse ka filluar një ndryshim i qëndrimeve të ndryshkura të doktrinaeve serbe, kthjellimi nuk po ndodh me shpejtësinë e nevojshme, së paku në aspektin e trajtimit të bashkatdhetarëve tanë në Turqi si pjesë e trungut kombëtar dhe si potencial për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit tonë. Nga jeta e gjatë në robëri dhe nga jetesa në një vend të vogël, shumicës prej nesh në Kosovë, na është injektuar një mentalitet provincial, një ndjenjë e vetëmjaftimit dhe e vlerës së rreme, një prirje për t'u kapardisur e për ta mbështjellë injorancën me mendjemadhësi e me agresivitet. Po të mos ishte kështu, nuk do të ishin kthyer mbrapshtë të zhgënjyer me qindra bashkatdhetarë nga Evropa, Amerika dhe Turqia, që kanë ardhur për të hulumtuar mundësitë e investimeve në këtë vend. Fatkeqësisht në Kosovë ka ndodhur, ndër shumë deformime të tjera, edhe deformimi i të vërtetës për çlirimin e vendit: kontributet praktike (pjesëmarrja në luftë) të shumë njerëzve janë legjendarizuar tej mase dhe ashtu është krijuar ideja se shteti i ri ekskluzivisht është meritë e tyre. Rrjedhimisht, edhe favorët u dashka t'u përkasin me shumicë atyre, qoftë dhe me reket e me pastrim parash. Kur deformohet kështu pamja e të kaluarës së afërt, për të cilën të gjithë ne kemi kujtesë të kthjellët,



ai deformim vetvetiu bëhet iritues për shumicën e bashkatdhetarëve, që kanë kontribuar, por që nuk janë shndërruar në "heronj të gjallë". Si për të kompletuar paradokset tona, kohët e fundit ka filluar edhe një përpjekje agresive e deformimit të historisë nën siglën "Rishikimi i historisë" ku hisen në radhët e "heronjve të gjallë" kanë filluar ta kërkojnë edhe ish-integristët jugosllavë! Jam i sigurt se deformime edhe më të rënda do të ndodhin në vitet që vijnë edhe në raport me historinë e afërt e edhe me aktualitetin, nëse nuk ndryshon diçka esencialisht në programin qeverisës dhe shtetëror të vendit tonë.

Pika e parë e një programi të tillë duhet të bazohet në një fakt të parrëzueshëm nga ana e fakteve: Kosova u bë shtet në saje të rezistencës shqiptare brenda vendit dhe kontributit të miqve të saj, por Kosova shtet stabil dhe i qëndrueshëm ekonomikisht dhe me vlera të vërteta shoqërore, nuk mund të bëhet pa ndihmën e koordinuar dhe afatgjatë të bashkatdhetarëve që janë të shpërndarë në Turqi, në SHBA dhe në Evropë. Dy vjet pavarësi, me ngecje krahas angazhimeve të sforcuara qeveritare, (ndërtimi i rrugëve, themelimi i Universitetit të Prizrenit), po e konfirmojnë këtë gjë. Prandaj, politikat qeveritare dhe shtetërore duhet të

ndërtojnë një program të veçantë për zhvillimin e vendit, duke u mbështetur shumë më shumë në kontributet e bashkatdhetarëve tanë nga Turqia, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, një program i atillë do të bëhej i zbatueshëm vetëm nëse paraprakisht qeveria dhe e tërë shoqëria jonë i shpallin luftë të ashpër korrupsionit, reketit, kontrabandës e trafikimit dhe nëse i mposhtë ato me dorën e shtetit ligjor.

Në të kundërt do të rritet pakënaqësia në vend, destabilizimi dhe do të bëhet kërcënues rreziku i dështimit të shtetit të ri, i cili u bë me gjakun dhe me vuajtjet e mijëra shqiptarëve, por po zbehet me paudhësitë e mijëra të tjerëve. Nëse shteti ynë do të dështonte, përvjetorët do të bëheshin të pavlerë, disi ngjashëm me përkujtimin e të vdekurve, të cilët përkujtohen por pa asnjë shpresë se do të ngrihen më në këmbë në këtë botë. Prandaj në përvjetor si ky dyvjetor i pavarësisë së Kosovës, më shumë se sa pompozitet festiv, duhet reflektim, duhet mobilizim politik e shoqëror, duhet një program i ri kombëtar, për ta fuqizuar shtetin tonë të ri, i cili është një garanci që të jetojmë si njerëz të lirë dhe me dinjtet, në tokën të cilën i lumi Zot na e ka dhënë dhuratë, jo për ta nëpërkëmbur, po për t'i dhënë kuptim jetës sonë në këtë botë. ■

Intervistë me deputetin e Kuvendit të Kosovës, nga radhët e PDK-së, Ramë Buja

Kosova si shtet i ri ka arritur shumë

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Një orë para se të hyja në seancën për të nënshkruar Dokumentin e Pavarësisë së Kosovës unë jam mbyllur në zyrën time dhe kam kujtuar shumë shokë, dashamirë, bashkëluftëtarë dhe bashkëveprimtarë që ishin më të mirë se unë, por nuk e pritën këtë ditë”, - në këtë mënyrë tregon emocionet e tij të shfaqura një orë para Deklaratës së Pavarësisë deputeti nga radhët e PDK-së. Ai thotë se në Kosovë ka pasur arritje të mëdha gjatë këtij dy viteve, por nuk duhet të kënaqemi me këtë sepse ka ende shumë punë për t'u bërë. Sipas tij, shteti ynë është shumë i ri dhe nuk duhet të krahasohemi me shtetet e krijuara shumë më herët, sepse ne tashmë jemi duke i ndërtuar institucionet. Ai mendon se Kuvendi i Kosovës është njëri nga institucionet, i cili ka pasur më së shumti sfida, por edhe suksese. Për më shumë, me rastin e dyvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës flet në një intervistë deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ramë Buja

PAQJA: Tashmë Republika e Kosovës po i afrohet dyvjetorit të pavarësisë. A mund të na thoni komentimin tuaj në këtë drejtim?

BUJA: Ne po gëzohemi që po i afrohem dyvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Është një periudhë e shkurtër pavarësie, në krahasim me shtetet dhe republikat e tjera të rajonit dhe të botës, por mund të them se ne jemi krenarë që po festojmë dyvjetorin e pavarësisë. Pavarësisht si e shohim gotën: të zbrazur a të mbushur, unë konsideroj se në këtë dyvjetor janë arritur rezultate të shumta, jo ndoshta më të dëshiruarat dhe më të synuarat, por unë mendoj se ka arritje në shumë sfera, ndonëse jo synimet që kemi pasur.

PAQJA: Sa mendoni se Kosova ka shënuar progres brenda periudhës dyvjeçare të pavarësisë së Kosovës?

BUJA: Mund ta them shumë hapur që, përveç asaj që kemi bërë si hap të parë, kemi bërë kushtetutën, kemi bërë ligje bazike për funksionimin dhe funksionalitetin e shoqërisë kosovare, kemi arritje në çështjen e zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore dhe

shkollore, pastaj kemi edhe rritje të vogla pagash në sektorë të ndryshëm, etj. Këto janë hapa të vegjël, por, megjithatë, për veprimin tonë janë të dukshme. Mirëpo synimet janë shumë më të mëdha sesa janë mundësitë dhe kapacitetet tona, por ja që jemi në këtë pozicion që jemi.

PAQJA: Ju keni qenë edhe nënshkruesi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. A mund të na përshkruani se si jeni ndier në ato momente?

BUJA: Emocionet kanë qenë shumë të përziera. Një orë para se të hyja në seancën për të nënshkruar Dokumentin e Pavarësisë së Kosovës, unë jam mbyllur në zyrën time dhe kam kujtuar shumë shokë, dashamirë, bashkëluftëtarë dhe bashkëveprimtarë që ishin më të mirë se unë, por nuk e pritën këtë ditë. Por unë nuk kam pasur mundësi të jem aq i gëzuar si një njeri i cili vë firmën në Dokumentin e Pavarësisë së shtetit të tij për vetë faktin se kishte më të mirë se unë dhe nuk arritën të jenë në mesin tonë. Gjatë nënshkrimit të Dokumentit të Pavarësisë së Kosovës kam pasur gëzim, krenari dhe dhimbje, njëkohësisht.

PAQJA: Sa mendoni se Kuvendi i Kosovës ka punuar gjatë këtyre dy viteve të pavarësisë së vendit?

BUJA: Kuvendi i Kosovës gjatë këtyre dy viteve të pavarësisë së vendit ka pasur shumë sfida, shumë pengesa, por edhe të arritura. Nëse mund të thuhet se a i ka realizuar objektivat e veta kuvendi gjatë këtyre dy viteve, unë mund të them se i ka realizuar, por jo përafshirë në tërësi, sepse ka pasur pengesa të shumta në procedura të shumta, në ofrimin edhe të projektligjeve për t'i realizuar dhe për t'i bërë ligje. Unë konsideroj se Kuvendi i Kosovës ka bërë një punë solide, por jo ajo që është pritur.

PAQJA: Për fund, cili është mesazhi juaj me rastin e dyvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës?

BUJA: Mesazhi im për Ditën e Pavarësisë së Kosovës është t'i gëzohemi këtij dyvjetori dhe uroj që ta presim përvjetorin që do të vijë me gjithë të mirat e mundshme. ■





'Nga Kosova Republikë!' në Republikën e Kosovës

"Po të kishte çmim Nobel për heroizëm, pa dyshim se do ta fitonte Adem Jashari"

Bernard KUSHNER Drenicë, gusht '99



Avni AVDIU

Këto ditë, shqiptarët kujtuan 17 shkurtin e vitit 2008. Dy vjet më parë Kuvendi i Kosovës e shpalli Kosovën shtet të pavarur. Ëndrra shekullore e shumë brezave u bë realitet. **Kosova Republikë!** - dikur ishte vetëm parullë e shkruar në mure, e brohoritur në demonstrata, e shënuar vetëm në ilegalitet, kurse tanimë është ideal i jetësuar dhe i deklaruar legalisht në mënyrë institucionale, nga të zgjedhurit e popullit dhe me aprovimin e shumicës së vendeve demokratike.

Ky ndryshim kaq rrënjësor i zhvillimit të rrjedhës së historisë kombëtare ndodhi me angazhimin permanent të bijve e bijave më të shquar të popullit, por edhe me ndihmën e miqve tanë ndërkombëtarë. Ishte para së gjithash Zoti në anën tonë, që e kurdisi fatin asisoj, ashtu që edhe disa armiq të mëparshëm historikë i shndërroi në

miq. Pra, për fatin tonë të mirë u zhbë sistemi famëkeq komunist, i cili ishte më i zi se murtaja, më i tmerrshëm se gogolët e përbindëshat përrallorë, si këtej ashtu edhe matanë kufirit të shtetit amë. Pastaj deshi, gjithashtu, Zoti që krisma e UÇK-së të ndodhë në momentet më të volitshme, atëherë kur u identifikua faktori në shumë fushëbeteja dhe pritej vetëm ndëshkimi kolektiv i tij dhe atëherë kur në arenën ndërkombëtare,

për fat të mirë, nuk kishte kriza madhore me përmasa botërore të tilla siç ndodhën menjëherë më pas (11 shtatori-Afganistani etj.), e të cilat ishin më prioritare për Amerikën dhe aleatët e saj strategjikë. Pra, u pleksën shumë faktorë të ndryshëm.

Deputetët e parlamentit, të zgjedhur po ashtu në mënyrë legjitime, e kishin shpallur **Kosovën Republikë** edhe një herë tjetër. Por që nga ai moment veçse





u shtua robëria serbe edhe më tepër. Regjimi i hekurt nuk i njihte parimet demokratike, ai e njihte vetëm gjuhën e fishkëllimit të armëve. Mu për këtë u desh përgatitja e konsoliduar e trimave dhe trimëreshave për ta kthyer atë përgjigje të merituar. Shkrepja e armëve të tyre drejt armikut, hodhi shkëndijat e para të lirisë së shumëpritur.

Prandaj është detyrë morale e secilit që në këtë përvjetor të përkujtojë të gjitha ata që dhanë gjënë më të çmuar për këtë ditë, të kujtojë më pas edhe ata që janë gjallë e që ishin shokë të tyre në çastet më dramatike kur vendosej për fatin e kombit, të sjellë ndërmend sakrificat e shumta që dhanë personal-

itetet më të shquara të lëvizjes për liri e pavarësi. Le të mos harrohen as vuajtjet e popullit të pambrojtur, persekutimi, dëbimi, masakrimi dhe tmerret e tjera. Pra le të shërbejë kujtimi për të gjitha këto si shenjë e kuptimit të domethënies së vlerës që ka të qenët i lirë.

Sot kur Kosova, ndonëse me disa probleme, po ecën e sigurt drejt integriteteve evropiane dhe kur të mirat po vijnë, edhe pse me disa të këqija, të gjithë duhet të kenë durim, por jo pasiv të pritjes përtace, po durim aktiv për të kontribuar që ato të mirat të vijnë. Populli thotë shumë mirë se të këqijat vijnë shpejt, ndërsa të mirat ngadalë. Mirëpo ne duhet të punojmë, e jo të presim e të

bëjmë sehir. Pushteti aktual nuk duhet t'i lejojë vetes komoditetin e tepruar për t'i neglizhuar hallet e popullit, në veçanti të asaj shtrese në saje të sakrificës së të cilës ndodhet në pozitë. Qeveritarët duhet të rrojnë me drojë se populli s'harron dhe ndëshkon. Opozita duhet të jetë sa më konstruktive e parimore, të mos e ndërtojë strategjinë e veprimit vetëm në kritika amorfë, por më tepër në sugjerime e ide që do të jepnin zgjidhje për problemet, të mos e kuptojë të qenit në opozitë si pretekst për t'i shpallur luftë gjithçkaje, por si shans për të dëshmuar aftësinë e korrigjimit të gabimeve. Zgjedhjet nuk duhen pritur si fëmijët babadimrin. Ato duhet të priten me projekte të gatshme, plane mundësisht të realizueshme dhe ide të kapshme, e jo me avazin e premtimeve boshe. Koalicionet duhet të kenë bazë logjike, e jo irracionale, kryekëput në bazë të interesit të ngushtë, sepse këto po i kushtojnë shtrenjtë elektoratit.

Republika e Kosovës po ndërtohet dhe po konsolidohet si shtet. Ajo është si një fëmijë që ka qenë i sëmurë, e të cilit i nevojitet shërimi dhe pastaj përkujdesja e vazhdueshme e të gjithëve. Ky fëmijë dëshiron të dalë jashtë, të luajë me shokë, dëshiron t'i shijojë frytet e lirisë. Prandaj për të mos e lënë të lëngoje në shtrat duhet të angazhohet e gjithë familja.

Lypset angazhimi i të gjithëve që gjërat të vijnë në rend ashtu siç duhet e siç dëshirojmë. ■

urime
ditelindjen **2** KOSOVE



Intervistë me deputetin e LDK-së, Ismet Beqirin

Qytetarët e Kosovës meritojnë më shumë

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Është njëri nga deputetët që e quan veten të privilegjuar që ka qenë pjesë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Ai tregon se si i ka përjetuar ato momente dhe se deri ku ka ecur vendi ynë përpara. Sipas tij, institucionet e vendit kanë mundur të bëjnë më tepër për qytetarët, por edhe për vendin, sidomos në angazhimin për njohje më të mëdha. Ai i uron të gjithë qytetarët për përvjetorin e pavarësisë dhe, njëkohësisht, u bën thirrje që ta ndihmojnë shtetin për t'i luftuar dukuritë negative. Për më shumë flet për revistën "Paqja" deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ismet Beqiri.

PAQJA: Tashmë Republika e Kosovës po i afrohet dyvjetorit të pavarësisë. A mund të na thoni komentin tuaj në këtë drejtim?

BEQIRI: Ajo që ka qenë aspiratë shekullore dhe shumëvjeçare u bë realitet këtu e dy vite më herët dhe, sig-

urisht, nuk mund të thuash që nuk e ndien vetën mirë që ke qenë pjesë e këtij akti madhor siç jam edhe unë në mesin e kolegëve të mi deputetë. Është realizuar ajo për të cilën kanë derdhur gjak shumë gjenerata me herët, pastaj edhe në Kosovën e re ose në vitet e '90-ta me lëvizjen e madhe LDK-në, me në krye presidentin Rugova, pastaj me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila me përkrahjen e Bashkësisë Ndërkombëtare solli lirinë e vendit. Fatbardhësisht, ne si popull kemi arritur t'i përvetësojmë miqtë dhe të dëshmojmë para tyre se jemi popull i vjetër, autokton dhe se e meritojmë pavarësinë. Këta miq na i ka krijuar presidenti Ibrahim Rugova e pastaj Lufta e UÇK-së.

PAQJA: Sa mendoni se Kosova ka shënuar progres brenda periudhës dyvjeçare të pavarësisë së saj?

BEQIRI: Sigurisht që Kosova ka shënuar progres këto dy vite, por ka ende edhe shumë punë për t'u bërë. Me gjithë të arriturat, qytetarët kërkojnë edhe më tepër mirëqenie sociale, sig-

uri, gjyqësi, luftim të krimit, etj. Unë mendoj se, si shtet, duhet të dëshmojmë se jo vetëm që nuk jemi pjesë e krimit, por duhet të jemi bajraktarë të luftimit të këtij krimi, praninë e të cilit në Kosovë ne nuk mund ta mohojmë. Pra, këtu ka vend për ta luftuar krimin. Po ashtu, para ligjit të gjithë duhet të jenë të barabartë, pavarësisht prej postit, që nga portieri e deri të presidenti. Pra, të gjitha instancat duhet të jenë të barabarta para ligjit dhe duhet të llogariten për të bërëat dhe të pabërëat. Në këtë drejtim, mendoj se ende kemi çaluar dhe duhet një luftë më e madhe dhe e pa kompromis kundër krimit, veçmas atij ekonomik.

PAQJA: Cilat janë sukseset dhe sfidat e shtetit të Kosovës gjatë kësaj kohe?

BEQIRI: Për dy vite të pavarësisë së Kosovës, dorën në zemër, kemi pasur shpresa më të mëdha, posaçërisht për çështjen e njohjeve. Unë mendoj se ka ca pengesa dhe, megjithatë, unë mendoj se do të duhej dhe ne meritojmë më shumë njohje, se sa numri 65 i shteteve që na kanë njohur, sidomos nga Bashkimi Evropian dhe ju e dini se ka nga ato shtete që hezitojnë të na njohin, por shpresoj që në këtë aspekt do të jemi edhe më aktivë, sepse duhet një lobim dhe angazhim më i fuqishëm. Problem tjetër i vendit tonë është, në përgjithësi, edhe gjendja ekonomike edhe në këto dy vite, por edhe në vitet e mëhershme. Pra, kemi një gjendje jo të mirë ekonomike, nuk kemi ende investitorë dhe investime nga jashtë dhe kjo, domosdo, e zbeh atmosferën e shtetësisë. Dëshira jonë është të zvogëlohen këto ndasi sociale, ose të mos krijohet një hendek i madh i gjendjes sociale mes atyre që e kanë të mirë gjendjen financiare dhe atyre që nuk e kanë. Shpresoj shumë se ne do t'i bindim të gjithë njerëzit që të investojnë në Kosovë. Thjesht, them se ka punë për t'u bërë dhe ne jemi optimistë, sepse ne kemi tejkaluar situata edhe më të rënda dhe besoj që edhe kësaj radhe do t'ia





dalim dhe do të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane.

PAQJA: *Ju keni qenë edhe nënshkruesi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. A mund të na përshkruani se si jeni ndier në ato momente?*

BEQIRI: Të nënshkruash deklaratën e Pavarësisë së Kosovës është një akt që njeriut i ndodh një herë në jetë ose nuk i vjen rasti kurrë më dhe, sigurisht, ne kemi qenë gjenerata më e privilegjuar që e kemi pasur këtë mundësi. Nënshkrimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës është një ndjenjë e veçantë dhe një privilegj i madh që nuk besoj se do të harrohet ndonjëherë. Një pjesë nga ne kemi shprehur keqardhje për ata njerëz që kanë dhënë gjithçka për Kosovën, por që nuk kanë pasur mundësi ta përjetojnë atë ditë dhe ky është ai emocioni që, deshëm a jo, nuk mundemi ta anashkalojmë ose t'i harrojmë ata njerëz që kanë kontribuar.

PAQJA: *Sa mendoni se ka punuar Kuvendi i Kosovës gjatë këtyre dy viteve të pavarësisë së vendit?*

BEQIRI: Është e vërtetë se janë miratuar një numër i madh ligjesh dhe, po ashtu, e dini se ne këtë e kemi bërë sipas një procedure të shkurtër, e cila ka dalë nga pakoja e Ahtisaarit. Nga kjo pako ne kemi miratuar shumë ligje, të cilat kanë krijuar identitetin e shtetit të Kosovës.

Sigurisht që miratimi dhe implementimi janë dy gjëra krejt të ndryshme, pra disa ligje kanë kosto financiare, ndërsa disa të tjerë po implementohen me vështirësi në praktikë, ndërsa një pjesë e tyre kanë nevojë sërish të amendamentohen, të ndryshohen për t'iu përshtatur rrethanave. Unë mendoj se në procedim të ligjit ka një neglizhencë edhe nga Qeveria e Kosovës. Për mua është e palogjishme që, pas shumë vitesh, ende nuk ka një ligj për personat e pagjetur dhe për këtë gjë nuk ekziston asnjë justifikim, sepse gjendja shpirtërore e këtyre familjeve është shumë e rëndë. Prandaj ia shoh shumë për të madhe qeverisë që nuk e ka bërë këtë gjë, edhe pse ne e kemi ngritur disa herë zërin për këtë. Personalisht, diçka që nuk më pëlqen në kuvend janë projektligjet që procedohen dhe tërhiqen në moment, të njëjtat kthehen prapë, pastaj bëhen shumë shkurt, shpejt dhe kjo është një mënyrë e keqe, sepse krijon përshtypjen e një diktati të vetë qeverisë ndaj Kuvendit të Kosovës, gjë që nuk guxon të ndodhë. Pra, në këtë drejtim, duhet të ketë më shumë korrektesë dhe sjellje të respektit të hierarkisë, që secili ta dijë se ku e ka vendin.

PAQJA: *Për fund, cili është mesazhi juaj me rastin e dyvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës?*

BEQIRI: Qytetarët tanë meritojnë të përgëzohen për gjithë atë që kanë bërë, ata meritojnë t'ua urojmë edhe dyvjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Qytetarët tanë duhet të jenë edhe më aktivë në luftimin e dukurive negative, sepse institucionet e Kosovës nuk mund ta bëjnë vetë atë punë, pasi që krimi, për t'u luftuar, duhet të lajmërohet. Pra, qytetarët duhet të jenë pjesë aktive në shoqëri, sepse pa ta nuk mund të kenë progres dhe sukses as vetë institucionet, sepse janë ata që na votojnë neve dhe na dërgojnë nëpër pozita. Qytetarët duhen të jenë ata që, nëse ne nuk e meritojnë, të na thonë që nuk jemi për këto poste. Populli ynë e ka edhe vitalitetin, por edhe mençurinë dhe ka ditur t'i vlerësojë të gjithë ata që e kanë merituar notën pozitive dhe negative. Shpresoj për ditë më të mira dhe uroj për ditë të mira, me një besim të thellë se do të përmirësohet, mbi të gjitha, mirëqenia sociale e qytetarit. Krejt në fund, urime për Ditën e Pavarësisë së Kosovës. ■

Reportazh nga Kompleksi Memor

Prekazi



Muhamet JAHIRI

Janë bërë më tepër se dhjetë vite që kur barbarët serb sulmuan fshatin Prekazi dhe bënë masakër mbi familjen legjendare të Jasharëve. Mirëpo, megjithatë, në këtë vend ende mbesin të gjalla gjurmët e luftës. Shtëpitë e Jasharëve tashmë të kthyer në muze janë dëshmitarët më të mirë të asaj që ndodhi dhe tregojnë me fanatizëm sulmin që ishte kryer mbi to nga të gjitha anët. Gjurmët e barbarëve serbë edhe më shumë se pas dhjetë vjetëve, janë prezente aty për të dëshmuar të keqen që ka bërë populli sllav ndaj civilëve të pafajshëm, ndërsa të shkaktonte makth dhoma në të cilën ishin masakruar barbarisht, familja Jashari.

Pavarësisht kësaj, flamuri i kombëtar i shqiptarëve për të cilin dhanë jetën shumë vetë, valëvitej mbi gërmadhat e mbetura të bombardimeve, ndërsa pranë tij silleshin dhjetëra vizitorë, edhe pse ishte një ditë me dëborë dhe e ftohtë. Vizitorët aty ndiheshin krenarë që po vizitonin shtëpinë e komandantit legjendar Adem Jashari.

Jo shumë larg tri shtëpive, tashmë muze të Jasharëve, gjendeshin edhe ata që pësuan nga sulmi barbar: mbi pesëdhjetë varre të një familjeje të vetme të



Memorial i Jasharëve në Prekaz

Prekazi meriton më shumë

masakruar, të gjithë në një kohë dhe në një formë barbare. Në mesin e tyre ishte edhe komandanti legjendar Adem Jashari, babai i tij Shabani e vëllai Hamza, të cilët dhanë gjithçka për Kosovën. Për nder të veprës dhe shenjtërimin të tyre, pranë varreve është vendosur edhe garda e nderit e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila të bën të ndihesh krenar.

Sulmet sllave mbi fshatin Prekaz kishin lënë gjurmë të shumta. Ata kishin sulmuar atë vatër nga të gjitha anët dhe nuk kishin kursyer asgjë, por përkundrazi kishin bërë kërdi të llahtarshme. Urrejtja e tyre që ka ekzistuar shihej ende gjallë kudo: flamuri kombëtar shqiptar i grisur, rrënimet e magjes ku përgatitej buka - janë vetëm disa nga këto dëshmi.

Në rrugën kryesore të Prekazit, e cila mban emrin "Shaban Jashari", hasëm shumë vizitorë, të cilët kishin ardhur nga vende të ndryshme të Kosovës.

Ndërsa ciceroni i kompleksit memorial Xhevat Imeri, i cili punon aty që nga paslufta, tregon se si kalohet një ditë në Prekaz.

"Këtu është gjallëri gjithë kohën. Tërë vitin ky vend është i mbushur me vizitorë. Edhe atëherë kur rrugët janë të pakalueshme, njerëzit i bëjnë të kaluara duke ardhur për ta vizituar këtë vend për të parë sakrificën e komandantit legjendar dhe gjithë lagjes së Jasharëve për çlirimin e vendit. Këtu kemi vizitorë me orë të gjata, të cilët ndonjëherë janë



prezent këtu deri në orët e vona të natës", - është shprehur ciceroni Imeri, duke shtuar në këtë kontekst se ka vizitorë të shumtë nga e gjithë bota.

"Kemi shumë vizitorë nga e gjithë bota. Më ka bërë përshtypje vizita këtu e KFOR-it danez e norvegjez, të cilët kanë ardhur për ta vizituar këtë vend në fund të misionit të tyre dhe janë deklaruar se nuk kanë mundur të vijnë me herët për shkak të mos politizimit", - ka theksuar ai.

Sipas tij, deri më tani, Prekazin legjendar e kanë vizituar miliona njerëz, për të cilët kanë statistika në librin e vizitorëve.

"Ne e kemi edhe librin e vizitorëve të cilin ia ofrojmë çdo vizitori. Ai është i hapur për të gjithë dhe, në të, çdokush mund të shkruajë përshtypjet që i ka lënë vizita. Sipas statistikave që kemi, mund të themi se deri më tani këtë vend e kanë vizituar më shumë se tetë milionë njerëz", - është shprehur Imeri.

Imeri ka theksuar se njerëzit që po e vizitojnë këtë vend shumë herë po dalin të zhgënjyer nga mospërkujdesja institucionale.

"Fatkeqësisht, duke pasur parasysh se sa vite kanë kaluar, njerëzit po ndihen të zhgënjyer me objektet, të cilat mund t'i shihni se në çfarë gjendje janë. Ato kanë filluar të dëmtohen sepse rregullisht janë nën ndikimin e borës dhe shiut, i cili është i gjatë në stinën e dimrit", - shprehhet ciceroni i kompleksit memorial

Xhevat Imeri, i cili tregon se tashmë ka filluar të punohet diçka, por puna është ndërprerë për shkaqe atmosferike.

Imeri tregon se po hasin në vështirësi edhe të mbijetesës, pasi që sipas tij nuk kanë paga nga institucionet për punën që bëjnë, mirëpo mbulohe vetëm nga shitja e disa librave që bëhen aty.

"Ne si personel këtu, më vjen keq të them, por paguhemi dhe mbijetojmë vetëm nga shitja e librave që bëhen këtu. Kjo është e vetmja mënyrë edhe pse më shumë prej kësaj përfitojnë autorët e librave", - ka theksuar Imeri.

Ndërkaq shumë banorë të atij fshati, të cilët nuk donin të identifikoheshin tregojnë se janë të zhgënjyer për moskujdesjen institucionale të shtëpive muze të Jasharëve në Prekaz. Sipas tyre, kjo familje meriton shumë, sepse ka dhënë shumë për Kosovën, prandaj nuk duhet të harrohet gjaku i tyre.

I po këtij mendimi ishte edhe vizitori, i cili kishte ardhur nga një fshat i Prishtinës aty, Agim Berisha. Ai ka thënë se Prekazin duhet ta konsiderojmë si vend të shenjtë për shqiptarët.

Më shumë se pesëdhjetë anëtarë të familjes Jashari, me në krye komandantin legjendar Adem Jasharin, u masakruan nga regjimi serb, në mars të vitit 1998, në fshatin Prekaz të Skenderajt.



Flet për revistën 'Paqja', deputeti Bajram Kosumi

17 shkurti histori e re për Kosovë

Intervistoi: Muhamet JAHIRI

Ishite borë. Prishtina ishte në ankth se si do të ndodhte? Shkuam në zyrat e grupit tonë parlamentar, ku duhet të pritim rreth gjysmë ore. Bëmë një diskutim të shkurtër. Pinim verë e këndonim. Kur mbërritën makinat e diplomatëve të huaj për herë të parë në Kosovë, ata kishin vendosur flamujt e tyre në njërën anë të makinës, ashtu si obligohet të bëjë një diplomat i huaj në shtetin ku shërben. Që nga ajo ditë, në anën tjetër të makinës do të vendosej edhe flamuri i Kosovës”, - kështu e përshkruan deputeti Bajram Kosumi ditën e 17 shkurtit kur Kosova u bë shtet.

Ai thotë se Kosova po shënon tashmë një histori të re, mirëpo sipas tij ka për të kaluar shumë sfida. Sipas tij, momenti më krenar ka qenë ditë e deklaratës së pavarësisë, e cila përveç gëzimit i ka sjellë edhe kujtimet për ata që nuk po e përjetonin këtë ditë të madhe dhe që kishin sakrifikuar shumë për vendin. Për më shumë flet, me rastin e dy vjetorit të pavarësisë, deputeti i AAK-së, Bajram Kosumi.

PAQJA: Tashmë Republika e Kosovës po i afrohet dyvjetorit të shpalljes së pavarësisë. A mund të na thoni cili është komenti juaj në këtë drejtim?

KOSUMI: Është një fillim i ri. Është një histori e re e Kosovës dhe e popullit shqiptar.

PAQJA: Sa mendoni se Kosova ka shënuar progres brenda kësaj kohe?

KOSUMI: Vetë bërja e shtetit është progresi më i madh. Asgjë tjetër që ka ndodhur pas shpalljes së pavarësisë e deri më sot nuk mund të krahasohet me kthesën historike që është bërë me bërjen e pavarësisë. Megjithatë, mund të flitet për progres në vija të veçanta dhe për stagnim në vija të tjera. Njohja e shtetit të Kosovës, anëtarësimi i Kosovës në disa mekanizma ndërkombëtarë, ndikimi që ka pasur krijimi i shtetit të Kosovës në sigurinë në rajon dhe më gjerë, etj. – këto janë përparime.

PAQJA: Cilat kanë qenë sukseset dhe cilat kanë qenë sfidat e shtetit më të ri gjatë kësaj kohe?

KOSUMI: Për sukseset tashmë folëm. Sfidat në një shtet të ri janë të shumta. Pothuajse gjithçka duhet të krijohet e re. Kjo, aq sa është heroike dhe historike, po aq është edhe e vështirë. Është e vështirë duke filluar që nga zgjedhja e prioriteteve: çka është më prioritarë për popullin dhe për shtetin e Kosovës në një çast të caktuar?

Unë besoj se, përveç krijimit të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës e cila

është çështje e ekzistencës së shtetit, çështja më madhore e Kosovës sot është demokratizimi, dhe gjithë ato veprime e gjendje që ndërthuren me konceptin demokratizim. Në këtë vijë ka një stagnim. Po ende, demokracia në Kosovë po degjeneron në një demokraci të kontrolluar nga grupe politike dhe nga grupe të biznesit, gjë që jemi mësuar të shohim në shumë vende latino-amerikane.

Pa demokraci të vërtetë, pa një ringjallje të shpirtit ndërmarrës shqiptar, pa një ringjallje të idealeve demokratike e patriotike, Kosova nuk mund të krijojë themele të forta. Për të pasur përparim në Kosovë, duhet të krijojmë një shoqëri dhe një pushtet të hapur, të krijojmë një shoqëri dhe një pushtet që i bindet ligjit.

PAQJA: Sa e vështirë është të jesh deputet në një shtet të ri?

KOSUMI: Ende nuk shoh një dallim thelbësor në Kuvendin e Kosovës, nga aspekti i vendosjes, midis të sotmes dhe të para 17 shkurtit 2008. Kuvendi, po edhe institucionet e tjera, sikurse qeveria, vazhdojnë të punojnë me të njëjtën inerci. Asnjë çështje thelbësore për Kosovën nuk është debatuar dhe nuk është votuar në Kuvendin e Kosovës (sikur në Kohën e UNMIK-ut, kur Kuvendi nuk kishte kompetencë të vendoste për disa çështje). Qeveria nuk ka debatuar në Kuvend asnjë çështje jetike për Kosovën, e as nuk e ka debatuar në publik. Të gjitha punët kryesore ende vazhdojnë të kryhen si në kohët e vjetra të UNMIK-ut. Dy-tre vetë e marrin sugjerimin nga ndërkombëtarët dhe i realizojnë ato detyra. Shikoni se çka po bëhet, p.sh. me PTK, me aeroportin apo me termocentralin e ri të Kosovës! Kush e di se çka është duke ndodhur atje? Askush, përveç kryeministrit, presidentit dhe ndonjë “eksperti” të huaj. Natyrisht, edhe drejtorët e këtyre ndërmarrjeve, sepse edhe ata janë pjesë e pazarit.

Unë jam i bindur se ne duhet të kemi tjetër tip të kuvendit, tjetër tip të qeverisë dhe tjetër tip të presidentit. Përfundimisht, tjetër tip të klasës politike. Vetëm demokracia e vërtetë krijon kushte për një tip tjetër të klasës politike.



ën, por duhen kaluar shumë sfida

PAQJA:

A mendoni se keni qenë me fat si deputet që të jeni pjesë e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë, ku tashmë jeni bërë edhe pjesë e historisë së re të Kosovës?

Kosumi: Unë e kam thënë një mendim në një intervistë si kryeministër i Kosovës, në vitin 2005, të cilin e kam vënë edhe në librin tim Një vit vendimtar, e të cilin dua ta citoj edhe tash:

"Është krenari shumë e madhe, jo vetëm për mua që jam kryeministër, por për të gjithë njerëzit e Kosovës, për tërë këtë brez të popullit të Kosovës, që është duke e jetuar kohën më historike të Kosovës. Diku rreth dy milionë qytetarë të Kosovës, sot janë të gjithë krijues, janë autorë të lirisë, të demokracisë dhe të prosperitetit të Kosovës, janë autorë të një veprë që do të mbijetojë shekujt dhe do t'i gëzohen njerëzit për shekuj të tërë".

PAQJA: A mendoni se deputetët e Kosovës i kanë kushtet e duhura për të ushtruar aktivitetet e tyre?

KOSUMI: Këto ditë po flitet shumë për pagat e deputetëve. Por, ata, deputetët, në të vërtetë, nuk i kanë as kushtet elementare për punën e një deputeti. Deputetët nuk kanë bashkëpunëtorë ekspertë për leximin e ligjeve. Ata vetë duhet të merren me të gjitha ligjet e të gjitha fushave. Si pasojë, ata nuk mund të jenë efektivë në shumicën e ligjeve. Pastaj, deputetët nuk kanë zyra pune, as në Kuvend, as në zonat ku ata mund të kontaktojnë me qytetarët. Deputetët kanë mbetur, fatkeqësisht, si do lloj zyrtarësh politikë, që shkojnë me çanta të trasha në seancat e Kuvendit dhe votojnë për o kundër një ligji. Ky është deputeti ideal i UNMIK-ut: Kosova ka deputetë, por ata nuk vendosin për gjërat për të cilat duhet të vendosë një deputet.

PAQJA: Ju keni qenë edhe njëri nga nënshkrueset e Deklaratës së Pavarësisë...

A mund të na përshkruani se si i keni përjetuar ato momente kaq të rëndësishme për vendin?

KOSUMI: Ai ka qenë një moment i koncentruar historik, një çast në të cilin është ndierë veprimi i miliona shqiptarëve, një çast në të cilin unë kam përjetuar punën dhe vdekjen e atyre burrave e grave që iu përkushtuan idealit të lirisë së Kosovës, që nga Hasan Prishtina (ideatori i lëvizjes së Kosovës për çlirim) e deri tek Adem Jashari. Nënshkrimi i Deklaratës së Pavarësisë ishte shpagimi më i madh që mund t'u jepja të gjithë atyre që kishin rënë për këtë shtet dhe i të gjithë atyre që kishin punuar tërë jetën për këtë ideal.

PAQJA: Cili ka qenë emocioni i veçantë i atij akti solemn?

KOSUMI: Ishte borë. Prishtina (sigurisht gjithë shqiptarët, dhe jo vetëm ata) ishte në ankth se si do të ndodhte? Shkuam në zyrat e grupit tonë parlamentar, ku duhet të pritnim rreth gjysmë ore. Bëmë një diskutim të shkurtër. Pinim verë e këndonim. Kur mbërritën makinat e diplomatëve të huaj për herë të parë në Kosovë, ata kishin vendosur flamujt e tyre në njërën anë të makinës, ashtu si obligohet të bëjë një diplomat i huaj në shtetin ku shërben. Që nga ajo ditë, në anën tjetër të makinës do të vendosej edhe flamuri i Kosovës. E shihnim me sytë tanë si ndryshonin gjërat dhe si po lindte një shtet...

PAQJA: A kishit ëndërruar ndonjëherë në jetën tuaj se do të ishit pjesë e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, në cilësinë e deputetit?

KOSUMI: Kush e ka ditur se do të mbetem gjallë deri në ditën e pavarësisë? Dhjetë vjetët e burgut, vjetët e pas burgut, vjetët e luftës... Ato janë dhjetëra mijëra ditë në të cilat vdekja është sjellë mbi kokat tona...

PAQJA: Për fund, cili është mesazhi juaj me rastin e dyvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës?

KOSUMI: Ne e kemi shpallur pavarësinë, por tash duhet ta bëjmë shtetin. Duhet të fillojmë nga krijimi i demokracisë për të vazhduar me zhvillimin ekonomik. Nuk duhet të kënaqemi me çfarëdo shteti, por vetëm me një shtet të denjë. ■



Sie përjetuan shqiptarëte Maqedonisë mor



Iljasa SALIHU

Prej shekujsh, ngjarjet në Kosovë ishin bërë temë dhe preokupim i ditës, pothuajse te secili shqiptar, pavarësisht se ku jetonte. Që Kosova të bëhej e pavarur, ose thënë më mirë, që të shporrej njëherë e përgjithmonë sllavi, u desh që dikush të jepte më të shtrenjtën, pra jetën dhe familjen. Është e pamundur të flasësh për pavarësinë e Kosovës e të mos i kujtosh dëshmorët që ranë për këtë Kosovë që gëzojmë ne sot, duke filluar prej atdhetarëve të hershëm e gjer tek Adem Jashari dhe familja e tij. Pavarësinë e Kosovës e ndihmoi edhe faktori politik, i cili e sensibilizoi opinionin ndërkom-bëtar për gjenocidin e kryer ndaj popullit tonë. Si rrjedhojë e pangopësisë serbe kundrejt gjakut të shqiptarëve, situata arriti të prekë ndërgjegjen e organizatës më të madhe politike ushtarake, pra NATO-s. Pas intervenimit të NATO-s kundër Serbisë, përfundimisht politika gllabëruese dhe barbare e Jugosllavisë.

Kemi marrë disa prononcime se si e pritën shqiptarët e Maqedonisë çastin dhe momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës:



Suad Daipi, profesor i makinerisë

Meqë, në kohën kur Kosova po kalonte proceset dhe vështirësitë për pavarësinë e Kosovës, unë isha student në Prishtinë, momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e përjetova tejet i mallëngjyer. Ishte një gëzim i papërshkruar. Po ashtu, në ato momente shumë të lumtura për mua dhe për gjithë shqiptarët anembanë botës, ishte edhe një moment tjetër dhimbjeje, sepse është në natyrën njerëzore që, kur

fillon të bëhet vjelja e frutave, të lindin edhe dhembjet, kujtimet për ata të cilët flijuan gjithçka, vetëm e vetëm që ne t'i gëzojmë këto fryte të pambaruara, në këtë rast pavarësinë e Kosovës. Ne shqiptarët e Maqedonisë, menjëherë pas pavarësisë, disi filluam të marrim frymë lirshëm dhe gradualisht shihet një sensibilizim i çështjes kombëtare edhe këtu te ne.



Mr. Ardian Ramadani, profesor i gjuhës frënge në UEJL në Tetovë

Po, momentin e shumëpritur të shpalljes së pavarësisë së Kosovës e përjetova personalisht sikurse secili shqiptar, me nostalgji të thellë për dëshmorët dhe të rënë për këtë akt sublim, si dhe me një gëzim të papërshkruar që mund të përsëritet eventualisht me bashkimin e trojeve shqiptare, nën një shtet të vetëm me emrin Shqipëri, qoftë Natyrale, Reale a Etnike, po asesi e Madhe.

Ishin momente të paharruara, që nuk mund të përshkruhen sepse vetëm shpirti di t'i përjetojë, po goja nuk mund asesi t'i thurë ashtu siç janë përjetuar realisht.

Por, në anën tjetër, mendjen e kisha te shqiptarët e Kosovës Lindore që janë lënë në mëshirën e fatit, te ne shqiptarët e Maqedonisë që jemi lënë në mëshirën e partive politike shqiptare të poltronizuara nga padroni sllav dhe te shqiptarët e Çamërisë (të harruar krejtësisht), pa mos harrur të shtoj edhe shqiptarët e Malit të Zi.

Por, ajo që më brente më tepër dhe më bren edhe më tej ishte dhe është frika se mos flamuri kombëtar do të zëvendësohej me flamur tjetër, frika nga krijimi i identitetit veçues dhe i një gjuhe të fragmentarizuar nga shqipja, si dhe zëvendësimi i përkatësisë kombëtare shqiptare me përkatësinë shtetërore, pra rënia në kurth nga koncepti i shtetit-komb.



Afrim Zymberi, profesor i historisë

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt të vitit 2008, është një datë e madhe historike dhe e

rëndësishme në historinë e Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi. Atmosfera e krijuar në trojet shqiptare në Maqedoni para dy viteve dëshmoi se shqiptarët e Maqedonisë, të bashkuar në një gjuhë dhe trashëgimi të përbashkët me shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kosovës Lindore e Çamërisë, po e ndajnë ëndrrën shekullore bashkë me motrat e vëllezërit shqiptarë nga Kosova. Shpallja e pavarësisë festohej edhe në të gjitha fshatrat e komunës së Likovës, deri në orët e vona të mëngjesit, duke i uruar njeri-tjetrit festën madhështore. Me vite të tëra i ndamë dhimbjet e vuajtjet me motrat e vëllezërit kosovarë (shqiptarë) nga një regjim i egër që nuk e njihnte historia. Por ata nuk ndenjën duarkryq, duke pritur se dikush do t'ua sillte lirinë, por u treguan të gatshëm t'i dilnin zot vetes ose siç ka thënë La Brujeri: "Liria nuk është të rrih duarkryq, por është përdorimi i arsyes së kohës, është zgjedhja e punës dhe e veprimit.



Amir Salihu, ekonomist

Nuk ka dyshim se momenti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës është një ndër momentet e rralla të gëzimit dhe haresë kombëtare, kur kihet parasysh fakti se, në këtë ngjarje madhore dhe eveniment të paharruar të kombit shqiptar, për dallim prej pavarësisë së Shqipërisë, patëm fat të jemi prezent fizikisht dhe shpirtërisht. Personalisht unë, edhe pse jetoj dhe punoj në Gjermani, momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e përjetova dhe e ndjeva shumë këndshëm, por duke

momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës?

qenë njëkohësisht i emocionuar, ngase kur erdha në Maqedoni, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mendova se gjërat edhe këtu te ne do të kishin marrë të mbarën. Shpresoja se, tashmë, ne shqiptarët u bëmë më të fortë, pra me dy shtete, por tretmani ndaj nesh vazhdoi ashtu siç kishte qenë edhe më parë. Ndërkaq, kur shkova në Kosovën e pavarur, ata nuk më trajtuan si të tyrin, por si një shtetas i një shteti tjetër. Pra, parandjenja emocionale e momentit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës kishte qenë fakti i lartcekur, por sidoqoftë momenti i këndshëm e kishte pushtuar vendin e tij natyral dhe ndihem mirë për këtë!



Xhabir Islami,
magjistër i
diplomacisë -
UEJL

Shqiptarët e Maqedonisë ishin në të njëjtën linjë me shqiptarët e Kosovës, rreth statusit përfundimtar të Kosovës. Tek shqiptarët e Maqedonisë, shpallja e pavarësisë u prit me entuziazëm të njëjtë si te shqiptarët e Kosovës. Gjithnjë me shpresë se çështja e shqiptarëve në Maqedoni do të avancohet në nivelin e duhur, sigurisht duke shpresuar edhe në ndihmën e Kosovës si shtet i ri në Ballkanin Perëndimor.



Abedin Zymbëri,
ish-Komandant i UÇK-së,
deputet aktual në
parlamentin e Maqedonisë dhe
nënkryetar

i Demokraci së Re.

Njeriu nuk mundet të ndihet ndryshe pos i gëzuar që prej shekujsh, në padurim, edhe pse vonë, u realizua ëndrra e arsyeshme e gjithë shqiptarëve. Sepse shumë shqiptarë kanë kaluar nëpër tortura të ndryshme barbare, nëpër burgje, vrasje, maltretime, etj. për këtë pavarësi – edhe pse kjo pavarësi

është akoma nën kontrollin e plotë të ndërkombëtarëve, por me shpresë se një ditë do të pavarësohet në tërësi. Unë nuk e di, që si ish-luftëtar në jetën time të kem pasur gëzim më të madh se në ditën dhe momentin kur Kosova u bë e pavarur. Ky gëzim u manifestua nëpër të gjitha vendbanimet shqiptare të ILIRIDËS. Kosova e meritoi që të jetë shtet i pavarur, sepse derdhi shumë gjak në të kaluarën. Kosova po ecën drejt pranimit nga të gjitha shtetet e huaja dhe mendojmë se do të ndërtohet ashtu si dëshiron populli dhe, me angazhimin e të gjithëve, do të rrumbullakohet pavarësia e plotë dhe natyrale.



Arafat Veseli,
jurist

Pavarësinë e Kosovës e kam përjetuar si përmbylljen e një kapitulli të lavdishëm dhe njëkohësisht të dhimbshëm, i cili ishte mbushur plot me derdhje të tmerrshme gjaku, me vuajtje, sakrificë të panumërta, drama rrëqethëse njerëzore, luftëra të guximshme çlirimtare dhe si hapjen e një kapitulli të ri shpresëdhënës, në të cilin do të vendosen bazamente të shëndosha të një shoqërie prosperuese, paqësore, të edukuar në frymë të shëndoshë, të aftë për të garuar me popujt më të civilizuar të botës.

Për mua shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë gëzim i dyfishtë, duke marrë parasysh se unë, si qytetar i Maqedonisë, studimet i kam mbaruar në Prishtinë dhe kam qenë për së afërmi

dëshmitar i procesit të bërjes hap pas hapi të shtetit të Kosovës dhe e di shumë mirë se çfarë munda të bëj për t'u arritur deri te momenti i shumëpritur i shpalljes së pavarësisë së Kosovës.



Sali Shasivari,
teolog
Kryetar i
Forumit Ri-
nor Islam në
Maqedoni

Nuk mbaj mend që shqiptarët e Maqedonisë t'i ishin

përkushtuar ndonjë çështjeje dhe të kishin sakrifikuar për të, më shumë se sa për kauzën e pavarësisë së Kosovës.

Rrugëtimi i gjatë dhe i dhimbshëm nëpër të cilin kaloi populli shqiptar i Kosovës, deri në arritjen e pavarësisë, jo vetëm që u ndoq me një kujdes të veçantë dhe me një ndjenjë të ndarjes, së të mirës dhe të keqes nga ana e popullatës shqiptare në Maqedoni, por me plot përgjegjësi mund të them se shqiptarët e Maqedonisë thuajse përjetuan dhe kaluan nëpër të gjitha ato dhimbje dhe shpresa nëpër të cilat kaluan bashkëkombësit e tyre kosovarë. Bile-bile, nuk gaboja nëse them se "çështja kosovare" ishte më aktuale në mesin e popullatës shqiptare në Maqedoni se sa vetë brengat, hallet, problemet dhe statusi i tyre juridik në shtetin në të cilin jetojnë.

Andaj, shqiptarët e Maqedonisë, momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e përjetuan si fitore të veten, para se ta konsiderojnë atë si fitore mbarëkombëtare, me të gjitha dimensionet që ajo ngërthen në vete. ■



Intervistë me deputetin Naser Rugova

Pavarësimi i Kosovës, arritja shekullore

Intervistoi: **Muhamet JAHIRI**

Eshtë njëri nga nënshkruesit e pavarësisë së Kosovës, i cili me rastin e dy vjetorit të pavarësisë së vendit tregon se si është të jesh deputet i një shteti të ri. Ai rrëfen emocionet që ka pasur në ditën e shpalljes së pavarësisë, ndërsa nënshkrimin e deklaratës e quan si jetik për të. Rrëfen për sukseset dhe sfidat e Kuvendit të Kosovës, për privilegjet dhe mangësitë e deputetëve. Sipas tij, është mundur të bëhej më shumë për Republikën e Kosovës, ndërsa në fund uron të gjithë qytetarët për ditën e madhe të pavarësisë.

Flet në një intervistë për Revistën "Paqja", me rastin e dyvjetorit të pavarësisë, deputeti dhe nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), Naser Rugova.

PAQJA: Tashmë Republika e Kosovës po i ofrohet dyvjetorit të shpalljes së pavarësisë. A mund të na thoni cili është komenti juaj në këtë drejtim?

RUGOVA: Shpallja e pavarësisë së Kosovës pa dyshim që është ngjarja më e rëndësishme për historinë e popullit dhe vendit tonë, që me përpjekjet e shumta të popullit të Kosovës dhe me ndihmën e miqve tanë u bë realitet.

PAQJA: Sa mendoni se Kosova ka shënuar progres brenda kësaj kohe?

RUGOVA: Pritjet e qytetareve të vendit tonë kanë qenë të mëdha. Edhe pse vetëm dy vite shtet, personalisht kam pritur më shumë nga qeveria e pavarësisë, si në aspektin e shtet-ndërtimit ashtu edhe në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik-social dhe politik. Por, fatkeqësisht, kjo qeveri dhe këto institucione nuk arritën as për së afërmi të përmbushnin kërkesat legjitime të qytetarëve, e për premtimet e tyre as të mos flasim. Këto dy vite kemi parë vetëm regres institucional dhe ngecje enorme në të gjithë sektorët e zhvillimit të gjithëmbarshtëm. Progres ka fare pak.

PAQJA: Cilat kanë qenë sukseset dhe cilat kanë qenë sfidat e shtetit më të ri gjatë kësaj kohe?

RUGOVA: Nëse mund të quhet suk-

ses krijimi i institucioneve dhe kategorive të caktuara kushtetuese, kompletimi i mekanizmave shtetërorë dhe asfaltimi i disa qindra km rrugë, cilësia e të cilave është e diskutueshme, po shihet dita-ditës. Në anën tjetër, sfidat janë evidente, dështimet janë të mëdha si: nuk respektohet kushtetuta, nuk ka juridiksion shtetëror në afro 30% të territorit të vendit, ka ngecje të zhvillimit ekonomik, ka rritje të papunësisë dhe varfërisë, ka mospunim të rendit dhe ligjit, nuk ka asnjë cent investime të huaja direkte, ka pakënaqësi sociale të punonjësve të shtyllave kryesore të shtetit si policia, shëndetësia, gjyqësia, administrata etj. Kur kësaj i shtojmë edhe raportet e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008 dhe 2009, ku vendi ynë kritikohet si vatër e krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme, atëherë emëruesi i përbashkët i këtyre konstatimeve është baras me degradim, stagnim dhe dështim.

PAQJA: Sa e vështirë është të jesh deputet në një shtet të ri?

RUGOVA: Të jesh deputet i zgjedhur nga populli dhe të përfaqësosh vullnetin e tyre në organin më të lartë përfaqësues të vendit është privilegj, por edhe përgjegjësi. Pritjet dhe kërkesat janë të mëdha, mundësitë e kufizuara. Të jesh deputet i një shteti të ri, si vendi ynë, është sfida dhe përgjegjësi, por edhe motiv për punë.

PAQJA: A mendoni se deputetët e Kosovës i kanë kushtet e duhura për të ushtruar aktivitetet e tyre?

RUGOVA: Jo. Këtë e arsyetoj me

këto fakte: nuk kemi zyra tonat ku do komunikojmë me mirë dhe në mënyrë institucionale me bazën, me zgjedhësit tanë, nuk kemi mbështetje teknike dhe administrative, e as konsulencë nga ana e ekspertëve. Kjo, nganjëherë, na e vështirëson shumë punën.

PAQJA: Ju keni qenë edhe njëri nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë. A mund të na përshkruani se si i keni përjetuar ato momente kaq të rëndësishme për vendin?

RUGOVA: Pa dyshim momenti më krenar i jetës sime!

PAQJA: Cili ka qenë emocion i veçantë i atij akti solemn?

RUGOVA: Gjatë aktit të nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë kam pasur emocione të përziera, krenarie, gëzimi, por edhe dhimbjeje për ata që kontribuan shumë për atë ditë dhe nuk e pritën jetësimin e idealit dhe punës së tyre.

PAQJA: A kishit ëndërruar ndonjëherë në jetën tuaj se do të ishit pjesë e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, në cilësinë e deputetit?

RUGOVA: Secili njeri që është aktiv në politikë i ka ambiciet e veta. Me thënë të drejtën kam qenë njeri me fat që i kam takuar brezit të pavarësisë së vendit tonë. Nuk e kisha menduar që, pikërisht, si njeri i zgjedhur do ta kem atë fat.

PAQJA: A mendoni se keni qenë me fat si deputet që të jeni pjesë e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë, ku tashmë jeni bërë edhe pjesë e historisë së re të Kosovës?



e shqiptarëve

RUGOVA: Krenari, privilegj dhe fat i madh. Kjo ndodh vetëm njëherë në jetë dhe histori.

PAQJA: Sa mendoni se është i rëndësishëm përfaqësimi në një institucion kaq relevant siç është Kuvendi?

RUGOVA: Ne jemi Republikë Parlamentare. Kuvendi është organi më i lartë përfaqësues i shtetit, zgjedh presidentin, kryeministrin, qeverinë dhe institucionet e tjera të parapara me kushtetutë, andaj përfaqësimi në institucionin që shpreh vullnetin politik të qytetarëve të vendit ka rëndësi dhe peshë të veçantë.

PAQJA: Sa mendoni se Kuvendi i Kosovës ka punuar gjatë këtyre dy viteve?

RUGOVA: Kuvendi i Kosovës mendoj që ka bërë një punë modeste gjate këtyre dy viteve. Kemi nxjerre një numër të konsiderueshëm të ligjeve bazike dhe derivateve. Kemi themeluar dhe kompletuar një numër të madh të bordeve, agjencioneve dhe institucioneve të pavarura që kanë rëndësi të madhe për sektorë të rëndësishëm, por kemi mundur dhe mundemi edhe më shumë. Pres një punë më të madhe dhe me cilësore të Kuvendit në ditët në vijim, konform përgjegjësive që ka.

PAQJA: A mendoni se ka mundur të bëhej më tepër për Kosovën?

RUGOVA: Gjithsesi, qoftë në politikën e brendshme zhvillimore dhe strategjive zhvillimore nacionale, qoftë në politikën e jashtme. Ka pasur mundësi dhe hapësirë të bëhej shumë më tepër.

PAQJA: Për fund, cili është mesazhi juaj me rastin e dyvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës?

RUGOVA: Së pari, ua uroj të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës përvjetorin e dytë të pavarësisë. Mesazhi im, në vigjilje të kësaj dite të madhe, do ishte që të gjithë ne, të tërë si popull, politikanë dhe institucione, t'i kryejmë ashtu si duhet detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë tona, të punojmë shumë, të krijojmë një perspektivë të mirë për vendin, ta bëjmë Kosovën shtet ku qytetari ndihet mirë, si dhe ta jetësojmë objektivin tonë nacional: integrimin në familjen e madhe evropiane. ■

Intervistë me Xhevdet Neziraj, deputet nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)

Pavarësisë së Kosovës duhet t'i gëzohen edhe pakicat



Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Është njëri nga deputetët i cili vjen nga radhët e pakicave. Mendon se për pavarësinë e Kosovës kanë sakrifikuar shumë gjenerata, ndërsa tani, sipas tij, të gjithë duke përfshirë edhe pakicat duhet të punojnë për ndërtimin e Republikës së Kosovës. Sipas tij, Kosova ka arritur progres të madh duke u anëtarësuar në disa organizata të rëndësishme të botës. Ai mendon se Kosova ka fituar një betejë kundër shtetit serb edhe në sferën e lobimit ku, sipas tij, Serbia nuk arriti t'i ndalë njohjet e shumta që iu bënë vendit tonë. Sipas tij, Deklaratës së Pavarësisë duhet t'i gëzohen edhe minoritetet, sepse ajo deklaratë është edhe pjesë e tyre. Për më shumë, në një intervistë me rastin e dyvjetorit të pavarësisë së Kosovës flet deputeti nga radhët e pakicave Xhevdet Neziraj, nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK).

PAQJA: Tashmë Republika e Kosovës po i afrohet dyvjetorit të pavarësisë. A mund të na thoni komentin tuaj në këtë drejtim?

NEZIRAJ: Pas sakrificave të shumë gjeneratave arriti Pavarësia e Kosovës dhe kjo është meritë e shumë gjeneratave dhe shumë brezave. Ne kemi menduar se pas arritjes së pavarësisë, si me një shkop magjik, do të mund t'i zgjidhnim shumë probleme, por tani jemi në fazën e ndërtimit të shtetit, në të cilën përballemi me shumë sfida. Jemi duke bërë përpjekje që ky shtet të jetë funksional dhe besoj se qëllimi i parë, që ka qenë pavarësia, është arritur, ndërsa qëllimi i dytë është ndërtimi i shtetit. Unë besoj se të gjitha komunitetet në Kosovë duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe këtu po flasim për ato komunitete që e pranojnë shtetin e Kosovës si shtet të vetin amtar.

PAQJA: Sa mendoni se Kosova ka shënuar progres brenda periudhës dyvjeçare të pavarësisë së Kosovës?

NEZIRAJ: Duke marrë për bazë se Kosova në ish-Jugosllavi ka qenë vendi më i pazhvilluar, duke marrë për bazë luftën, sundimin shumëvjeçar nga serbët, atëherë themi se jemi të kënaqur me të gjitha këto të arritura, edhe pse këto suksese nuk duhet të ndalen, sepse duhet të arrijmë më shumë në aspektin

e sigurisë, në aspektin ligjor dhe në zhvillimin ekonomik. Kemi probleme të grumbulluara shumëvjeçare, andaj shpresoj se këto probleme do të arrijmë t'i zgjidhim në vitet e ardhshme.

PAQJA: Cilat janë sukseset dhe sfidat e shtetit të Kosovës gjatë kësaj kohe?

NEZIRAJ: Si sukses do të quaja konsolidimin e duhur të institucioneve të Kosovës, por si mospjesëmarrje do të quaja mospranimin e shtetit të Kosovës nga një numër i madh shtetesh të tjera, për arsye se tashmë është sfidë që nuk jemi anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe të disa organizatave me renome ndërkombëtare. Suksesi më i madh është se Kosova ia arriti, edhe përkundër përpjekjeve të bëra nga Serbia, që ta pranojnë një numër shtetesh të fuqishme në botë si shtet të pavarur dhe demokratik. Kosova ka arritur të anëtarësohet në Fondin Ndërkombëtar Monetar dhe në Bankën Botërore, që janë dy mekanizma të rëndësishme për vendin tonë. Pritet që në vitin e ardhshëm të anëtarësohemi edhe në institucionet e tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

PAQJA: Ju keni qenë edhe nënshkruesi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. A

mund të na përshkruani se si jeni ndier në ato momente?

NEZIRAJ: Momenti i nënshkrimit të Dokumentit të Pavarësisë së Kosovës ka qenë shumë i veçantë për ne si deputetë, por edhe për mua, si pjesëtar i pavarësisë së Kosovës, ka qenë shumë emocional, sepse këtë moment e kanë pritur shumë gjenerata, por ka qenë fati i kësaj gjenerate që të jetë nënshkruese e pavarësisë. Është një gjë e paharrueshme dhe shpresoj se ia ka vlejtur, sepse nënshkruerit kanë qenë të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të Kosovës, me përjashtim të atij serb, të cilët nuk e kanë bërë për shkaqe të ndryshme politike. Deklarata e Pavarësisë bëhet shumë e fuqishme, sepse pjesëmarrës në të janë të gjithë pjesëtarët e komuniteteve dhe gjithë ata e shohin Kosovën si shtet të vetin.

PAQJA: Sa mendoni se Kuvendi i Kosovës ka punuar gjatë këtyre dy viteve të pavarësisë së vendit?

NEZIRAJ: Jam deri-diku i kënaqur me punën e Kuvendit, por mund të them se ka zbrazëtira. Dua të them se Kuvendi i Kosovës, sidomos komisionet parlamentare, duhet të kenë disa mekanizma, të cilët duhet që të bëjnë

përgatitjen e ligjeve në mënyrë më profesionale. Ne kemi kaluar shumë ligje, por implementimi i tyre nuk është duke u bërë ashtu siç duhet. Por ne jemi duke i harmonizuar dhe duke i marrë ligjet nga Bashkimi Evropian dhe kur këto ligje po vijnë në Kosovë për t'u implementuar, atëherë po dalin probleme të natyrave të ndryshme. Unë shpresoj se Kuvendi i Kosovës do të ketë një kuadër më profesional, më afër deputetëve dhe Komisioneve Parlamentare, me qëllim që ligjet t'i përshtaten edhe Kosovës, si shteti më i ri dhe me qëllim që ligjet të implementohen, sepse nëse nuk ndodh kjo, atëherë do të ketë probleme.

PAQJA: Për fund, cili është mesazhi juaj me rastin e dyvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës?

NEZIRAJ: Të gjitha gjeneratat në Kosovë duhet të punojnë më shumë. Është fakt që gjeneratat e reja po rriten pa dhunë dhe në demokraci dhe jo sikurse gjeneratat tona. Është një fat i mirë për ta që po shkollohen dhe po arsimohen për tregun e punës sipas standardeve evropiane. Ndërsa neve, si deputetë, na mbetet të punojmë më shumë për Kosovën dhe për gjeneratat e ardhshme. ■

Urime 2 vjetori i Pavarësisë

